

KADARE-ONUFRË 25 VJET BASHKËPUNIM

Ishte një terren i vështirë dhe vazhdimisht binin rrufe

Nga Bujar Hudhri



IN MEMORIAM

Guljelm Radoja (1945-2021)

**Guljelmit i kanë thënë
"këtu nuk ka përse, këtu
ka vetëm urdhna!"**

Fragment nga intervista e pabotuar me
Guljelm Radojën

Nga Enver S. Morina (fq. 5)

SHËNIME PËR LIBRAT

Visar Zhiti, "Funerali i pafundmë"
në rumanisht

**Kori që shndërrohet
në kortezh**

Nga Adrian Lesenciuc (fq. 8)

Romani i ri i Stefan Çapalikut

**"Mbyllur për pushime"
një paradigmë
deheroizuese**

Nga Josif Papagjoni (fq. 9)

Botim i ri nga Shtëpia Botuese Dituria

**"Ankthi i portierit
para penalltisë",
Peter Handke**

Nga Petrit Ymeri (fq. 21)

GAZETARËT SHQIPTARË NËN REGJIMIN MONIST

Nga Ardita Reçi

(fq. 6)

Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët

Në lidhje me pretendimin se në atëkohë kishte gazetari të mirëfilltë, shumë studiues të tjerë nuk bien dakort, duke pretenduar se gazetaria shqiptare e asaj periudhe, vetëm informim publik nuk ishte (dhe ky duhet të jetë kriteri i parë dallues i gazetarisë), por vetëm propagandim në shërbim të shtetit.

PËRSE LEXOJ ANGLISHT

Nga Eni Myrtollari

(fq. 17)

JORDAN B. PETERSON DHE LIBRI I TIJ "12 RREGULLA PËR JETËN"

Shënime të përkthyeses

Nga ATENA BISHKA

(fq. 10)



BIBLIOTEKË

Vath Koreshi (fq. 12)

Vajzat

Shazim Mehmeti (fq. 13)

Agim, çast deliri...

Vjollcë Berisha (fq. 14)

Ftohtë për ëndrra miturake

Shpresa Qeriqi (fq. 15)

Gishtat e nanës

Milorad Pavić (fq. 16)

Lundrimi i zgjatur i natës

Günter Grass (fq. 18)

Bosh dhe vetëm (poezi)

Dante Aligieri (fq. 19)

Aq hirplote ...

A. P. Çehov (fq. 20)

Dy Tregime

Robert Pinski (fq. 22)

Mitet e studios

25 vjet bashkëpunim Kadare-Onufri

ISHTE NJË TERREN I VËSHTIRË DHE VAZHDIMISHT BININ RRUFE

Nga Bujar Hudhri

Gjysmë shekulli më parë

Më kujtohet kur isha një nxënës në tetëvjeçare, mbi pesëdhjetë vite të shkuara, kur një të diel në mëngjes, i shoqëruar nga vëllai im i madh, u regjistrua në bibliotekën e qytetit. Atëherë banonim në Peqin. Libri i parë që kam marrë, e mbaj mend si tani, ishte *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*. Siç duket, titulli pati ngacmuar fantazinë time dhe e mbarova librin me një frymë. Të nesërmen, ditë e hënë, që në mëngjes shkova ta dorëzoja në bibliotekë, por e gjeta mbyllur. S'dihet sa kisha pritur te dera, kur pashë tabelën e orarit: E hënë, pushim!

Ngjarja tjetër duhet të ketë lidhje me një konkurs kombëtar të vitit 1969, ndërsa ndiqja shpalljen e fituesve në gazetën *Drita*. Më sheh im vëlla, i cili ishte atëherë student në Institutin e Arteve, dhe më pyet pse isha mërzhitur. "Kadareja nuk e mori çmimin e parë", - i thashë, thua e kisha humbur unë çmimin. - "Ja, e mori Dritëroi çmimin e parë, kurse Kadareja u afrua gjithë arrogancë të tërhiqte çmimin e tij te juria". S'di pse kjo fjalë më ngushëlloi. (Arroganca më ka mbrojtur nga sulmet e mediokërve, do të dëgjoja shumë vjet më vonë nga Kadareja.)

Ishte një rast kur mund ta takoja për herë të parë. E mbaj mend datën: 28 nëntor 1980. Kadareja me zonzën e tij po ktheheshin nga vizita në Prishtinë, ku ishte botuar kompleti i parë i veprave të tij. Në kufi kishte dalë për t'i pritur im vëlla, Feridi, atëherë redaktor në gazetën *Drita*. Ishin kthyer në shtëpinë tonë, por unë isha ushtar, ndaj nuk munda t'i takoja. Edhe sot e mbaj mend që zonzja Kadare kishte sjellë një tufë karafa të kuq nga ta Kosovës.

Do ta takoja shumë vjet më vonë Kadarenë, pasi kisha themeluar dy gazeta të pavarura, *Fjala e lirë* (16 shtator 1991-14 shtator 1992) dhe *Ku vemi* (tetor 1992-janar 1993), dhe shtëpinë botuese *Onufri*. Po ashtu, kisha instaluar një shtypshkronjë me ndihmën e një kredie të programit "Phare" të Komunitetit Europian. Mund të jetë e para shtypshkronjë në vend që përdori kompjuterin në procesin e shtypit dhe kjo na dha mundësi të konkurrojmë të gjitha shtypshkronjat shtetërore të cilat edhe disa vjet më pas do të përdornin germa prej plumbi.

Pas nja dy vjetësh *Onufri* kishte edhe një godinë ndër më të bukurat e qytetit. Ishte projektuar nga arkitekti i shquar shqiptar, Qemal Butka, i cili më vonë ka projektuar grataçela në Nju-Jork. Mbaj mend se, kur po bënim pagesën e kështit të parë, ishin mbledhur pasardhësit dhe njëri prej tyre më tha që, të kishte qenë gjallë babai, nuk do ta kishte shitur kurrë këtë godinë. Pasi pushuan diskutimet, më i madhi prej tyre u drejtua: të ishte gjallë babai, do t'ia kishte falur këtij djali për atë që po bën për kulturën! Nuk i harroj kurrë këto fjalë të cilat, mbase, do ta profilonin edhe më qartë rrugën që do të ndiqja në jetë. Po për këtë do të flasim më vonë.

Takimi i parë me Kadarenë

Isha bërë një botues i njohur tashmë. Mendoj se arsyeja kryesore ishte drejtimi që kisha marrë për botimet e autorëve shqiptarë, duke filluar me librin e parë *Abeli* të Haxhiademit, ndërkohë që pothuaj të gjithë kolegët e mi kryesorë botonin vetëm letërsi të huaj. Mbase po shtroja rrugën qetësisht drejt Kadaresë, i cili tani për herë të parë botohej nga një botues privat. Ishte shtëpia botuese Çabej, e Brikena Çabejt, vajza e profesorit të famshëm, ish-redaktore e *Naim Frashërit*. Dhe librat që ajo kishte nisur të botonte ishin modeli europian që kurrë nuk ishte parë në libraritë tona. Edhe sot janë model! Ndaj lidhja me Kadarenë më dukej edhe më e largët, aq më tepër që të dy jetonin në Paris, mund të kontaktonin shumë kollaj. Ndërkohë Kadareja po vinte më shpesh në Shqipëri dhe normalisht që botuesi duhej të ishte në Shqipëri për botimin dhe shpërndarjen e librave të tij.

Ka qenë qershori i vitit 1995 kur mund të

“

Onufrin e kam zgjedhur për botuesin tim të tanishëm dhe të ardhshëm, midis botuesve të tjerë shqiptarë. Më është dukur një botues serioz, por më kryesorja, më është dukur se në aksionin e tij të botimit nuk udhëhiqet nga etja për fitime, që për fat të keq është shumë e shpeshtë në jetën e sotme shqiptare dhe në vende të tjera të Europës Lindore, por ka edhe njëfarë idealizmi, domethënë në kuptimin shpirtëror të gjërave.

(Pjesë nga intervista e I. Kadaresë dhënë së përditshmes "Rilindja", 22.05.1996)



takoheshim, por nuk e mbaj se ç'ngatërresë ndodhi dhe u la për në vjeshtë. Përsëri një ngatërresë me orarin. Kadareja na priste në orën 14.00 në shtëpinë e tij dhe mbase kam menduar që e kisha dëgjuar gabim, sepse ishte vakt dreke. (Më vonë do të mësoja se pikërisht kjo ishte ora më e rëndësishme për të pritur vizitorët në shtëpinë e tij.) Edhe këtë herë gjithë sherrin e përballoi im vëlla, Feridi, që kishte mundur t'i mbushte mendjen të takoheshim në orën 18.00.

Por nuk qe e thënë. Përsëri u vonuam, sepse ngatërroam katin dhe u përballëm me derën e apartamentit të Dritëroit. Doli duke qeshur Sadija dhe tha se nuk është hera e parë që na ngatërrojnë me Ismailin. Zbritëm dhe hymë në dhomën e ndenjjes, një dhomë shumë e madhe, pak e ndriçuar nga dielli i pasdites. Disa minuta zgjati debati me tim vëlla, jo pse nuk janë korrekt njerëzit në këtë vend, a është i rëndësishëm ky takim për ju, pse neglizhoni etj.

Më erdhi radha mua të flisja. Pasi më pyeti se ç'botoja, i thashë se kisha vepruar si në një kampionat boksi derisa të arrija te sfidanti i duhur. "Mirë, mirë, por lëri këto tani", - dhe për herë të parë pashë se një buzëqeshje u përhap në gjithë fytyrën, kur ai ndezi një nga abazhurët. Në këtë moment im vëlla i tha: "Jepi një libër Bujarit për botim." Ai u ngrit energjikisht nga kolltuku i thellë ngjyrë bezhë, shkoi në studio dhe u kthye që andej me një libër në dorë, në frëngjisht. E vuri në tavolinë në krahun tim dhe tha me seriozitet: "Ja, ta provojmë me këtë libër." Ndërkohë Feridi nxori një stilolaps dhe ia zgjati duke thënë: "Shkruaji diçka Bujarit, ndryshe e gjitha kjo do t'i duket si një ëndërr." Ai zuri vend në kolltuk dhe qetësisht, pa e zgatur, shkroi autografin e parë dhe të fundit për mua: "Zotit Bujar Hudhri, duke i uruar suksese në punën e tij fisnike dhe si një fillim i bashkëpunimit tonë. Ismail Kadare. 14 nëntor 1995." Nuk kam asnjë foto nga ai takim!

Vizita tek Onufri në Elbasan

Kaluan gjashtë muaj dhe Kadareja u kthye përsëri në Tiranë. Ndërkohë, unë kisha botuar librin e parë *Dialog me Alain Bosquet*. Edhe pse kisha vetë shtypshkronjë, për të pasur një libër cilësor e shtypa në Itali. Cilësia e lartë, çmimi i shitjes shumë i arsyeshëm. Kështu e kam nisur dhe kam vazhduar deri më sot me të gjithë librat e Kadaresë. Shpesh kolegët më kanë tërhequr vëmendjen për këtë paradoks, por kurrë nuk kam ndryshuar dhe këtë e kam bërë për lexuesin shqiptar dhe vetë Kadarenë.

Ardhja e Kadaresë nuk ra edhe aq në sy, sepse Shqipëria ishte përfshirë nga ethet e zgjedhjeve të majit 1996. Morëm një kameraman dhe një fotograf amator për të fiksuar diçka nga kjo vizitë e papërsëritshme. Sapo u ulëm në zyrë, m'u drejtua seriozisht: "Shumë e bukur kjo godinë, por shite

urgjent dhe eja në Tiranë!” Nuk po u besoja veshëve, ndërsa vazhdoi: “Po, po, mos e zgjat.” Por nuk ishte sikur të ndërroje hotel, ndaj na u deshën tri vite të mira derisa u shpërngulëm në Tiranë. E shpejtoi këtë viti i mbarshtë ’97. Sipas mendimit tim, ky vit ndau njëherë e përgjithmonë kryeqytetin nga çdo qytet tjetër në Shqipëri. E ndieja këtë duke ardhur çdo ditë nga Elbasani në Tiranë, dhe kthim. Për tetë vjet radhazi. Por tani kisha edhe një pengesë shumë më të madhe, sepse autori im i rëndësishëm banonte në Paris, unë në Elbasan dhe duhej të komunikonim gjithmonë e më shpesh. Kur kujtoj sot ato vështirësi, humbjen e valëve të celularit pas kthesave të panumërta dhe zërin e nervozuar përtej: “Po ku je? Ç’u bëre, nga u zhduke?” Sa herë u paraqitën këto situata, të cilat e bënin të pashmangshme shpërnguljen drejt Tiranës.

Erdhi një episod që i vuri vulën gjithçkaje. Duhet të ketë qenë nëntori i vitit 1998. Kadareja kishte ardhur vetëm në Tiranë, sepse Televizioni Francez do të bënte një film për jetën e tij në kooperativën “Agimi”, në Ndërnënës, Fier. Meqenëse ishte ftohtë, ai u akomodua në Hotel Tirana. E kishim lënë të takoheshim në orën 15.00. Me sytë nga dera e hotelit se mos po vinte nga çasti në çast, mendova të pyes te recepsioni mos ndoshta kishte ardhur. Jo, nuk është brenda, m’u përgjigjën. Prita deri në orën 18.00, pyeta edhe një herë. Nuk ishte. Dhe u nisa për në Elbasan. Mbaj mend, kur mbërrita në majë të Qafë Krrabës dhe kishin nisur fllorat e para të dëborës, më merr im vëlla në celular. Ishte me Kadarenë. “Pse nuk ndenje?” - më tha im vëlla. - “A kishe lënë takim?” Mezi kam mbërritur atë natë në Elbasan dhe mora vendimin e vështirë, por jetik. Po ç’kishte ndodhur me Kadarenë? Kur u takuam në mëngjes, më tha që kishte qenë brenda dhe i kishte porositur te recepsioni të mos e shqetësonin deri në orën 18.00.

Pas tre muajsh, në mars 1999, u shpërngulëm në Tiranë dhe ky ka qenë viti më i vështirë në jetën e familjes dhe biznesit tim: fëmijët e vegjël, shtypshkronja pothuaj një vit e painstaluar në Tiranë. Por me sakrificë i tejkaluam të gjitha dhe ai vit u kthye në suksese, sidomos në Panairin e Prishtinës, në dhjetor 1999, ku Kadareja vinte pas gati njëzet vjetësh. Megjithatë, me vitet që po kalonin vija re se ardhja në Tiranë nuk ishte ndonjë ndryshim kushedi, sepse largësia bënte të vetën.

Dua të përmend një rast që nuk e kam bërë të ditur asnjëherë. Kadareja kishte ikur në Paris. Pasi kisha nënshkruar dhe parapaguar disa kontrata, duhej të nxirrnim romanin e tij të ri *Jeta, loja dhe vdekja e Lul Mazrekut*. Më vuri kushtin që çmimi të ishte 500 lekë. Ishte sikur ta falje! E shtypëm me atë çmim në kopertinë dhe një të enjte dolëm bashkë Gimin, ish-shokun tim të bankës në gjimnaz, i cili atë kohë, pasi ishte kthyer nga Greqia, bënte shpërndarësin e librave të *Onufrit*. U ktheva në zyrë dhe i rashë numrit të telefonit të Kadaresë, por nuk u përgjigj. I lashë një mesazh telefonik në sekretari: “Zoti Kadare, megjithëse binte shi, bashkë me Gimin i shpërndamë librat në gjithë Tiranën. Nesër nëpër rrethe.” Më merr në telefon të nesërmen zonja Kadare: “Bujar, veç ta shikoje Ismailin, ulur në kolltuk, e dëgjonte disa herë mesazhin tënd i lumtur.” I harrova edhe debatet për çmimin, megjithëse po regjistronim një tjetër humbje të radhës. S’kaluan veç 24 orë, kur në një darkë me disa të huaj bie celulari. Ishte Kadareja. Nuk e hapa se ishim në bisedë e sipër. Celulari nuk pushonte. “Më merr në telefon”, - më tha dhe e mbylli. Nuk e mora, thashë ta lë për më vonë, sepse nuk më pëlqeu zëri i tij. Nuk po kuptoja asgjë. Kur telefoni përsëri. U ngrita dhe e pyeta se ç’kishte ndodhur. “More, pse nuk ka libra në librari? Një shoqes së Helenës i kishin premtuar të hënë një kopje!” M’u duk sikur kjo telefonatë më ndau kokën më dysh. “Çfarë, - i ngrita zërin, - ma jep këtu Helenën, kush është ajo?” Nuk dija ç’flisja nga nervozizmi dhe e ndjeva që ai u praps dhe më tha: “Jo, nuk ta jap Helenën në telefon me këto nerva.”



4 maj 1996, me Kadarenë, përballë godinës së Shtëpisë Botuese Onufri, në Elbasan



Në ditën e 25-vjetorit të bashkëpunimit: 4 maj 2021 në Bar Juvenilja, Tiranë



Pas kthimit nga Panairi i Ulqinit, Ishull-Lezhë, 2004

Ishte viti 2002. Ato ditë niste panairi i librit dhe koincidonte me ardhjen e tij, por nuk doja t'ia dija më për të. Mora një vendim të prerë: të ndaheshim njëherë e mirë! Boll më! Nuk komunikuam fare deri ditën kur u pamë rastësisht në Rinas. Unë me time shoqe, Zanën, kishim dalë për të përcjellë një grup norvegjezësh, kur shoh që Kadareja dhe zonja e tij kishin hipur në një xhip. Ishte hera e parë që i shihja si gjithë të tjerët, sikur s'kisha asnjë lidhje me ta. I përshëndetëm me dorë dhe u nisëm pas makinës së tij. Ndërkohë u ktheva në zyrë dhe nisa të shkruaja letrën e ndarjes. Ime shoqe me lotët që nuk i pushonin dhe unë i vendosur si asnjëherë. E futa në një zarf A4 që të mos e thyjeja dhe drejt e te shtëpia e tij e re te Sky Tower. Pas 5 minutash, bie citofoni. Ishte regjisori Gëzim Kame që kishte vënë në skenë *Stinë e mërzitshme në Olymp*. U ngritëm menjëherë, s'kishim ç'të bisedonim, ardhja e regjisorit sikur e shtoi dramaticitetin. "Ke një letër këtu", - i thashë. E parandjeu. "Ç'është kjo letër?" - më tha. "Lexojeni, flasim". Dolëm, hymë në ashensor dhe drejt e në rrugë, ku kishte nisur një rrebesh shiu. Nuk kaluan pesë minuta, kur celulari: "O Bujar, kthehu, ç'janë këto? Eja flasim, ke luajtur mendsh më duket." Shpesh linja ndërpritej, shiu nuk po pushonte, gjëmime herë pas here. Vetëm ime shoqe e heshtur gëlltiste lotët mbështetur te xhami i makinës. Nuk kthehem më, i thashë. Vazhduan edhe disa biseda që ndërpriteshin mbase nga koha e keqe. Lagje të tëra pa drita, rrugët po ashtu. Nuk më hiqet nga mendja edhe sot e kësaj dite, por s'ishte ky problemi i vetëm.

Ishte planifikuar një pjesëmarrje e Kadaresë në Tetovë, por unë vazhdova me këmbënguljen time dhe nuk shkova. Dhe nuk do të shkoja, por mikësja jonë e përbashkët, Mira Meksi, me një durim e këmbëngulje të pashoqe ma mbushi mendjen. Kur mbërrita në sheshin para Pallatit të Kulturës në Tetovë, në mes të grumbullit të njerëzve shoh Kadarenë që gjithë gëzim po më thërriste. Nuk ishim përqaftuar kurrë ndonjëherë dhe me siguri ka shkaktuar habi tek të tjerët, thua se po takoheshim pas disa vjetësh. Të nesërmen ndenjëm në Strugë, dolëm buzë liqenit deri në mesnatë dhe në mëngjes u nisëm për në Tiranë. Rrugës, bashkë me menaxherin tim Fatosin, i dhashë një drekë me rastin e 10-vjetorit të themelimit të *Onufrit*, që ishte atë ditë. Ndërsa Kadareja me rastin e festës së *Onufrit* më dhuroi përgjithmonë librin tim të preferuar *Autobiografia e popullit në vargje*. Kështu nisi një periudhë e qetë, deri në stuhinë e radhës.

Ishte kompleti i plotë i veprës që na e komplikoi



Një autograf për bashkeshorten time, Suzanën, 1996

bashkëpunimin për vite të tëra. Pikërisht kurorëzimi i një bashkëpunimi që duhej të ishte krejt i natyrshëm, solli shpesh situata jonormale. Siç duket, i ndikuar nga të tjerë, shpesh hezitonte. Do të kujtoja vetëm dy javët e fundit kur do të fillonte botimi i dy vëllimeve të para. Acarime pa ndonjë shkak të dukshëm. Nervozizëm. Ditët kalonin. Ai donte të shihte letrën e kapakut të fortë, si do të ishte produkti final. Ishte një enigmë për të gjithë. Por nuk kisha qetësinë e nevojshme. Nuk e dija se ndërkohë një botues tjetër, me miratimin e njerëzve të afërm të autorit, priste që të dështonte ky bashkëpunim. Afati ishte dhënë: nëse nuk dilte vepra në panair, çdo gjë ndërpritej. Kadareja ishte i ftuar për tri ditë në Gjermani. E përcolla deri në Rinas. Nuk e di pse u tregua i dhembshur, gjë që nuk i shkonte aspak në marrëdhënien me mua, dhe më porositi që vepra të dilte sa më mirë. Që të nesërmen u nisa për në Shkup, sepse në Tiranë nuk mund të gjendej një material i tillë. U ktheva, po ashtu edhe Kadareja, i cili donte të shihte si do të dilte libri. Por si, qysh t'ia tregonim? Duhej ende punë. Dhe ja, filloi java finale. Ika në Shkup të dielën së bashku me Bledin, shoferin, që të merrnim paperkotin. Ishte ora tetë e mëngjesit, në qendër të Shkupit. Ku je, u dëgjua zëri i Kadaresë. As si je, as mirëmëngjes. Po ç'bën atje? Po ç'punë keni ju se ç'bëj unë etj. U kthyem të martën në mesnatë, përmes borës, drejt e në shtypshkronjë, ku të gjithë punonjësit po merreshin me veprën e

plotë. Në orën 17.30 u bënë gati dy vëllimet e para pas shumë peripecish. Binte shi, trafiku ishte i rënduar si asnjëherë, ndaj nisëm një shpërndarës drejt e te shtëpia e Kadaresë. Aty ishte vetëm e motra, Kakuja. Gjithë zemërim i kishte thënë se Kadarenë e kishte marrë me makinë botuesi në pritje. Ndërkohë, në stendë, disa persona po fërkonin duart, të sigurt që *Onufri* do të dështonte. Kur në orën 18.00 librat, si në një magji, ishin në stendë. Ndërsa unë nuk munda të isha i pranishëm në momentin më të rëndësishëm për një botues. Dy net i pagjumë, i parruar, i stërlodhur, ndenja në shtypshkronjë. Kur rreth orës 20.00 më mori Kadareja. Pse nuk erdhe? më tha. Nuk munda, pastaj, kishim tri ditë pa u parë dhe do të takoheshim përpara kamerave sikur po bënim teatër. "Dëgjo këtu, - më tha shumë serioz, - bravo! S'ka libra më të bukur. Veç të jesh i lig e të mos i pëlqesh. Të lumtë!" I lodhur siç isha, e ndjeva që më rrodhi një lot dhe befaz sikur u çlirova nga një barrë e madhe e një makth që s'më linte të merrja frymë.

Të nesërmen na ftoi për drekë së bashku me Zanën. Kur u afruam tek tavolina e vogël, pashë që kishte vënë dy librat dhe i shihte me një fytyrë të mrekulluar. Helena i mori pa kujdes që të shtronte pjatat, kur Kadareja i foli prerë: "Lëri aty!" Pastaj pyeti të motrën, Kakunë: "Hë, si të duken?" "Ku di unë, s'marr vesh unë", - u përgjigj ajo mbyturazi. Pastaj m'u kthye mua: "Dëgjo, Bujar. Unë jam rritur mes librave të bukur, gjithë jetën. Po s'ka libra më të bukur se këta!"

Jemi të dy në Bar Juvenilja. E martë, 4 maj 2021. Që të sigurohem marr nga tavolina faturën, ku lexoj edhe datën dhe orën e saktë - 04.05.2021; 12.45. I them se fiks në këtë orë, 25 vjet më parë, kemi nënshkruar kontratën e bashkëpunimit. Shoh që buzëqesh, është krejt i qetë dhe pret që të vazhdoj.

- Ishte një terren i vështirë dhe vazhdimisht binin rrufe! - i them.

- Po, sigurisht, çfarë prisje tjetër? Nga Olimpi vijnë vetëm rrufe! - ma kthen aty për aty.

Nuk folëm për një kohë dhe s'idi pse m'u kujtua vetja, ai fëmija dhjetëvjeçar me librin *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, përpara derës së mbyllur të bibliotekës. Befaz, ajo derë m'u bë sikur të isha para Olimpiti dhe atje në majë shihja siluetën e Kadaresë. E di shumë mirë se kurrë nuk do të mbërrij të ngjitem atje, sado të jetoj. Sepse atje është arti i madh, janë zotat dhe ne jemi shumë të vegjël para tyre. Doja t'i shprehja mirënjohjen për të gjithë këtë rrugëtim, por, i bindur se nuk do t'i shkonte ky *happy end* një shkrintari si ai, nuk ia thashë.

Faleminderit Kadare. Përjetë. *Scripta manent.*



Në shtëpinë e Kadaresë në Paris, me Jusuf Vrionin, mars 2000

In Memoriam: Guljelm Radoja (1945-2021)

GULJELMIT I KANË THËNË “KËTU NUK KA PËRSE, KËTU KA VETËM URDHNA!”

Fragment nga intervista e pabotuar me Guljelm Radojën

Nga Enver S. Morina

Naim Frashëri ishte personaliteti më i madh dhe duket personaliteti i tij u ba që të shuhen shumë gjana dhe Guljelm Radoja të ishte në filmin “Gjurma” te Kristaq Dhamos. Këtu filloj Guljelmi të lozi film...

... biseda me At Nikolla Marku në Elbasan u bë shkas që aktori Guljelm Radoja të më pres dhe të takohemi në Durrës. Takimi pranë stacionit të trenit. Guljelmi erdhi me një ombrellë, sikurse në të mund të futeshin disa veta. Ajo mbulonte jo vetëm qytetin bregdetar. Ajo kapte Shkodrën, Librazhdin, Fierin... Dhe Tiranën.

Diktafoni lëvizte rrjedhshëm, shiriti i të cilit ruante zërin e aktorit. Përgjigjet e para të njohjes si fillim, për herë të parë pas tetë vite në “ExLibris”.

11 nëntor 2013. Gjithçka gdhendej nga shiu pranë detit deri në imtësitë e vitit 1970 kur Guljelm Radoja filloj të interpretonte në film. Te “Gjurma”. Një rol episodik, emri i të cilit nuk shkruhet as në siglën e filmit. Më tej emri do t’i shkruhet Guljem e herë Guljelm dhe përsëri, si të “Nëntori i dytë”, Guljem!

Shkurtazi biografia artistike në veten e parë? Që nga roli i parë që konsiderojmë që është në vitin 1970 te filmi “Gjurma”? 35 vite në skenë, shkurt Guljelm Radoja gjatë këtyre viteve?

Guljelm Radoja është i lindur në Shkodër. Në dyzet e pestën. Rrjedhë nga një familje e vjetër që kanë ra në Shkodër në kohën e bushatllinjve prej një fshati të Dukagjinit që quhet Gimaj. Ata kanë ba kullat e tyre në një lagje që quhet Arra e Madhe, ku edhe kam le. Pra, une kam le në shpi. Se, kur kam le unë materniteti nuk funksiononte. Pra, kam le atje. Jam Radoj, prej babe nga Gimaj dhe Radovan prej nane, nga një katund afër Shkodrës që quhet Shirokë, që njëfjet si fshatë shumë i vorfën peshkatarësh dhe pijejdashës. Pra tanë njerëzit e nanës teme kanë gjujtë peshk e kanë pi raki. Kurse nga krahu i babës ishin tanë hekraxhi. Pra, duke qenë se ishin jetima, vazhduan tekniken amerikane te Harri Fulsit, edhe, dolën mekanikë nga mekanikët më të mirë në atë kohë, dy shkollat që ishin te mesme, por, ishin në përmasat e universiteteve, mos te akademive! Njëra quhesh “Instituti i Nanës Mbretëreshë”. Instituti ishte për femna, ku kanë dal personalitete te ekonomisë shqiptare dhe teknike amerikane e Harri Fulsit që dolën inxhinierat e tekniket më të mirë në Shqipëri, por që ai djali i bukur prej Gjirokastre, i futi në burg, i pushkatoj tanë. Bahet fjalë për adashin tan prej Gjirokastre!

Pasioni im në jetë ishte muzika. Im atë duke qenë se ishte hekraxhi, dhe kishte pasion hekrat, donte që edhe i biri të bahesh hekraxhi. Dhe kur mbarova gjimnazin, pra, nuk më la me shku në Liceun Artistik, që kisha qejf me shku. Në shkollë artistike për muzikë, nuk më la! Por, kjo dëshirë për muzikën dhe dashuri për muzikën u konkretizua ma vonë në rininë teme kur unë rashë në dashni me një muzikante, violonçeliste, dhe ajo malësore. Maloke, prej një vendi që e kena kojshi. Është krahu i tjetër i malit quhet Nikaj-Mërturi ose Lekëbibaj. Pra rashë në dashni me violonçelisten më të cilën u martova. Edhe kam dy fëmijë, që janë të dy muzikantë. Kam dy mbesa, të cilat edhe ato janë muzikante. Pra, im atë nuk desh që unë te bahesha muzikantë por në shpi teme u pushtua nga muzikantë, me grua, më fëmijë, e me mbesa. Kur mbarova gjimnazin, im atë më bëri alternative, o në teknike, në politeknikum për mekanik, ose në gjimnaz. Sigurisht shkova në gjimnaz. Dhe aty, në maturë mbasandej, ja bana tetëshin babës, i ika tutelës, i bana një pabesi t’vogël dhe shkova në konkurs dhe dhashë në shkollën e aktorëve. Im atë u zemëru. Nuk më foli gati një vit. Dhe një ditë të bukur, dy miqtë e tij, ishin edhe miqtë e mij, njënin prej tyre e kam pas edhe pedagog. Prokop Mima dhe Sander Prosin, i thonë babës: “Po hajde shife djalin, mos i mbaj inat. Djalin e ke te talentum!” Kështu im atë filloj me ardhë në teatër, po sigurisht nuk i përkiste asaj kategorie teknikesh që sikur t’kishin naj mendim të mirë për artin, sepse nuk quhesh zanat. Këtë mendim e ka pasur edhe ish- kryeministri i Shqipërisë Mehmet Shehu. Nuk ishin zanat për të, i quanin punë qejfi.

Nuk ishte mjeshtëri?

Pra nuk ishte mjeshtëri. Ishte dava qejfi, punë çiftelie me një fjalë. Por vinte në teatër dhe i thonte atij që e kishte afër, o majtas, o djathtas, i afrohej dhe i thonte: “A e shef atë djalin atje që loz në teatër? Është djali jem ai!” Kështu që mbarova vitin e parë dhe

të dytë. Në vit të tretë, ndodhi ajo që tre institute bashkohen në një. Pra tre shkolla bashkohen në një. Shkolla e naltë e aktorëve “Aleksandër Moisiu” që ishim na, Instituti i Arteve figurative, që ishin artet figurative në vete, dhe Konservatori Shtetëror i Tiranës, ishte prapë në vete. Në ishim në oborrin e Teatrit Kombëtar dhe Konservatori ishte në oborrin e Operas dhe Baletit. Pra, s’më kujtohet rreth viteve 1965, 1966 më duket u krijue Instituti i Lartë i Arteve. Opera iku prej andej ku ishte dhe shkoi në godinën e re. Godinën e ish Operës së vjetër e mori Instituti i Lartë i Arteve ku u mblodhën gjithë këto. U krijue edhe një fakultet i katërt që quhesh në atë kohë simbas influencave ruse, Shkolla e Kulturës, që përgatiste kadro masovike kryesisht për vatrën e kulturës dhe shpiti e kulturës.

Në këtë kohë njihem më gruan teme, ajo studente në konservator për violonçel. Meqë im atë ma kishte stimuluar gjithmonë këtë që, meqë një vajza, me tu mush mendja për najnjenën, bjere babës në shpi! Unë jam djalë i vetëm, skam motër, s’kam vëlla. Baba ma stimuloj këtë lidhje për këtë garanci që unë të lidhësha herët. Dhe i thash një ditë që unë e gjeta. Ma sill në shtëpi, babës! Kështu që atë që vendosa më u feju, mëzi gjeta dy pako llokume, në atë kohë ishte vëshirë shumë më gjetë gjana për me e qerasë dynjanë, dhe shkova në kurs tem. Kursi jem në historinë e shkollës ishte kursi më i madh numerik, nëse kursi sot ka degjëruar e mëzi plotësohen 12 veta, në atë kohë ishim 36 vet. Dhe kena konkurrenca mbi 500 vet. Shpërndau llokume dhe ju thash më uroni se jam feju. Isha më i vogli i kursit në moshë. Kishim në kurs edhe njerëz, djem e vajza që ishin shtatë, tetë vjet më të mëdhenj se unë. Do ma uruan, do u tallën me mu. Nejse. Të nesërmen kryeplaku i kursit, kemi pas Shëri Mitën, që e kam pas shokë klase. Më thotë: “Guljelm shko se të kërkon sekretari i partisë!” S’kisha pas punë ndonjëherë me parti. Në shtëpi tanë ishin te departizum. Bile nën vendi e urrenin atë sistem. Shkova të ai. Kush ishte ky njëri tashi?! Ky njeri quhesh Sofokli Buda. Nga mbiemri mund të të kujtoj Aleks Budën, një burrë fisnik, nga burrat që drejtuan Akademinë e Shkencave Shqiptare, me studime të kryeme në Austri, edhe më kulturë gjermane. Por ky ishte njeri i lig ... (...)

Më thotë mua: “Ishe fejuar ti a?”

“Po, i thash, me mendimin se po m’uron.”

“Po je menduar mirë që je fejuar ti?”

“Po përderisa jam feju, i thash, sigurisht që jam mendu.”

“A e din që ti ke marr për gru, tha, çupen e armikut të popullit?! Pra, vajzën e armikut të popullit?”

“Unë e di, thash, që kam marr vajzën, nuk e di që paskam marr babën!” Priti pasojat Guljelm Radoja nga unë!

I the drejtpërdrejt!

Po, po drejt! Turijve! Dhe pasojat qenë të llahtarshme! (...) Unë nuk kisha problem me biografinë. Baba mekanik punonte në uzinë në atë kohë... Po mirë, thash, në qoftë se ka pasoja do i presim. Dhe pasojat ishin të tmerrshme. Pra, unë u martova student, u bana prind-student. Pra, në historinë e universitetit shqiptar, që ndofta qifti i parë që u martum dhe u bam prind student.

Një qift artistësh?

Po. Dhe emnimi i parë që në Librazhd. S’kisha nga të luajtshat! Thash: Lavdi partisë n’Librazhdë! Na zuri ne. Në atë kohë ishim kursi i parë që u ekspperimentu, ne në atë kohë i thoshim në terminologjinë ruse zbor, por ishte shërbim ushtarak gjashtëmuor. Shërbim ushtarak që do të diplomoheshim oficerat në rezervë. Kështu që unë mbeta gjashtë muaj në Burrel pa marr një ditë leje!

Në Burrel!?

Po në korpusin e Burrelit, që sot bile ishte një lajm, një nga personalitetet ushtarake të asaj kohe, në atë kohë ishte komisar i korpusit të Burrelit, quhesh Halim Ramohito. Sot varroset se kishte dek dje. Pra, këtu filloj ajo spirale në universon në jetën time si njeri dhe si aktor, si artist. Çka të bësha në Librazhd? Regjisor i shpisë së kulturës?! Megjithatë u tregu burrë një kryetar komiteti, mbasi ju luta unë, ju lut im atë, ju tha e kam djalë të vetë, ju lut shumë, ministrit të asaj kohe Thoma Delianës që ishte një burrë shumë fisnik dhe më transferuan në Tiranë. Erdhëm në Tiranë. Dhe ne në atë kohë kishim nomenklaturë të dyfishtë për sa i përket trajtimit si kuadër. Kishim dhe trajtimin nga komiteti ekzekutiv, por kryesisht nga komiteti i partisë. Dhe personi që mua ma nxivi jetën, i cili në vitet 90-ta na mbante flamurin e disidentit... (...)

Ky ta nxu jetën?

Më mbajti gjashtë muaj në ajër. Pra unë bana rolin e parë kryesor në jetën teme si aktor i teatrit Kombëtar, ose në atë kohë quhesh Teatri Popullor, një dramë e shkurtër enkas për ushtrinë, nga Bashkim Kozeli, dhe unë kam luajtur rolin kryesor, një aviator, ushtar. Erdh gjithë byroja politike e pa çfaqjen përveç Enver Hoxhës dhe Mehmet Shehut. Punova gjashtë muaj në teatër dhe nuk mpaguejshin rrogën. Atëherë ka qenë koha më e mjerueshme e familjes teme, që jetojshim vetëm me rrogën e babës. Dhe Fadili i përdridhte dokumentat e mija, ja se do të aprovohen sot, ja do të aprovohen nesër dhe dokumentat e mija nuk u aprovuan, dhe një ditë të bukur të marsit të vitit 69-të, mua më pret Komiteti i Partisë i Tiranës.

Dhe më thotë: “Ju nuk pranoheni në Tiranë!”

“Po perse, i thashë unë!”

“Këtu nuk ka përse, këtu ka vetëm urdhna! S’ka, se pse!”

Në këtë kohë profesori jem, ai që më deshti fort, nga i cili unë u bana aktor, Naim Frashëri i madh, ishte në atë kohë anëtar i Byrosë së Partisë në teatër, më thotë: “Unë nuk kesh i zoti më të nimu mor bir, me nejt në Tiranë, a po don me luft film?”

Thash: “Profesor! Me biografinë që doli, që babai i gruas ka qenë në burg politik...!”

“Atë e di unë. A po don ti?”

“Po more burrë i dheut.”

Dhe më mori me vete të filmi “Gjurma”. Naimi ishte personaliteti më i madh dhe po duket personaliteti i tij u ba që të shuhen shumë gjana dhe Guljelm Radoja të ishte në filmin “Gjurma” te Kristaq Dhamos. Këtu filloj Guljelmi të lozi film...



Roli i parë në filmin “Gjurma” (1970)

GAZETARËT SHQIPTARË NËN REGJIMIN MONIST

Nga Ardita Reçi

Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët

Gazetarët janë një kategori e veçantë profesionale, të cilët e ushtrojnë profesionin e tyre nën trysni dhe ndikime të ndryshme të faktorëve socialë, ekonomikë, politikë, shoqërorë, etj. Siç thonë e studiuesit shqiptarë Hamit Boriçi, Bashkim Gjergji, Genc Tirana dhe Sadri Ramabaja në librin e tyre "Gazetaria 1": "Profesioni "gazetar" ka ngjyra e ngarkesë politike, ideologjike e shoqërore; ai përmban angazhim me përgjegjësi të lartë. Ai nuk është as nuk mund të jetë vetëm një "instancë transmetimi", një përcjellës i thjeshtë në publik i lajmeve, i ngjarjeve apo i ndodhjeve të jetës përmes gazetës, radios apo televizionit. Gazetari profesionist vlerëson politikisht çdo fakt, gjykon për vlerat e tij dhe e interpreton atë, duke u shprehur edhe qendrimit vetjak". Sado që kërkohet objektivitet dhe paanshmëri në transmetimin e informatave tek publiku, në shkollat e gazetarisë pranohet se vetë ndërmjetësimi që bën gazetari në transmetimin e realitetit është subjektivizëm. Duke qenë kështu, brenda gazetarit formohen praktika të ndryshme të ushtrimit të këtij "zanati", të cilat janë shumë të ndryshme prej luhatjeve të elementeve politike të ambientit që e rrethon, të tilla si vetëcensura. E për më tepër kur bëhet fjalë për ushtrimin e gazetarisë në kushte të veçanta siç janë regjimet totalitare, ku ky profesion merr një rëndësi të madhe për vetë sistemin.

KONSIDERATA MBI GAZETARËT

Sociologu i mediave Michael Schudson thotë se gazetaria nuk qëndron dot larg politikës dhe është një element i saj, por "për ta kuptuar gazetarinë si një pjesë të politikës, duhet të tregohemi mëndjehapur, duke pranuar që kultura të ndryshme politike dhe institucione të ndryshme politike i japin formë dhe strukturë lajmeve". Ndërsa Max Weber, edhe pse e ka të vështirë të bëjë një përcaktim të saktë shoqëror, gazetarin e rendit si një nga figurat politike të një shoqërie të caktuar: "Ajo që gazetari ka të përbashkët me demagogun dhe me avokatin (dhe artistin), sipas Weber, është mungesa e një klasifikimi të caktuar shoqëror", - më tej shton: "Natyrshisht çdo politikan e ka ndërjetë nevojën për të ndikuar në shtyp dhe si rrjedhim ka ndërjetë nevojën edhe për lidhje me të". Në këtë marrëdhënie, që Weber e shpjegon se hallka lidhëse me më shumë ndikim janë gazetarët, të cilët përveç aftësive dhe formimit të tyre (të nevojshme për ta ushtruar këtë lloj profesioni), kanë edhe mundësi reale për t'u përfshirë në jetën politike të një vendi. Ai mendon se karriera e gazetarit mbetet një nga rrugët më të suksesshme të veprimtarisë profesionale politike, pasi: "Ajo nuk është një rrugë që mund ta ndjekin të gjithë, dhe për më tepër, për karakteret e dobët, veçanërisht për njerëz që mund

të ruajnë ekuilibrin e tyre të brendshëm vetëm me një pozitë të sigurtëstatusi".

GAZETARIA DHE TOTALITARIZMAT

Colin Sparks vëren në librin e tij "Komunizmi, kapitalizmi dhe mass-media", se në vendet totalitare: "Puna e gazetarëve ishte që të shpëgonin, të edukonin e të ndihmonin me shkrimet e tyre për të fituar mbështetje për ndërtimin e botës socialiste".⁵ I njëjti aktor i komunikimit masiv, ndryshe konsiderohej në Lindjen komuniste e ndryshe në vendet perëndimore të asaj periudhe. Ndërsa në Perëndim: "...detyra e gazetarit ka të bëjë më tepër me regjistrimin e ngjarjeve se sa me përzgjedhjen dhe interpretimin e tyre",⁶ të tjera konsiderata ka në Bllokun Lindor për të njëjtin personazh të jetës publike, aty: "Prirja e ndërgjegjshme, me të cilën kuptohet përzgjedhja e njohur dhe ndërtimi i materialit për të provuar një pikëpamje të veçantë mbi botën, ishte parimi organizues i shtypit komunist".⁸ Një ndër detyrat e medias së modelit perëndimor siç pohon studiuesi Claude-Jean Bertrand, është edhe lufta kundër krimeve, abuzimeve me pushtetin, dhe korrupsionin. "Lufta kundër korrupsionit dhe krimeve të tjera bën të nevojshme një media të pavarur dhe të lirë".⁹ Për këtë qëllim, edhe media, sipas parimeve perëndimore profesionale, duhet të jetë e pakorruptuar dhe zbatuese e rregullave të etikës, në mënyrë që të gëzojë besimin e publikut dhe të ketë ndikimin tek ai. Claude-Jean Bertrand, thotë tek libri Deontologjia e mediave, se "regjimet komuniste zhdukin lirinë e sipërmarrjes duke pretenduar se e lejojnë lirinë e të shprehurit. Rezultati është se: Shtypi i gjymtuar shndërrohet në një instrument budallalëpsjeje dhe indoktrinimi".¹⁰

GAZETARËT GJATË RREGJIMIT KOMUNIST SHQIPTAR

Siç e theksojnë edhe studiuesit Hamit Boriçi dhe Mark Marku: "Regjimi i ri e filloi sundimin e tij të gjatë në Shqipëri, duke ndaluar botimin e çdo organi alternativ të shtypit... Gjithashtu gazetat e revistat që botoheshin jashtë vendit, siç qe p.sh., gazeta "Dielli" e Bostonit, nuk u lejuan të hynin në Shqipëri. Qeveria komuniste ndërkohë ndaloi edhe botimin e organeve të reja të shtypit, që nuk kontrolloheshin nga qeveria. De facto, që prej nëntorit të vitit 1944 në Shqipëri nuk ekzistonte e drejta e pronësisë private mbi

shtypin"¹¹ Sipas një raporti të mbajtur në emër të Qeverisë Demokratike, në sesionin e tretë të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar – 26 shtator 1945, "Në Sektorin e shtypit dhe të propagandës", del se ishte krijuar organizimi "Sektori i shtypit dhe i propagandës".¹² Rrjeti i shtypit të shkruar, tashmë krejtësisht nën kontrollin e shtetit edhe nëpërmjet këtij sektori, shtrihet shumë shpejt në të gjithë vendin.

Një pjesë e mirë e ngjarjeve të historisë së gazetarisë shqiptare të periudhës komuniste, duket se janë përsëritje pa hequr as pikë e as presje nga ndikimet e gazetarisë së modelit leninist, të ushtruar në Bashkimit Sovjetik. Duke filluar që nga konceptimi i shtypit në shërbim të Partisë, si i vetmi përfaqësues i proletariats, shtetëzimi i të gjitha pronave të shtypit: "Marrja e kontrollit kalon së pari nga shtetëzimi i të gjitha pronave të shtypit dhe zbatimi i një censure parandaluese për të siguruar që vetëm e vërteta – ajo e Partisë – të bëhet publike. "E vërteta" është për më tepër emri në rusisht i gazetës së vetme të autorizuar që në 1917 me ardhjen në pushtet të Sovjetikëve, Pravda"¹³; e deri tek konsideratat për gazetarët, të cilët "kanë një mision të vet, të përsërisin me terma lavdërues direktivat e Partisë"; si dhe përcaktimi i misionit të shtypit. Pas rëndësisë që Lenini i dha shtypit për dy arsye kryesore: "shtypi duhet të jetë një instrument agitacioni dhe propagande për të mbajtur lart pa pushim vrullin revolucionar, ai duhet të jetë gjithashtu rrip transmetimi ndërmjet përfaqësuesve të Partisë dhe popullit"¹⁴, - të njëjtën rrugë ndoqën të gjitha politikatat drejtuese të vendeve të bllokut të Lindjes. Ata jo vetëm propagandonin me mediat e tyre "arritjet" e vendit përkatës dhe të mirat e kursit politik të ndjekur prej tyre, por edhe trasmetonin mesazhet nga Partia tek populli, duke u dhënë kështu rolin e komunikatorit, jo gazetarëve, por vetë përfaqësuesve të Partisë, siç thonë studiuesit edhe për rastin shqiptar, ku shkrimet direktiva, synonin të orientonin vëmendjen e popullit për nga drejtimi korrekt me vijën e partisë, ishin të hartuara në zyrat më të larta të nomenklaturës së Partisë.

Të gjitha komunikimet publike kontrolloheshin nga partia – shtet, që në mënyrë paradoksale deklaronte formalisht lirinë e shtypit, madje kjo sanksionohej edhe në "Ligjin për shtypin", i botuar në vitin 1947, ku në nenin 1 thuhej; "Shtypi në Republikën e Shqipërisë është i lirë. Me përjashtim të rasteve të parashikuara nga ligji, çdo njeri është i lirë të shprehë mendimet e veta nëpërmjet shtypit".

Kontradikta brenda këtij përcaktimi, lidhet me idenë e mësipërme se i gjithë sistemi i mediave të kohës konsiderohej si "pronë" e udhëheqjes komuniste. Për këtë, studiuesi Artan Fuga në botimin Monolog, thotë se: "Shtypi i shkruar dhe mediat zyrtare të vetmet që ekzistojnë, përbëjnë elemente të sistemit politik autoritar. Mediat transmetojnë ato mesazhe informative që ofron vetë pushteti dhe, pasi ia kalojnë publikut, vetë pushteti prej të cilit varet i kthen jehonën që ky kërkon të dëgjojë. Asnjë lajm, koment a korrespondencë nuk duhet të jetë kaotike, spontane dhe aq më pak të vijë në kundërshtim me ideologjinë dhe me vijën politike sunduese"¹⁵. Fuqia propagandistike e medias e kuptuar që herët nga drejtimi komunist i vendit (që me lëvizimin e shtypit ilegal gjatë Luftës), vlerësohet shumë herët. Në "Raportin mbi aktivitetin dhe detyrat e reja të Frontit, mbajtur në mbledhjen e dytë të Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik"¹⁶, të datës 7 tetor 1946, thuhet: "... Shtypi të shpërndahet dhe të lexohet nga të katër anët dhe ky të jetë një shtyp jo vetëm informativ, por sidomos edukativ dhe të pasqyrojë jetën dhe frymën e re..."¹⁷.

KARAKTERISTIKAT E PUNËS NË SHTYPIN E KOHËS

Në vitet e komunizmit shqiptar 1944-1990, me termin shtyp, përcaktohej i tërë sistemi i komunikimeve masive përmes mediave. Cilësimi që i bëhej në atë kohë këtij shtypi, nga organizuesit dhe studiuesit e tij, ishte se ky qe një "shtyp i tipit të ri, revolucionar". Enver Hoxha shkruante: "shtypi ynë revolucionar u bë, ashtu siç thoshte Lenini i madh, pjesë e çështjes së përgjithshme të Partisë, pjesë e çështjes së

11 Boriçi,H.; Marku,M.(2010):Historia e shtypit shqiptar, nga fillimet deri në ditët tona, SHBLU,T.,fq. 232.

12 Partia e Punës e Shqipërisë për shtypin, Shtëpia botuese "8 Nëntori", Tiranë, 1980, fq. 72.

13 Balle, Francis (2011): Mediat dhe shoqëritë, Botimet Papirus, Tiranë. Fq. 254.

14 Balle, Francis (2011): Mediat dhe shoqëritë, Botimet Papirus, Tiranë. Fq. 254.

15 Fuga, Artan (2010): Monolog, Dudaj, Tiranë, fq.

16 Shënim: PKSH fshihej pas Frontit Demokratik deri më 1948.

17 Partia e Punës e Shqipërisë për shtypin, Shtëpia botuese "8 Nëntori", Tiranë, 1980, fq. 47.

1 Grup autorësh (2000): Gazetaria 1 – Njohuri të përgjithshme, ShBLU, Tr., fq. 127.

2 Schudson M.,(2003): The Sociology of News, New York, Norton&Company, New York, L., p. 166.

3 Weber, Max (2004): Studime sociologjike, botimet Plejad, Tiranë, fq. 166.

4 Weber, Max (2004): Studime sociologjike, botimet Plejad, Tiranë, fq. 166.

5 Weber, Max (2004): Studime sociologjike, botimet Plejad, Tiranë, fq. 166.

6 Sparks, Colin (2001): Komunizmi, kapitalizmi dhe mass-media, ISHM, Tiranë, fq. 81.

7 Sparks, Colin (2001): Komunizmi, kapitalizmi dhe mass-media, ISHM, Tiranë, fq. 81.

8 Sparks, Colin (2001): Komunizmi, kapitalizmi dhe mass-media, ISHM, Tiranë, fq. 81.

9 Bertrand, Claude-Jean (2007): Deontologjia e mediave, ISHM, Tiranë, fq. 7..

10 Bertrand, Claude-Jean (2007): Deontologjia e mediave, ISHM, Tiranë, fq. 7.

përgjithshme të proletariatit. Traktet dhe gazetaret tona shpënë në popull fjalën e zjarrtë të Partisë dhe ngritën njerëzit peshë në luftën kundër pushtuesve fashistë e tradhëtarë të vendit. Jo më pak se nga armët partizane armiku tmerrohej nga shtypi ilegal¹⁸. Pra shtypi, duhej konsideruar si armë e fuqishme kundër armikut. Sipas leksioneve mbi komunikimin bindës dhe propagandën të Mark Markut¹⁹: Çdo propagandë e ka nevojën e një armiku dhe në momentin që nuk e ka, e shpik atë. Denigrimi i “armikut”, është dy llojesh: 1) Diskretitimi i personit. 2) Sulmi ndaj vlerave që përfaqëson individi apo aktiviteti i tij”. Ideja për t’i dhënë sa më shumë fuqi shtypit që drejtonte e për ta riorientuar audiencën e tij që ta lexonte e besonte atë, Hoxha tenton të shpikë armiq të dobët e frikacakë, që tmerrohen nga media e kontrolluar dhe orientuar prej tij. Duke patur në mendje gjithnjë “armiqtë”, e në shërbim të mbajtjes në këmbë të këtij rregjimi, shtypi i kohës organizohej në atë mënyrë që përmbajtja dhe brendia ideopolitike e tij të ndiqnin vazhdimisht këtë vijë logjike. “Ai është shtyp i masave dhe për masat, tipar thelbësor që e dallon atë nga shtypi i mëparshëm shqiptar. Prandaj detyra e tij ishte, që në ditët e para të jetës së tij, propagandimi i ideve luftarake të Partisë për çlirimin kombëtar e shoqëror nga zaptuesit e huaja e tradhëtarët e vendit²⁰”.

Akademiku Artan Fuga, thotë se sistemi i informimit masiv në shoqëritë totalitare është ndërtuar në mënyrë hierarkike. “I ndodhur mes kulmit të piramidës së pushtetit dhe lexuesit, gazetari lëkundet mes të dyve, anon edhe nga pushteti por edhe nga masa e qytetarëve nga individët anonimë, vështirësisht të kontrollueshëm në idetë, bindjet, pakënaqësitë, lidhjet e tyre shoqërore”. Sipas Fugës, gazetari i asaj periudhe ishte edhe njëfarë nëpunësi i mesëm, por edhe një individ i thjeshtë si gjithë të tjerët, i cili, sa më lart që të vështrohej, aq më tepër ai do të trajtohej si një individ anonim, si një vegël e thjeshtë në përdorim, si një njeri të cilit pushteti nuk i beson tërësisht, por ushqen edhe dyshime ndaj tij, e mban edhe në njëfarë kontrolli të përditshëm²¹. Ndërsa në pozicionin e tij si një njeri i thjeshtë apo nga një kuadër i ulët apo i mesëm i administratës së partisë apo shtetit, shfaqet si instrument i pushtetit dhe njësohet me të. Nga ky këndvështrim i fundit, gazetari ka mbrojtjen e të fuqishmëve të kohës, është i njëjshuar me pushtetin dhe shihet me mosbesim nga grupe të ndryshme shoqërore, nga masat e gjera popullore dhe nga nëpunësit²². Me një fjalë, gazetari është një person që merr goditje nga pushteti, por edhe jep goditje në emër të pushtetit, ideologjisë dhe politikës në fuqi. Edhe është i dobët, pra mbahet nën kontroll, por edhe është i fuqishëm dhe ushtron kontroll e trysni mbi të tjerët.

Konsideratat për gazetarin e kohës që vinin nga brenda sistemit mediatic të kohës, e vinin të parën si karakteristikën më të rëndësishme të kësaj figure partishmërinë, e cila renditej si e para në tipizimet profesionale. Atëherë ku thuhej se gazetari është së pari: “... Njeri me partishmëri të lartë, besnik i çështjes së popullit dhe të Atdheut...²³”

Siç ka konkluduar në studimet mbi këtë periudhë kohore edhe Godole: “... Sistemi mediatic ishte tërësisht në shërbim të pushtetit duke ndihmuar me anë të propagandës në ruajtjen e status-quo-së dhe në ndërtimin e një realiteti që nuk përputhej me aktualitetin²⁴”

E rëndësishme është të theksohet një tjetër aspekt i propagandimit në mediat shqiptare të kohës: Propagandimi i Shqipërisë së suksesshme në sytë e botës dhe informimi i të huajve se modeli i rrokur prej saj ishte më rezultativ.

Krijimi i këtyre imazheve në sytë e botës, bëhej nëpërmjet përdorimit të të gjitha teknikave propagandistike, duke krijuar kështu një botë imagjinare, siç mendonte Arendt. “... Me përgjithësim të tilla, propaganda totalitare krijon një botë të përshtatshme për të konkuruar me botën reale, pengesa kryesore e së cilës është se ajo nuk është logjike, e qendrueshme dhe e organizuar. Qëndrueshmëria e trillit dhe pikëpamja e organizimit e bëjnë atë të mundshme për përgjithësim, eventualisht që të mbijetojë shpërthimin e gënjeshtrave më të veçanta... Sapo këto parulla propagandistike integrohen në një “organizëm të gjallë”,

18 Enver Hoxha – *Vepra*, vëll. 26-të, f. 313-314

19 Mark Marku, *Leksion mbi Komunikimin Bindës*, në Departamentin e Gazetarisë dhe Komunikimit, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës, viti akademik 2014-2015.

20 Boriçi, Hamit, (1986): *Redaksia dhe puna e gazetarit, Teoria dhe praktika e shtypit popullor*. Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Politike dhe Juridike, T., fq.7.

21 Fuga, Artan (2010): *Monolog*, Botimet Dudaj, Tiranë, fq. 175.

22 Fuga, Artan (2010): *Monolog*, Botimet Dudaj, Tiranë, fq. 175.

23 Boriçi, Hamit (1986): *Redaksia dhe puna e gazetarit, Teoria dhe praktika e shtypit popullor*, Universiteti i Tiranës, fq. 63.

24 Godole, Jonila (2014): *Gazetaria shqiptare në tranzicion*, Papirus, Tiranë, fq. 61.



ata sigurisht s’mund të eliminohen pa prishur të tërë strukturën²⁵. Ideja e Arendt ishte se në sistemet totalitare përcimi i propagandës bëhet në mënyrë të organizuar dhe transmetimet e saj ndikojnë në krijimin e një strukture që mbahet tek ideologjia e sistemit dhe lëvizjeve totalitare. Edhe në shtypin shqiptar të kohës, kishte organizim, si brenda edhe jashtë sistemit mediatic. Orientimet dhe këshillat e vazhdueshme të Partisë dhe organeve në varësi të saj, ndikonin në punët e këtij sistemi.. Përveç komunikimeve të përditshme, i kushtohej kujdes i veçantë aktiviteteve kolektive, gjithnjë nën kujdesin e Komitetit Qendror, të Byrosë Politike, etj.

Kur flet për dallimet mes dy blloqeve të Luftës së Ftohtë, Gabriel Partos thotë se: “Shpejtësia e njoftimit përbënte një tjetër cilësi që zyrtarizmi sovjetik nuk e çmonte²⁶. Duke folur për mangësitë në korrektesën kohore të transmetimit të informacioneve në bllokun lindor, Partos e trajton si të mirënjohur tiparin zyrtar të shtypit të modelit sovjetik. Ndërsa Qamil Buxheli (në një si qarkore) kritikon fjalitë urdhërore me “duhet”... “Jam i mendimit se si “shkrimet relacione” dhe shkrimet “qarkore”, ku jepen “udhëzime” e “receta”, “porosi” për gjithçka dhe për të gjithë njësoj nuk duhet të kenë vend në shtypin tonë dhe duhen parë si miell nga thesi i praktikës burokratike, nga thesi i zyrtarizmit”.²⁷ Ky fenomen në fakt, në dukje goditej jo pak herë, edhe pse e shoqëroi deri në fund atë sistem mediatic, për vetë faktin se duke mos arritur ta kritikojë burokratizimin e vendit, gazetari binte në pozita konformizmi, siç thotë Fuga (Fuga, 2010). Në librin *Gazetaria shqiptare në tranzicion*, studiuesja Jonila Godole, kur paraqet trashëgiminë e sistemit mediatic të formësuar gjatë periudhës së komunizmit, pasi thotë se: “Të gjitha aktivitetet partiake, kongreset, plenumet e rëndësishme, dhe sidomos fjalimet e Enver Hoxhës, botoheshin të plota në shtyp dhe transmetoheshin në radio dhe televizion, - citon (Coman 1994: 82), - Në këtë aspekt, gazetarët nuk dallonin shumë nga burokratët partiakë, madje Coman, për të vënë në pah ngjashmërinë mes tyre, përdor termin “burokratët e të vërtetës”.

Në redaksitë e mediave shqiptare të periudhës komuniste, bëheshin mbledhje të cilat paracaktonin detyrat e secilit prej gazetarëve dhe korrespondentëve të terrenit, se çfarë teme do të trajtonin, duke planifikuar kështu paraprakisht punën dhe materialet që do të sillnin ata me vete për botim. Rastësia nuk ishte rutinë e punës. Siç pohon Fuga, për gazetarët nuk ishte jeta që e shtynte gazetarin të bënte punën e tij, “por janë temat e përcaktuara nga vetë gazetarit ato që përcaktojnë, sipas kësaj ideje, agjendën e mediave. Pra gazetari ndodhet në terren jo për të vëzhguar dhe analizuar faktet dhe ngjarjet e aktualitetit, por thjeshtë për të vërtetuar një mendim paraprakisht të strukturuar, për të përmbushur një lëndë empirike një temë tashmë të strukturuar në mendjen e tij²⁸..

Rëndësinë që merrte shtypi në përcimin e mesazheve

25 Arendt, Hannah (2002): *Origjinat e totalitarizmit*, Dija, Prishtinë, fq. 465.

26 Partos, Gabriel (1994): *Bota që erdhi prej të ftohtit*, Çabej, Tiranë, fq. 97.

27 “*Tribuna e Gazetarit*”, nr. 1 (42) 1971, Tiranë, fq. 19.

28 Fuga, Artan (2010): *Monolog*, Botimet Dudaj, Tiranë, fq. 127.

politike, drejtuesit komunistë të shtetit e kishin kuptuar që me lëvizimin e formave ilegale të shtypit që do të drejtonin më vonë, kur Lufta e Dytë Botërore nuk kishte mbaruar ende. Në një letër, drejtuar “Zërit të Popullit” në dhjetëvjetorin e themelimit të këtij organi, më 24 gusht 1942, riformulohet mendimi: “Gazeta duhet të bëhet gjithmonë një agjikator më i fuqishëm, një propagandist i flaktë dhe një organizator kolektiv më i mirë i masave tona punonjëse...”.²⁹ Vite më vonë, ky mendim nuk ndryshoi, përveç se u përforcua ashtu siç u shtri edhe rrjeti i mediave, tashmë të ligjshme dhe nën drejtimin e njohur të politikës shtetërore. Në vendimin e Vendimi i Pleniumit të Komitetit Qendror të PPSH “Mbi punën ideologjike të Partisë dhe masat për përmirësimin e saj”, të datës 27 prill 1955, pasi deklarohet se: “Shtypi, radioja dhe botimet si armë të fuqishme të agjitacionit e të propagandës dhe të organizimit të masave për ndërtimin e socializmit, janë zgjeruar dhe forcuar mjaft. Ato kanë luftuar me sukses për edukimin dhe mobilizimin e masave për zbatimin e detyrave të ndërtimit ekonomik dhe kulturor të vendit, për mbrojtjen e lirisë e të pavarësisë kombëtare... Por me gjithë këto përmirësime, niveli ideologjik i shtypit është i ulët, ai nuk tërheq vëmendjen në çështjet kryesore dhe roli organizator i tij nuk ndihet sa duhet³⁰. Nëpërmjet organizimit kolektiv që duhej të realizonte shtypi, radioja dhe televizioni, ata duhej të ndihmonin në formimin e kuadrove të reja të partisë, që do të thotë me pak fjalë se materialet që publikoheshin aty kishin brendi të theksuar politike. E për këtë faji shpesh u vihej gazetarëve, të cilët deri sa nuk e realizonin mirë detyrën e tyre, kjo përkthehej se nuk kishin formim të mirë ideologjik, ndaj duheshin korrigjuar...

Në mediat shqiptare të asaj periudhe mund të pasqyroheshin vetëm ngjarje, fenomene apo modele pozitive. Më qëllimin e deklaruar (justifikimin) “që të mos u japim material mediave të huaja”, dhe në fakt për të mos pranuar të metat e dobësitë e vetë sistemit, në shtypin shqiptar të kohës nuk flitet për realizim e mosrealizim të tregëtinë e jashtme, “papunësi” apo “inflacion”, por as nuk raportohet “nga salla e gjyqit”. Ndaj dhe kur flet për faktet mediatiche, Fuga thotë: “se ato ishin në përputhje me ideologjinë, politikën dhe propagandën në fuqi. Të gjitha faktet e tjera, sado reale të jenë, sado interesante, nuk mund të transformohen nga fakte realiteti në fakte mediatiche³¹. Ndrësia Boriçi që për shumë vite ka drejtuar gazetën “Bashkimi” në pozicionin e kryeredaktorit, thotë se: “Për gazetën, radion dhe televizionin nuk është fakt çdo ngjarje, ndodhi, çdo proces jetësor a veprimtari shoqërore. Këto në vetvete përfaqësojnë fakte jetësore, por jo për t’u pasqyruar në shtyp, për t’u servirur lexuesve, ato përbëjnë fakte nëse kanë vlerë shoqërore, në qoftë se u shërbejnë zhvillimit dhe përparimit shoqëror³²”

Siç thotë edhe akademiku Fuga: “Gazetari shqiptar i kohës nuk mund të dalë kurrësi jashtë alternativave, opinionëve dhe direktivave zyrtare. Çdo mendim jashtë këtyre të fundit do ta fuste atë në një zonë të rrezikshme për sa i përket ruajtjes së vendit të tij të punës, sidomos lirisë së tij qytetare. Ndëshkimi që ai mund të marrë është në përputhje me faktin se sa larg ka shkuar ai përtej normave zyrtare të shprehjes në media. Sigurisht pushteti ka vendosur kufij dhe asnjë gazetar nuk mund t’i kapërcejë ata për t’u shprehur në media.³³ Përballë të gjitha trysnive dhe “formatimeve” të figurës së gazetarit, sipas kërkesave të asaj kohe, sërish Boriçi gjatë bisedave personale thotë se në atë periudhë ushtrohej mirëfilli gazetarit, edhe pse jo në gjitha shkrimet, dhe çfarë është më e rëndësishme, gazetaria dhe publicistika ushtroheshin duke përkthyer në shumë, për të mos thënë në të gjitha zhanret. Në lidhje me pretendimin se në atëkohë kishte gazetarit të mirëfilltë, shumë studiues të tjerë nuk bien dakort, duke pretenduar se gazetaria shqiptare e asaj periudhe, vetëm informim publik nuk ishte (dhe ky duhet të jetë kriteri i parë dallues i gazetarisë), por vetëm propagandim në shërbim të shtetit.

29 *Partia e Punës e Shqipërisë për shtypin*, Shtëpia botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1980, fq. 123.

30 *Partia e Punës e Shqipërisë për shtypin*, Shtëpia botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1980, fq. 144.

31 Fuga, Artan (2010): *Monolog*, Botimet Dudaj, Tiranë, fq. 151.

32 Boriçi, Hamit; artikull në “*Tribuna e Gazetarit*”, nr. 1, 1977 me titull: “Fakti, tema problemi”.

33 Fuga, Artan (2010): *Monolog*, Botimet Dudaj, Tiranë, fq. 171.

Visar Zhiti. *Funerali i pafundmë*. Përkthimi në rumanisht nga Luan Topçiu.
Pasthënie nga Liviu Lungu, 2020, Shtëpia Botuese A. 224 f.

KORI QË SHNDËRROHET NË KORTEZH

Nga Adrian Lesenciuc

România literară nr. 10/2021



Emri i Visar Zhitit nuk është i njohur aq sa duhet nga rumunët. Në fakt, letërsia shqipe na është imponuar me një emër të vetëm, Ismail Kadare, dhe dimensionin universal i veprës së tij (përkthyer nga M.D) ka ndihmuar që emri i tij të mbahet në ballë të kësaj letërsie.

Visar Zhiti lindi në 1952 në Durrës dhe u diplomua në Institutin Pedagogjik në Shkodër. U arrestua dhe u burgos për tetë vjet nga regjimi i Enver Hoxhës për "fajin" e vetëm se kishte shkruar poezi dekadente (për një vëllim poetik të çuar për botim). Poezia e Zhitit u botua vetëm pas rënies së Perdes së Hekurt. Vëllimi debutues, *Kujtesa e ajrit*, nga viti 1993, ishte një sukses i jashtëzakonshëm dhe autorit të tij iu dha Çmimi i Republikës së Shqipërisë për letërsi. Dhe vëllimet e tjera me poezi ishin me vlera të afërta me vlerën e të parit. Romanet e tij gjithashtu u pritën me entuziazëm nga kritika. Shumë vepra të tri-dhjetë viteve të fundit janë përkthyer në shumë gjuhë. Zhiti ka marrë çmime të rëndësishme ndërkombëtare, veçanërisht në Itali. Ndonëse ende i panjohur mjaftueshëm për publikun e gjerë rumun, vëllimi i tij me poezi *Psalm* u përkthye nga Renata dhe Luan Topçiu në 1997 dhe romani *Funerali i pafundmë* u botua për herë të parë në Shtëpinë e mirënjohur Botuese Leda - Corint në 2008, me përkthim të Luan Topçiu. Një ribotim i kohëve të fundit dhe i riparë i këtij romani u botua në vitin 2020 nga Shtëpia Botuese A. Vëllimi poetik *Flatra e mundur*, përkthyer nga Luan Topçiu dhe Renata Melonashi, u botua në të njëjtën Shtëpi Botuese një vit më parë.

Funerali i pafundmë është një roman atipik, më tepër një antiroman, një prozë e çartur, që nuk i nënshtrohet aspak konvencioneve, një tekst që shumë vështirë mund ta karakterizosh me termat me të cilat Romul Munteanu¹ u përpoq të zbusë Romanin e Ri Francez përmes

1 Romul Munteanu (1926-2011), kritik letrar, historian i letërsisë dhe botues rumun.

preludeve të një poetike të antiromanit. *Funerali i pafundmë* duket se minon edhe konceptin e antiromanit, të cilin Sartre e shihnte si të zënë rob në pamje të jashtme dhe në konturet e romanit. Romani shfaqet më së shumti si një epikë në tre pjesë të pabarabarta: "Udhëtimi i zi", "Elipsa dhe Corona V" dhe "Anti-Funeralet" (epilog) dhe 66 këngë, të hapura nga një "fletë e grisur nga fundi për t'u lexuar si fillim".

Teksti i Zhitit përshtetur rrjedhën e një turme të papërcaktuar, jo konsistente në një marshim drejt vdekjes. Padyshim që rruga është vendosur sipas koordinatave ideologjike dhe shtysës së turmës, si një shëmbëlltë e errët e shekullit të njëzetë:

"...të ikësh larg. Sa më tepër këmbë, aq më pak lodhje. Të qenët bashkë, shumë njerëz njëherësh, të ngjall ndjenjën e fuqisë, e cila shtohet edhe nga e cura. Kokët janë të rrezikshme. Të menduarit ndryshe gjithmonë prish punë. Rrugëtimin e bën më të lehtë mendimi i njëjtë, i vetëm, i përbashkët. I ngjashëm me yllin e karvanit që ndrit njëlloj për të gjithë. Dhe ai ecën me të gjithë, i largët, digjet si plaga e tjetrit që nuk dhemb kurrë. Është më mirë të mos mendosh, se jo vetëm nuk lodhesh, por shmang edhe mëdyshjet, që gjithmonë bëhen pengesë. Vetëm të ecësh. Ka më siguri, kur mendimi mungon fare. Ky është ideali: mungesa e tij. Se ka dhe epidemi ideologjike, dreqi e marrtë." (P.11)

Funerali, i drejtuar nga forca shtypëse dhe instinkte, duke shkuar drejt një destinacioni të vështirë, i drejtuar nga *quasi-prania* e një arkemorti, ka gravitetin e "Librit të Pëshpëritjeve" të Varujan Vosganian-it². Turma mbahet nga dëshira e thjeshtë për t'u radhitur me normën e imponuar, nga përgjigja adekuate ndaj rrymave të mëdha ideologjike të fundit të shekullit. "Funeralii pandemive rumun.


2 Varujan Vosganian, (1958), shkrimtar dhe politikan rumun.

ideologjike", siç e quan përkthyesi Luan Topçiu, një funeral i përbërë nga "personazhe maska" dhe "personazhe zëra", avancojnë në vijimësinë e këngëve të epopesë, si vetë historia e nivelimit, duke lënë pas hapësira dhe kohëra, të marra së bashku, të kuptuara së bashku, në një pastë topologjike ende të papërfunduar: "Iknim dhe iknim. Ktheva kokën pas. Arrita ta shoh prapë varrezën, tekta zvogëlohej e zbardhte si një kope e mbetur delesh, e palëvizshme në vapën e mesditës. Dhe dielli i ftohtë m'u duk si një kafkë dordolecësh për të trembur gjithçka [...] "(f.31). Peisazhi (pas) apokaliptik është i populluar nga bunkerët e Hoxhës, mbi të cilët ka punuar një nga personazhet - zëra, varreza, qytete të shkreta, vende të thata e gurishte. Një Shqipëri që kaloi nga autoriteti osman në komunizëm, një Shqipëri e sekularizuar pa vullnetin e saj, rigrupohet në kolonën mortore, e pasigurt si e kaluara e vendit, e fshehur në të njëjtën mjegull si në veprën e Kadaresë: një Shqipëri që kishte jetuar, në funeralin e njëpasnjëshëm të vdekjeve të Stalinit, Mao Ce Dunit dhe Enver Hoxhës: "Kur vdiq Enveri, madhështia e tij ishte e rreme, si çdo gjë që i përkiste atij." (f. 57)

Shqipëria në funeral hyn në gjysmën e dytë të epopesë në stinën e shirave, baltës dhe mallkimeve - një imazh i identifikueshëm edhe në veprën e Kadaresë - i udhëhequr nga një arkivol intuitiv, një ideologji e balsamosur: "Na udhëheq një arkivol që herë duket e herë zhduket, sipas kthesave që merr funerali, sipas motit, mjegullave dhe lojës gënjeshtare të dritës, të përpjetave idiote dhe të tatëpjetave edhe më idiote, duke përhapur duhmë kufome që s'kalbet..." (f.136). Arkemorti që ende drejton turmën e kortezhit, në të cilin mbyllet historia e kalbur e bindjes, ruan peshën e tij: "një i ri pas meje po më thoshte me zë të mallëngjyer, ngaqë njëri sup i tij kishte përsipër ca arkivol, se pesha që mbartnim, kishte rëndësi të jashtëzakonshme ndërkombëtare dhe kujdesi që bota të mos na e grabiste, duhej të ishte i tejshëm, mbi çdo sakrificë." (f.161). Ditari i këtij udhëtimi, fort i poetizuar: "ngrita kokën i shushatur dhe pashë të drunjëzuar qiellin e arkivoltë, të brejtur nga krimbat e yjeve." (f.166), kur e kur me këngë ose faqe që mungojnë, me faqe të fshira, me faqe - pasthirrma, është ajo në të cilën e gjithë dhimbja e marshimit është e shkruar përmes një jete të vjedhur, të mbyllur, të robëruar në ideologjinë e balsamuar, por duke transmetuar ende duhmën e historisë që nuk i nënshtrohet çmitizimit. Turbullues dhe dramatik është ky rrëfim i stërhollësive dhe qëndrimeve poetike, kjo alegori e historisë që shtyp nën peshën e vet njeriun që i nënshtrohet turmës dhe atë jashtë saj, secili "Secili nga ne është një arkemort i gjallë i vdekjes që s'vdes. Mbi supet e tjetrit dhe të botës." (f. 203), e cila fshin edhe poezinë e pamasë të ndryshimeve të dukshme: "Funerali i pafundmë vazhdonte rrugën e pafundme në mijvjeçarin e ri. Dukej sikur s'kishte ndryshuar asgjë." (P.207), ai vetë ende një pjesë e papërfunduar e marshimit të varrimit.

Funerali i pafundmë është një libër tronditës për një Shqipëri të brendshme, të supozuar nga Zhiti, që mban gjallë dhimbjen e tragjedisë antike greke. Në fakt është areali i improvizuar që kori i personazheve-maskë intonon, duke përsëritur zërin e qartë dhe të rëndë të një *choragos*³, një rol që Zhiti e merr përsipër deri në fund.

3 Choragos, drejtues i korit në Greqinë e Lashtë



Romani i ri i Stefan Çapalikut

“MBYLLUR PËR PUSHIME” NJË PARADIGMË DEHEROIZUESE

Nga Josif Papagjoni

Stefan Çapaliku ka një personalitet letrar dhe artistik të shumëfishtë. Njihet më shumë si dramaturg me mbi 20 drama të vëna në skenë, në këtë lami edhe si regjisor. Por ai ka lëvruar edhe vargun, me disa vëllime poetike, epohet e tundohet nga studimet letrare e artistike duke botuar disa libra kësodore dhe, sakaq, pena e tij ka provuar disa romane, i suksesshëm me romanin “Secili çmendet simbas mënyrës së vet”, që unë e çmoj si një nga më të mirët e kohëve të fundit, i profilit të satirës, sarkazmës dhe humorit. Ecejaket e tij monopateve letrare artistike, që duken si më vete e të ndara me “gardhe” gjinore nga njëri art tek tjetri, në fakt s’janë veçse peizazhi i të njëjtës mendje krijuese, përroska e rrjedha vrapacake që derdhen në ujanën e artit të tij sa të hapur aq dhe të thellë. Ndonjëherë të duket sikur Çapaliku i kap gjërat lehtë, sikur rri mbi syprinë e bën “humor” prej shkodrani pranë miqsh e një gote vere. Por ti ec pak më tej, or mik! Rrëmo pak më thellë syprinës, gërvishite cipëzën farfuritëse të “lehtësisë” dhe “kotësisë argëtuese” pa të keq dhe, besomë, do të shohësh poshtë këmbëve një plagë që gërric, një rremb gjaku e shpirt që dhemb, një përpëlimë që krijon thellomë në gjoks. Dhe, teksa ti do kridhesh pak më thellë, do të ndjesh dridhjen e një rrëmeti që do ndodh përtej kësaj shpoteje e këtij humorit; do të ndjesh, miku im, se dikush aty po qan në heshtje, i ngujuar në zgëqin e tij social, në dramën e tij, në hallin dhe mërzinë e tij; se dikush po ecën kuturu drejt një humbëture ku shpresa tashmë ka vdekur. Pikërisht këtë dallgëzim të brendshëm të tragjedisë dhe të dramës në disa vepra të Çapalikut unë e kam ndjerë. Dhe kam ecur zgafelleve të ironisë së tij në reljvet brinjëdala të një Shqipërie çudane, groteske e paradoksale. Për një lexues të rëndomtë këto duken si ca marri njerëzish të mbetur periferive, gjysmë të budallallepsur e të harruar, hedhur nëpër gropat sociale të shpërfilljes, por janë më tej; janë njerëz që vuajnë dallditë e para dhe pas viteve ‘90, lënë udhëve si jashtëqitje a plehërishte të një kohe kaotike, të rrumpallës, të një realiteti sa absurd, aq dhe mjeran.


E pra me këtë barrë dijesh mbi shpinë rreth artit të Çapalikut, veprat e të cilit i kam ndjekur vijimisht (edhe si mik e koleg i kahershëm), ja ku lexova të fundit krijim, romanin e tij “Mbyllur për pushime”. Stefani sa kishte mbaruar monografinë e shkurtër “Serafin Fanko – Felini i teatrit shqiptar”, që ende se kam lexuar dhe që duhet ta lexoj, si mirëfilli i kësaj lamie që jam. Por në një tjetër rast do të them do fjalë për atë regjisor-poet të teatrit tonë, artistin e imazhit, simbolikave dhe metaforave mizanskenike, e filigranave dhe ideve, që e ngritën teatrin e Shkodrës në nivelin e filozofisë. Romani “Mbyllur për pushime” është krejt tjetër nga romani “Secili çmendet simbas mënyrës së vet”. Janë dy poetika të ndryshme, dy stile ligjërimi që unë i dalloj saora. Këtu ka më pak marrëzi, më pak humor dhe shpoti për qejf, thuhet aspak anekdotë e thagma, sepse ka më shumë dramë, më shumë lëngatë të fshetë, më shumë trysni dhe një zymtim që zbrazet prej gotës së helmit dhe ti e pi atë glënjë pas glënjës. Dhe ndjen sa dhimbje për personazhet, që mbahen si përpara një pasqyre (larg teje e si fantoma), aq dhe të përthyer nëpër gollet e tua, në nevojën për ta parë “ndryshe” atë që sikur ka qënë koren e përligjies historike. Andaj dhe ke qejf të përsiatësh ca, t’i lësh faqet në nyjat e heshtjeve të njëpasnjëshme të romanit për pakëz meditim dhe të kridhesh, siç thashë, pak më thellë, edhe më thellë, aty ku muret e lagështa të shpirtit kullojnë nga mërzitë, ankthet e fshehta, frikërat, mëritë, keqkuptimet, sikundër edhe nga idiotësitë e lapërdhitë.

Romani, ndonëse jo vëllimor, i ngjan një afresku në cakun kohor shtator 1943, kur Italia fashiste kapitulloi dhe i la ushtarët rrugëve të fatit dhe 28 nëntor 1944, kur pushteti kaloi në duart e komunistëve të Enver Hoxhës, këtij terroristi që buzëqeshte dhe vishej shik e plot sqimë. Romani ka një strukturë të “copëzuar” në formën e një mozaiku, të cilat rrinë më vete, zhvillohen më vete dhe të tubuara së toku na japin gjithë reljevin sociokulturor e politik të Shqipërisë. Pena ecejaket nga gjasat e drojtura e delikate të artit të krimi, lufta, përgjakja, përçarja, ankthi i vëllavrasjes, te kurthet e situatave ndërkombëtare, te përpëlitja për të gjetur shtigje daljeje nga tragjedia, gjer te zdërrhalljet, idiotësitë, budallallëku. Gjithsesi ai është një gërshet me fatet e tri çifteve të dashuruar, në një hallakamë psikike, kombëtare e mbarëbotërore, në zgripin e ditë-natës dhe jetë-vdekjes.

...Një djalosh seminarist, Shiroka, që teksa përgatitej të dorëzohet prift, i bujt dashuria, e cila ia trazon shpirtin, dëgjon “najadat” e saj dhe martohet, krijon familje; një oficer i lartë gjerman, Herman Janas, i dërguari i Ribentropit dhe i plotfuqishmi i Ballkanit për të krijuar qeverinë e Regjencës në Shqipëri, duke i garantuar shqiptarët të qeverisnin vetë dhe se gjermanët nuk do ta push-tonin dheun e tyre, por do kërkonin veçse sigurinë e rrugëve të kthimit të divizioneve që vinin nga Greqia; pranë jetës së tij një

vajzë serbe, Milica, mes dy mëtimesh mashkullore, që ndjehej e përdorur, rrjedhimisht e shkatërruar shpirtërisht; një djalosh i dashuruar me një italianë të bukur gjatë studimeve, por falë një rrengu alla harrakatësh u rikthye në Shqipëri, zemërthyer, mbetur me nënën e vet, në ajrinë e një dashurie të kthyer në makth; një familje tiranase ardhur nga puntoria (usta Mihali) me djalin e vetëm të pushkatuar, që gjen mirëkuptim e solidaritet te një tjetër familje prej intelektualësh, ku hallet, tragjedite dhe zemrat ndër shqiptarë përherë bashkohen; gjer edhe fati i një lidhjeje martesore nga “halli dhe e keqja” mes dy personazheve anekdotikë, Osmanit dhe italianes Sonia, dy bjeranë, me diferencë 30 vjet, që gjejnë në fund një shtrat martesor. Dhe të gjitha këto linja kanë si sfond Shqipërinë e Luftës II Botërore, ankthin dhe trazimet e saj, përplasjet e nënkuptuara politike e kulturore, ndoca iluzione që projektoshin prej farfurive të Perëndimit por që thyheshin copë e grimë nga vrazhdësia dhe huqet e Lindjes: komunistët që vinin si jakobinë me giotinat, diferencimet, pushkatimet dhe kastat kulturore e politike nacionaliste që merrnin arratinë, në një tjetër picir e kalvar. Dhe si për habi, një prift katolik, eminent i dijes dhe shpirtit të dëlirë, edhe pse avioni i vjen apostafat që ta shpëtojë nga vdekja e sigurt, nuk i ikën fatit të vet, por i rri si një Krisht, mendjeftohtë, me vetimin e kamzhikut shpinës dhe plumbin që fluturonte drejt ballit të tij nga skuadra e pushkatimit nesër.

Narrativa e romanit në pamje ndjek modelin e të paangazhuarës, e të tjetërsuarës, diçka që rrëfehët si në një kronikë, pa marrë pjesë shpirtërisht në veprimin, te sjelljet dhe përjetimet e personazheve. Kjo lloj “ftohtësie” në dukje midis treguesit dhe të treguarës, ky drejtpeshim dhe “sy i thatë” mbi një gjësend që djeg a mbi një lëng që vlon, më duket se është gjetje inteligjente e ligjërimin romanor. Duket sikur autori të qe në një balancë farmaceutike dhe të na hidhte aty pluhurin e kininës, aq sa duhet dhe atje ku duhet: diku për të shëruar një shpirt, për ta marrë për dore e për të na i paraqitur si në një skenë a sfilatë fytyrash tragjikomike e diku gjetkë për të na lënë të vetëm, si përballë një portreti të një galeri arti, kredhur në mendimin dhe në ndjenjat tona, paçka se praninë e shkrimtarit, diku aty bri, ne e ndjejmë. Syri i tij nuk na ikën. Është tok me syrin tonë. Ai nuk flet, por e hedh vështrimin pikërisht aty ku plaga është më e thellë dhe çmenduria vizllon në zgrip. E kam ndjerë këtë pikërisht te fati i serbes Milica, e dashura e një hierarku nazist, por që, e gjora, ka mbetur nën afshin erotik të një shqiptari krenar dhe prandaj, e trullorur dhe jashtëmendjes, si ajo fantoma e Migjenit rrugëve të Shkodrës, del mesnatave e dehur, ndofta dhe e keqpërdorur si femër lokale,



by fate velaj

dhe zhgaravit vargje dashurie mureve të rrugës “Skadralia” në Beograd, me mendjen e shturur që s’ka për t’iu mbledhur më. Çfarë humbelle ka këtu?! Sikur të hapet poshtë këmbëve një gropë e madhe, një abis dhe ti sheh shprishjen me tërësej të një jete të brishtë. Sa keq! Një situatë e pikturuar bukur, pa shumë përshkrime, thuhet hiç fare, veç ca penelata, si në pikturat e një Degaje. Ia thashë edhe Stefanit se të tilla zgjidhje e kanë çuar vrik narativën sipër; na lënë ta mendojmë vetë atë që ka ngjarë sakaq. Konkurrente me këtë është edhe nyja kur hierarku nazist duhet të shkojë e të mblidhet te gruaja dhe djali i vet të lënë pas dore. Dhe për të dhënë tmerrin e ndodhur, autori asocion përmes një situatë thuhet apokaliptike nga një poemë e njohur e Gëtes, “Erlkönig”, ku nënkuptohet se djali i Hermanit duhet të ketë vdekur njësoj si edhe fëmija në poemë. Madje vdekja shkon edhe më tej, sepse edhe ai, ndofta, do të vdes nga bombardimet e aviacionit anglez teksa rreket të kthehet në shtëpi, ose do të ndëshkohet nga një Nyremberg i mëpasëm.

Një nga kyçet politike të romanit, tejet i mprehtë dhe ndofta i diskutueshëm, është fati i pater Andreas (Anton Harapit) si anëtar i Regjencës. Pata një tundim të fortë se si do ta trajtonte shkrimtarin këtë figurë të njohur historike, e anatemuar nga politika komuniste si kuisling, tradhtar, shitës i interesave kombëtare dhe shërbyes te pushtuesit gjermanë. Pater Harapi nuk ishte dosido. Ishte një njeri i ditur, me kulturë gjermanike, një prift i iluminuar dhe tejet i dashur, i ëmbël. Gati një poet. Nuk ishte thjesht një “tradhtar” i kombit, i pushkatuar nga gjyqet komuniste, por qe njeriu që bash për atë komb, të gjendur fatalisht në zgrip, ishte gati të therorizohej. Ai e dinte se legjionet jakobine të komunistëve po vinin, e dinte se ata do të masakronin elitat kulturore me zor të ngritura në Shqipërinë monarkike duke institucionalizuar “kopetë e nesërme sociale” ku vezullimi, sqima dhe individit do të shkeleshin e shqydheshin, ku tempujt e Zotit do të përdhoseshin e do të nxirreshin jashtë ligjit. Por a gaboi ky prelat i kishës në raport me lirinë dhe të drejtën? Shkrimtari i bishton kësaj pyetje. Ai nuk është historian. Ai shkruan letërsi, dhe letërsia merret me fate e marrëdhënie njerëzore. Letërsia asocion me filozofinë e historisë, me shpirtin e saj, jo me dokumentin apo gjyqin e fitimtarëve. Prandaj Çapaliku e sheh fatin e pater Andreas nga dritarja e humbësit. Ishte konteksti historik i kohës që e çoi atë në zgjedhjen e një rruge, politikisht të gabuar, por e paraqitur në vetëdijen e tij si një domosdoshmëri, si shans për ta shpëtuar vendin nga shkatërrimi i papërbalueshëm i një ushtrie të hekurt siç qe ushtria gjermane, sikurse edhe si një blatim për të shmangur vëllavrasjen mes shqiptarësh. Motivet nuk shpallen dhe nuk “argumentohen” historikisht si të tillat, ato veçse nënkuptohen. Ne e ndjekim këtë personazh dhe nuk shohim kurrëgjë të keqe veçse një shpirt të bardhë, gati poetik e nostalgjik. Është qingji që sakrifkohet, flija dhe kurbanit që shqyhet nga shpata dhe verbëria. Autori e ka marrë në mbrojtje pater Harapin jo me fjalë, por me dhembshuri dhe një respekt që kullon gjithandëj narrativës së tij. I ka hedhur sipër një pelerinë jo aq prej tempullari sesa prej meshtari, i cili nuk mund ta linte grigjën e vet të çartë nga ujçërit e kohërave të gjakut, mizorive, utopive vrastare, dasive, përjashtimeve dhe therorive. Jo aq antikomunisti se sa dijetari, shpirtbukuri dhe prifti i grigjës së hutuar është pater Andrea (Anton Harapi)... Më erdhi mirë në mendje e zemër kjo figurë, ashtu e butë, e paqme, dinjitoze, sido që ky Pater i shquar i kishës mbeti peng i një orientimi a logaritmi të gabuar politik. Epo ja që fatet e historisë janë ndoca monopate të shtrembra, që një dreq e di se si përfundojnë dhe ku përfundojnë. Nisesh për mirë dhe shkon për keq. Ashtu siç shumë nga ata njerëz që bënë luftën, përfunduan më pas burgjeve, internimeve dhe skuadrave të pushkatimit.

Romani “Mbyllur për pushime” është i paradigmatave deheroizuese. Narrativa është lakonike, e thukët. Lexohet shpejt. Pa lodhje. Një strukturë, do të thoshja, atletike. Thuhet të gjithë personazhet janë një tubë humbësish a, thënë më drejt, dështakë në një rrethanë “anti”, desakralizuese, që poezinë, besimin dhe ëndrrën e tyre i katandis diku në do recka-pecka, diku në martirizime të vetvetes e diku gjetkë në zhgënjime dramatike, dëshpërim e çmendje.

PROF. JORDAN B. PETERSON DHE LIBRI I TIJ "12 RREGULLA PËR JETËN"

Shënime të përkthyeses

Nga ATENA BISHKA

Vetëdija jonë duket se rrudhet në përpjesëtim të drejtë me komunikimin që vjen duke u zgjeruar; bota në është hapur si kurrë më parë dhe ne çapitemi si të burgosur, secili në kafazin e vet privat, portativ. Ndërkaq, sahati troket tik-tak. Vallë, ç'mund të bëjnë ulëritësit, përveçse të ulërijnë derisa bulçitë t'iu bëhen mavi?

– Arthur Koestler, *Makthi që është realitet*, 1944



kërkimi i kuptimit jo te këmbëngulja për të drejta e privilegje, por, përkundrazi, te marrja e përgjegjësive, sado e sertë të tingëllojë dhe sado larg prej imazhit fluturak të jetës-përrallë me destinacion lumturinë, përkundër gjasave, rezulton e mirëpritur nga miliona të rinj kudo në botë, të cilëve, ashtu si edhe në Shqipëri, kultura, stili i jetesës dhe gjithësia online iu servirin bash të kundërtën: konsumerizmin, eskapizmin dhe kënaqësinë e përfutur me mjete çudibërëse e rrugë të shkurtra, që s'kanë të bëjnë as me përgjegjësinë, as me kuptimin. Ky libër, pra, e kthen vështrimin për nga vuajtja, si një e vërtetë e pashmangshme e realitetit i provueshëm, që buron nga përkohësia jonë dhe vetëdija se ekzistenca, ashtu sikurse çdo lojë çfarëdo, është e mundur vetëm brenda një qarku kufijsh, rregullash dhe kushtesh. Jo më kot, sikurse e ka thënë Dostojevski te *Shënime prej nëntoke*, “jeta është një proces në të cilin vatra e dhimbjes zhvendoset, por nuk zhduket”. Duke qenë kështu, nëse librin *12 rregulla për jetën* do ta përmbledhim në një kryepytje, ajo do të ishte: “Si të sillemi duke e ditur se jemi të përkohshëm dhe se jeta për shkak të kufizimeve është vuajtje?” Lënda që shtjellohet këtu është për ato mendje që i grish dhe i ngacmon kjo pyetje. Pikërisht për të tilla mendje, të cilat kanë ndjeshmëri të lartë edhe ndaj raportit të ndërlikuar liri-disiplinë, me të cilin përballat shoqëria shqiptare sot, ky libër mund t'u shërbejë si udhërrëfyes në kërkim të shtegut të kuptimit të jetës. Përmes faqeve të këtij libri lexuesi i interesuar do të mësojë se potenciali që ndërthehet së brendshmi te cilido individ s'ka si të shpalohej si liri veprimi pa përvetësuar kryesëpari disiplinën, pa ushtrimin e së cilës as që mund të flitet për rregullin – për rregullin si prita më efikase ndaj nihilizmit dhe dëshpërimit që kall gjendja e pashpresë, ky rrezik i njëmendtë ekzistencial sidomos për të rinjtë shqiptarë sot.

Një tjetër mësim, që bazohet në analizën e gjëmave të shekullit XX, është ai që lidhet me mënyrën se si e shohim veten të pozicionuar në raport me krimet e së kaluarës dhe sa jemi në gjendje ta përfytyrojmë veten në rolin e antiheroit ose të kriminelit përmes veprimeve dhe mosveprimeve tona. Ashtu si fëmijët që identifikohen në çdo përrallë me “të mirët”, edhe të rriturit po njësoj identifikohen me të mirën që mishëron heroi ose heroina protagoniste. Kur shohim një film si *Lista e Schindler-it*, të prekur deri në ngashërim, njësohemi pa ndërpyshje me Schindler-in. Mirëpo, natyrisht, duhet më parë të vihemi në provë, pa t'ia dëftojmë, sidomos vetes, se cilët, në fakt, jemi dhe si do të vepronim. Ka shumë më tepër gjasë që të shumtët ndër ne të zgjidhnin (me vepra, jo me fjalë) të bënin rojtarin e burgut, kalecin, spiunin, ose shefin e kapanonit, që është edhe më i zellshëm e katil se eprori, duke fuqizuar ose duke mbështetur kështu të keqen, madje edhe përmes heshtjes ose heshtjes së syve mënjatë. Nëse vërtet synon përmirësimin, vështrimin lart e përpara, duhet kuptuar se “Asnjë pemë s'rritet dot deri lart në Qiell, nëse rrënjët s'i mbërrijnë dot gjer poshtë në Ferr.” siç vëren C. G. Jung. Aq më tepër vlen kjo për Shqipërinë, e cila pas dekadash tranzicioni ende së njeh, bën sikur së njeh, sështë gati a s'dëshiron të njohë e ta shohë në sy të kaluarën e saj të spiunëve, të kalecëve e të torturuesve.

Qysh në pikënisje, kur mora përsipër sjelljen në shqip të këtij libri, ia kam bërë vetes pyetjen: “Në ç'masë idetë dhe principet që shtjellohen këtu, prej perspektivës së një vendi të begatë e me demokraci të konsoliduar si Kanadaja, përkohë me realitetin shqiptar dhe sa i vlejnjë lexuesit shqiptar?” Përsiatja që më ka shoqëruar gjatë rrugëtimit tim si përkthyesë më ka sjellë në këtë shteg arsyetimi: Natyra e diskutit publik në Shqipëri përcaktohet doemos nga shkalla e zhvillimit demokratik, që vijon të jetë i brishtë e në fazë adoleshence. Kur nisa punë tek Agjencia për Zhvillim Ndërkombëtar e Shteteve të Bashkuara (USAID) në fillim të viteve '90, hamendësohej se ndihma dhe mbështetja e kësaj organizate do t'i lypsej Shqipërisë diku te ndonjë duzinë vitesh a diçka më shumë. Mirëpo, në mbarim të dekadës së tretë, në faqen online të USAID-it, shërbimi i së cilës ende lypset për të zbutur varfërinë dhe për të forcuar rendin demokratik në Shqipëri,

Atë të premte fundmarsi 2009 agimi ia behu me kujë e ofshamë. Qielli derdhej teposhtë me rrapëllimë e hakërrimë. Në stacionin St. George mora shkallët lëvizëse që të nxjerrin në rrugën me po atë emër. Pasi kapërceva gjeometrinë trekëndore në stilin brutalist të bibliotekës Robarts, m'u shfaq binaja e Sidney Smith Hall-it, po aq e betontë, kaba dhe e mugët sa edhe çdo ndërtesë universitare e ndërtuar posaçërisht e kursimtarisht për të shërbyer si fabrikë prodhimi masiv punonjësish të ardhshëm të pajisur me arsim të lartë. Në katin e katërt, në ndarjen në të djathtë të ashensorëve, trokita në derën 4046. Dr. Peterson-i e hapi duke më zgatur dorën për të më përshëndetur. Si degë shelgu pas shtrëngate, hutueshëm belbëzova se ishte më mirë të mos ia qullja pëllëmbën. Por ai ma shtriu gjithësi duke ma pritur me mirësjellje se uji i shiut që i padëmshëm. Si më ndihmoi të vendosja mantelin në varëse, më ftoi të mblidhja veten e të ulesha në poltronën përballë tryezës së punës. Paqja e atyshme nisi të më shtensionojë e të zhदारisë harbimin e natyrës që më gjëmonte ende në tëmtha. Sytë e tij, sa të vëmendshëm edhe zhbirues, nën vetullat e rrepta më vështronin si prej një tisi që s'lejon kënd të shohë më shumë seç duhet, duke mos ia dalë dot gjithësi të fshihnin thellëtitë e kushedi se çfarë brengash mundonjëse.

Ajo dhomëz, që përbente këndin e tij të punës, s'mbante erë burokracie. Pak ngjashmëri kishte me një zyrë çfarëdo universitare (a në daç korporate), ku të përshëndesin po ato vitrina gazmore fotografish, aradhe çmimesh, certifikatash, fletëlavdërimesh, muresh me citate e postera frymëzues, vandakë shkresash në pritje për t'u radhitur dhe sirtarë metalikë që s'lodhen së arkivuari dosje të reja e të vjetra. Ajo hapësirë modeste, përkundrazi, dukej se ishte enkas e krijuar për të ndërthurur kreativitetin me rendin dhe funksionalitetin. Sa të grishte të harliseshë në imagjinatë a ëndërrim ditën për diell, aq edhe të nxiste të vije rregull e të ndaje brenda mendjes grurin nga egjra, të ftilloje e të tëharrje mendimet, të rrekeshë t'i vije me sira e të kridheshe në punë pa u trazuar. Ishte po aq edhe një kënd ku mund të bashkëbisedohej pa prani barrierash për të shestuar pikësnyime, për të ftiltuar andralla, për të zhdrivilluar probleme dhe për t'i peshuar e për t'u dhënë udhë zgjidhjeve.

Vend për klishe e tepri aty s'kishte. Në të majtë, nëse shihje me kujdes, në një cep si fshehur pranë portës pikasje dy portrete bardhezi shkrepur në ndonjë studio të viteve '50-'60 që dokumentonin çaste të çmuara për kujtesën familjare. Sipër, përmbi derë, qëndronte një foto e madhe e portretit imponues të Hemingway-it. Kur e pyeta a mos portreti i një burri serioz që vinte menjëherë pas tij ishte i Sollzhenjicinit, u shpreh se studentët dhe përgjithësisht ata që hynin aty së vinin re ose, me gjasë, nuk e njihnin. “Është letërsi që s'para gjen vend ndër shkollat tona”, - tha. Përmbi tryezën e punës, në një pikturë ruse që zinte një pjesë të mirë të faqes së murit, dy çarçafë të bardhë, përkundur prej puhisë, zdrinrin oborrin e gjelbër larë prej vesës së mëngjesit në një shtëpi të thjeshtë fshati. Këndet e mureve dhe parvazin e gjerë të dritares i hijeshonin objekte e skulptura të vjetra e të reja, maska ngjyrëndezura e punime artistike indigjenësh të Veriut. Kurse pranë raftit të librave përbri rrinte sendërtimi trepërmasor mbi bazën e vizatimit të tij tashmë emblematic, konceptuar si tunel kaleidoskopik i përfutur prej një shumësie fraktalesh modeluar sipas strukturës gjeometrike të një guri diamanti. E pata ndeshur në ballinën e librit *Hartat e kuptimit, arkitektura e besimit* (1999) atë trajtë gjeometrike me të cilën Peterson-i rreket të përcjellë vizualisht konceptin e kuptimësisë, si të

ishite shëmbëlltyra e asaj që na kumtojnë shtresëzimet, frazate e tingujt muzikorë.

Çdo sipërfaqe tjetër vertikale e asaj ode vishej me nikoqirllëk prej raftesh cit në libra të ujdusur me kujdes. Meqë në atë periudhë fusha parësore studimore e Peterson-it që personaliteti dhe matjet e tipareve të tij, do të pandehje se në zyrën e tij të punës do të dominonte literatura kërkimore prej teknikienësh dhe neuro-eksperimentuesish të tejspecializuar. Të tillë doemos kishte dhe fundja njëri prej tyre ishte ai vetë. Mirëpo, më fort se qoshen e një teknikieni, ajo fole të sillte ndër mend tempullin e paqtë të një dietari oshënar në shoqëri të zgjedhur mendjesh të ndritura të derdhura përfundimisht në letër dhe objekte artistike.

Lëmi parësor i humltimit të tij teorik dhe klinik është psikologjia. Te ky stacion diturie, pas kryerjes së studimeve universitare në fushën e shkencave politike dhe pjerrjes së hershme për nga e majta politike, e solli rrugëtimi drejt vetëzbulimit e vetëdijesimit përmes ushtrimit të shqyrtimit të rreptë kritik të motivimit personal, sistemit të vlerave dhe besimeve, dhe vënien në kalendarin etik të sjelljeve dhe veprimeve vetjake. Në këtë kontekst, përmbytja librare e rafteve vizatonte kthjelltazi hartën e trajektoreve dhe stacioneve të tij të edukimit dhe mbrytjes intelektuale. Si për të shpaluar qasjen e tij utilitare e pragmatike, pranë librave, rrinin në varg gjithëfarë veglash të thjeshta dore që gjenden në çdo shtëpi, sikurse pinca, darë, çekiçë, leva e kaçavida. Përmbytja e asaj biblioteke shënonte rrethprerjen e humltuesit të neuropsikologjisë dhe psikologut klinik, filozofit dhe humanistit, dashnorit të letërsisë dhe artit, por dhe të ustait praktik që i hanë duart për punë dhe i ka veglat e punës gati për të ndrequr çfarë s'funksionon siç duhet nëpër shtëpi.

Po të nisesh prej titullit, mbase e merr librin *12 rregulla për jetën* për ndonjërin nga manualët që zakonisht gjenden në çdo hyrje librarie, të pozicionuar enkas për të ndjellë blerësit që gjurmojnë receta punëmbaruëse e andrallashpëtuëse, çudibërëse e frymëzuese, suksespërshkruese e lumturigarantuese. Por, paçka se vërtet ngrihet mbi 12 parime në dukje të thjeshta, libri pak pikëprerje ka me stilin dhe marifetet e trajtës “si të shkëlqesh kudo e kurdoherë me 12 hapa për 12 ditë”. Përkundrazi, kumti në qendër të këtij libri, sa i moçëm aq edhe modern, i zbulueshëm në pikëtakime mitologjike, religjioze, filozofike, psikologjike dhe letrare, është sa i kulluar dhe i thjeshtë, aq edhe i rëndë dhe i zymtë, i përfutur sa përmes përvojave personale e marrjes së vetes në pyetje, aq edhe i mirëmbështetur dhe i verifikuar përmes dijeve që trashëgojmë prej mendjeve më të spikatura të njerëzimit. Ai rreh të nyjetojë atë që në brendinë tonë më të thellë e ndiejmë dhe e përjetojmë, paçka se jo doemos mundemi ta artikulojmë a priremi ta pranojmë: kuptimi përlligj vuajtjen dhe kuptimi zbulohet përmes përgjegjësive. Është kjo dija e dorës së parë dhe e pashmangshme, që na lypset për t'u bërë ballë pengesave që bashkëshoqërojnë shtegun gjarpërues të jetës dhe sflitjeve që mund ta thejnë e ta zvetënojnë shpirtin njerëzor, sepse, siç vëren Viktor Frankl te libërthi i vlerët *Njeriu në kërkim të kuptimit*, vuajtja pushon së qeni e tillë veç kur përpuqet me kuptimin.

Ky libër, pjesë e diskutit të munguar që mëton të zgjojë interesin për të shqyrtuar raportin mes kuptimit dhe përgjegjësive, duket sikur s'ka fort të bëjë me klimën e sotme të botës perëndimore ku i mëshohet qerthullit të drejtave dhe privilegjeve (paçka se nuk e mohan aspak rëndësinë e të drejtave njerëzore). Përqasja kuptim-përgjegjësi këtu, pra

lexon: “Edhe pse ekonomia e Shqipërisë vijon të rritet, vendi është ende nga më të varfrit në Europë, i penguar prej një ekonomie të konsiderueshme informale dhe niveleve të larta të korrupsionit, që i vështirësojnë përpjekjet për reforma.” Mirëpo, pavarësisht kësaj panorame, Shqipëria është, megjithatë, vend ekzistenca e të cilit s’mund të mendohet pa ndërveprimin shumëpërmasor brenda një bote ku shtetet edhe për shkak të teknologjive të komunikimit gjithnjë e më shumë përziejnë kulturat, ndikohen nga lëvizjet migratore e demografike dhe rreken t’u binden ligjeve e rregullave gjithnjë e më të ngjashme. Nga ana tjetër, Shqipëria, e cila ka eksportuar një pjesë të mirë të popullsisë së vet në vendet perëndimore, gjithnjë ka mëtuar ta bëjë të vetin modelin perëndimor duke ia adoptuar qasjet, ligjet, rregullat dhe format e komunikimit edhe kur s’ka qenë ose ende s’është gati kulturalisht dhe mendërisht për t’ia përvetësuar sistemin e vlerave. Mirëpo, me gjithë dallimet, përballjen e gjatë me gangrenën e korrupsionit dhe humbjes së besimit, veçantitë dhe mospërkimet e kuptueshme zhvillimore dhe historike, shumë nga debatet e nxehta në botën e zhvilluar që lidhen me themelet e demokracisë, si liria e fjalës, problemet e diskriminimit dhe pabarazia gjinore, çështjet e besimit dhe arsimit, politikës së majtë dhe të djathtë, herët a vonë do të jenë (në mos janë) tema të nxehta e me rëndësi edhe në Shqipëri. Për më tepër, nëse sinorët e diskursit publik në vende, si Kanadaja, SHBA-të apo Britania e Madhe e gjetiu vijnë e bëhen aq të ngurtë, saqë diskutimet e hapura e transparente për çështje kontroversiale bëhen gati të pamundura e ndëshkuese nëse dalin prej shinave të ngushta e të ngurta gjuhësore të diktuara politikisht, kjo do të thotë se Shqipëria me fytyrën e kthyer nga perëndimi, si hallkë e të njëjtit zinxhir, paçka se ende nga bishti, s’mund të mbyllë sytë e veshët.

Deri aty nga mesi i viteve 2010 prof. Jordan B. Peterson njihej prej studentëve të psikologjisë në Universitetin e Torontos, një rrethi klientësh në praktikën e tij klinike dhe një numri ndjekësish të programeve të kanalit televiziv publik TVO të provincës së Ontarios, ku e ftonin shpesh. Popullariteti i tij ushqehet edhe nga suksesi i ligjëratave të hedhura falas në YouTube, të cilat mbështeten në tezat dhe idetë e librit *Hartat e kuptimit*. Mirëpo, flurudha e tij e hatashme mediatike dhe trokitja me sokëllimë në vëmendjen botërore e pati pikënisjen te një video 3-pjesëshe e titulluar *Profesori kundër korrektesës politike*, hedhur në Patreon në fund të shtatorit të 2016-s. Ajo gjeti sakaq udhën për te sytë dhe veshët e publikut që ishte, me sa duket, i uritur për të dëgjuar çka nuk gjendej në parashikueshmërinë e ligjëritimit bajat publik, gjithnjë i mbështjellë me po ato petka të korrektesës politike. Përkundër gjasave, shumë njerëz pikasën vërtetësi e tejdukshmëri jo vetëm sa i takon përmbajtjes, por edhe gatishmërisë për ta artikuluar mendimin shqeto, pavarësisht stepjes frenuese dhe drojës paralizuese teksa ti e di mirë se ajo që po bën mund të ketë çmim të lartë e të papërballueshëm. Në atë video-regjistrim Peterson-i, ndër të tjera, arsyeton mospajtimin e tij me ligjin

e ashtuquajtur Bill C-16, me të cilin ndryshohet Akti Kanadez i të Drejtave Njerëzore dhe Kodi Kriminal, me qëllim që të ndalojë diskriminimin mbi bazën e identitetit dhe të shprehjes gjinore, duke i bërë vend ndjeshmërisë gjuhësore që lidhet me transjinorët dhe konkretisht, detyrimin për t’u drejtuar dikujt me përmrin veçor të parapëlqyer (kushdo sendërtor përmrin ose neologjizmin me të cilin dëshiron të thirret prej të tjerëve dhe këta me forcën e ligjit duhet t’ia respektojnë kërkesën). Ndoshta numri i njerëzve me kërkesa të tilla është tepër i vogël për të krijuar përshtjellim të madh, të trajtës stuhi në gotë. Dhe ndoshta s’ia vlen barra qiranë që kërkesa e dikujt për t’u thirrur në anglisht *zie, sie, zim, zhe, zhey* (lista vjen duke u zgjatur) të mos respektohet. Megjithatë, teza që mbron Peterson-i është se ky ligj i paprecedent në historinë e së drejtës zakonore angleze do të thotë të shkelësh civilizimin perëndimor. Edhe pse pohon se, nëse dikush do t’i kërkonte personalisht t’i drejtohej me përmrin e preferuar, dëshirën me gjasa do t’ia plotësonte, Peterson-i, megjithatë, tërheq vëmendjen se ky ligj shënon një kapërcim prej rrafshit ku ndëshkohesh nëse përdor gjuhë urrejtjeje, në rrafshin ku, përkundrazi, ndëshkohesh nëse refuzon të përdorësh fjalë të parafabrikuara e të detyrueshme me ligj. Çfarë e shqetëson, s’është edhe aq ligji si i tillë, por doktrina dhe ideologjia ku themelohet ligji, që regjimentojnë fjalën dhe pastaj mendimin.

Duke e këqyruar diçka të tillë si imponim të fjalës rrasur forcërisht në grykë si shtupë, gjatë një debati në Universitetin e Torontos në nëntor të 2016-s, ai u shpreh: “S’kam për t’u katandisur në zëdhënës të një gjuhe që e përcmoj, dhe se luan topi!” Ai debat, nga më të vështirët e më të pamundurit që më ka rënë rasti të shoh që prej largimit nga Shqipëria, dukej si inskenim i frymëzuar prej gjyqeve politike të viteve ’70-’80 të Partisë së Punës të Shqipërisë, ku individ i gozhuar me shpatullat pas murit s’ishte më shumë se një tabelë pritëse goditjesh unanime. Veçse, në ndryshim nga viktima e atyre viteve të errëta, e cila jo vetëm s’u shpëtonte goditjeve, por edhe i pranonte tragjikomikisht duke thirrur “Rroftë Partia!”, ky profesor pa përkatësi partiake, që përndryshe së pengonte kurrëgjë të shijonte i patrazuar e në rehati suksesin e një karriere të konsoliduar, pati guximin që, edhe përmes shkundullimit të kuptueshëm emocional që njeriu provon kur e di se rrezikon shumëçka e veç një hap e ndan prej greminës, t’i dilte për zot pikëpamjeve personale, qoftë edhe sikur të katandisej i shpërnjohur prej kolegëve e miqve (shumë prej të cilëve nxituan me zell të firmosnin denoncime e peticione që lypnin pezullimin e tij nga puna; nga ata që heshtën e që kishin pikëpamje të ngjashme, askush, me sa di, s’pati guximin të rrezikonte duke i dalë në krah) e duke marrë në sy koston dhe pasojat e mundshme, sikurse shkatërrimi i reputacionit, përmbysja e karrierës dhe marginalizimi publik e shoqëror.

Pavarësisht përpjekjeve mediatike për ta ngjyrosur politikisht (posaçërisht si të djathtë), për ta urreyer ose për ta adhuruar nisur prej kornizash të ngushta binare “i djathtë-i majtë”, “me ne-me ata”, ajo çka Peterson-i njëjton është

në thelb e zhveshur nga zhgualli politik dhe e pamotivuar ideologjikisht. Pikësëpari, për këtë mendimtar, ikonoklast, renegat akademik, personalitet mediatik joortodoks, që së ha merak fort në pëlqehet a jo prej gjithkujt, i zoti të gozhdohet vëmendjen e dëgjuesve me orë të tëra pa ndërprerje, çdo temë e problem është i mirëpritur të vendoset mbi tryezën e diskutimit, me kusht që të mos ndodhet aty për qoka politike dhe të mos jetë recitim ideologjik prej papagalli.

Ligjërimi i tij me profil kryesëpari psikologjik, por edhe po aq filozofik dhe teologjik, sfidon llogoret ideologjike të majta ose të djathta duke u lëshuar dritën e një aparati kritik e qasjeje ndërdisiplinore që shpalohet në bashkëbisedime me cilindo diskutant, pavarësisht kahut politik a pikëpamjeve të kundërta. Shembujt shkojnë prej filozofit e neurohulumtuesit Sam Harris te publicisti konservativ Ben Shapiro, prej gazetareve Cathy Newman e Helen Lewis te filozofi hegelian Slavoj Žižek, prej gazetares Decca Aitkenhead te një nga kritikët më të rrepta të islamit Ayyan Hirsi Ali, prej konservatorëve Douglas Murray e Roger Scruton te psikologu social Jonathan Haidt, prej ish-politikantit John Andersen, matematikani Eric Weinstein dhe biologu Bret Weinstein, dhe lista është e gjatë.

Me penën që vizaton lëngatën shpirtërore të kulturës perëndimore të sotme, me njohjen dhe zhërvjelltesinë prej dijetari, Peterson-i flet për sferën e koncepteve dhe ideve – për të cilat C. G. Jung frikshëmrisht është shprehur se “idetë të artikulojnë, nuk i artikulon” – të ndërgjegjes dhe pandërgjegjes, të së mirës dhe së keqes, sikur ato të jenë edhe më reale, konkrete e të gjalla sesa vetë njerëzit.

Duke ndërthurur në mënyrë ndërdisiplinore psikologjinë evolucionare, psikologjinë mitologjike jungiane, analizën e rrëfenjave të moçme biblike dhe studimin e së keqes, ky studiues na ofron thjerrëza të reja me të cilat të kuptojmë ideologjitë e djathta dhe të majta. Pikërisht kjo qasje e freskët duhet të jetë edhe çelësi që shpjegon se përse mesazhi i tij zë vend në mendjen e shumë njerëzve, sidomos në atë të të rinjve, që e përpijnë fjalën e tij si ara e përcëlluar dushin freskues që lëshohet prej reve të mbarsura. Me sa duket, njerëzve ende u intereson dialogu safi dhe i thellë intelektual. Nga ana tjetër, teknologjitë e reja, veçanërisht formati *podcast*, janë platforma e duhur për të përcjellë falas e me shtrirje të gjerë këtë dialog që ngrihet mbi një oratori që dëshmon se gjuha e folur mund të garojë po aq peshërendë dhe e ngjeshur në kuptim me gjuhën e shkruar, e për më tepër falas e duke rrokur të gjithë veshët e interesuar.

Së fundi, ajo çka lexuesi i kultivuar shpresoj të gjejë në këtë libër është një platformë idesh e principesh që ftojnë mendjen kureshtare të shestojë modelet e veta të të menduarit, të përqsasë argumente dhe arsytetime në mënyrë të çinterësuar, të ngrejë dyshime e të gjejë qasje që e mbrojnë prej kurthit të manipulimit ideologjik e që e orientojnë drejt vetëpërmirësimit. Të gjitha këto kërkojnë të duash të mësosh si të vallëzosh me kujdes përgjatë kufijve kaos-rregull, duke qëndruar në baraspeshë me njërën këmbë në truallin e kaosit dhe këmbën tjetër në truallin e rregullit.

MBI 4 MILIONË KOPJE TË SHITURA

JORDAN B. PETERSON

12 RREGULLA PËR JETËN

NJË ANTIDOT NDAJ KAOSIT

‘Një nga mendimtarët më të rëndësishëm që është shfaqur pas shumë vitesh në skenën botërore.’ SPECTATOR

Minerva



Ditën e djeshme, më 7 maj 2021 ishte 85 vjetori i lindjes së shkrimtarit të shquar të letërsisë shqipe, VATH KORESHI.

Me këtë rast po botojmë një tregim të autorit marrë nga përmbledhje e tij e tregimeve "I dashur i saj i parë".

VAJZAT

Tregim nga
Vath Koreshi

Njëherë, kur isha 10 apo 11 vjeç, më kujtohet se shkova me nënën në shtëpinë e një mikut tonë. Nga Lushnja qemë nisur në mëngjes herët e u deshën gjashtë orë e ca rrugë nëpërmes një vape të tmerrshme gjer sa arritëm në Berat e pastaj në atë shtëpizë të vogël në rrëzë të kalasë. Vërtet që sot në Berat arin për një orë, po asokohe ishte fat i madh të gjeje maqina, prandaj shpesh udhëtarët e bënin rrugën me ca karroca me katër rrota e të hapura si tezgë, që t'i binin zorrët mu në grykë.

Po ne jse. Ne zbritëm në të hyrë të qytetit e astaj muarëm ca rrugica të përpjeta të shtruara me kalldrëm. Unë, që i shihja të gjitha këto për herë të parë, habitesha me atë lagje të çuditshme, me ato shtëpi të rrasura njëra pranë tjetrës që nxirrnin kokat lart si ai njeriu që përpigjet t'i shpëtojë mbytjes. Rrugicat ishin të ngushta, në të majtë e në të djathtë dukeshin portat e vjetra e të ronitura nga krimbi si ca gojë të frikshme e në zemër të futej padashur një ndjenjë zymtie që të zinte frymën. Ajri ishte i rëndë e i ngrohtë, atje lart dukeshin shkëmbinjtë e kalasë si një katarakt i gurt që binte nga qielli e përpara të gjitha këtyre njeriu e ndjente veten të mërzhitur.

As që më bie ndër mend se sa zikzake bëme përmes asaj lagjeje të çuditshme, po më kujtohet si tashti porta ku hymë, një portë e vjetër me një hark të gurtë përsipër me një dorezë bronxi të nxirë nga koha. Në oborr na priti një grua e shëndoshë e veshur me të zez. Mbas saj doli një vajzë e re si nja pesëmbëdhjetë vjeç, me një triko në dorë e me një buzëqeshje të harruar në çipat e buzëve. Nëna u përshëndet me të zonjën e shtëpisë një hop të gjatë aty në mes të oborrit të vogël të shtruar me gurë bojëhiri, kurse unë rrija si në gjemba e shikoja herë gruan e veshur me të zeza e herë vajzën e re që kish ulur kokën e bënte triko. Po më në fund gruaja e ktheu vëmendjen dhe nga unë, më bëri një tok pyetjesh me zë të ëmbël e pastaj i tha së bijës:

-Hidhi një çikë ujë këtij çunit! Qenka mbytur në djersë e të freskohet pak.

Vajza hoqi trikon nga duart e bëri përpara drejt një pusi me çikrik, që ishte në rrëzën e një fiku të egër, ndërsa nëna me të zonjën e shtëpisë i ngjiten lart përmes ca shkallëve të drunjta që kërcisnin.

Unë i vajta pas e vajza hodhi kovën në pus, duke mbajtur në dorë litarin që shpështillej nga çikriku.

-Do peshqir? – më tha.

-Jo, - ithashë – kam shami.

-Me maqinë erdhët?

-Jo, me karrocë.

-Vete në shkollë ti?

-Po! Kalova klasën e tretë.

Ajo më shikoi me vëmendje, ndërsa në fshihesha e shikoja nga porta.

-Po ti vete në shkollë? – e pyeta unë.

Ajo heshti një hop, duke rregulluar kovën në grykën e pusit e pastaj tha me gjysmë zëri:

-Jo! Kam bërë dy klasa dhe unë, po...

Vura re sytë e saj bojëkafë se si u vrenjtën për një hop e si i shtrëngoi buzët e holla. Po ky qe vetëm një çast, sepse mua më erdhi zor të pyesja më tej. Ajo u çel në fytyrë e më tha:

Hajt të ngjitemi lart. Do të flesh?

-Jo, - i thashë unë.

-Mirë- tha ajo, - hajt të rrimë te minderi. Minderi ishte pranë një dritareje të vogël; që andej dukeshin dhjetëra ççati të nxira e më tej hapej një panoramë e bukur mbi kopshtijet në breg të Osunit. Ne rrinim aty e bisedonim, ndërsa nga dhoma tjetër vinte zëri i nënës, që bisedonte me të zonjën e shtëpisë. Tashti më kish ikur gjithë ajo mërzë e sepse më dukej aq e bukur ajo panoramë që hapej nga dritarja. Po mbas pak vajzën e thirri e ëma. Ajo u ngrit e doli si me përtim e që prej atij çasti s'pata më rast të rrija me të. Dola dhe unë e shkova te nëna.

-Uu, po ty të qenka rritur djali goxha, moj xhiko...

-Eh, të lumtë goja, moj hanko... po ka lëshuar trup, se vjeçtë s'i ka aq sa tregon.

-Mashallah, mashallah. A të hyri në unike moj xhiko...?

Jo, moj hanko...sivjet kaloi në të katërtën. Gruaja më shikonte buzëqeshje me dashamirësi, kurse unë heshtja e më vinte turp që flisnin për mua.

Vajza hynte e dilte, po unë s'e çoja kookën, vetëm se dëgjoja frushullimën e fustanit të saj. Ajo binte ndonjë gjë, rrinte ndonjë hop në këmbë e ndërkaq e ëma kthehej nga ajo dhe e ngarkonte me ndonjë punë tjetër.

-Shko na mbush ujë, të keqen! – i tha ajo një herë.

-Ja, nënë, tashti e mbusha.

-Tashti thotë! Mbushna, moj ujë; ky u ngroh.

Po uji s'ishte ngrohur fare e vajza doli me shtambë në dorë.

Unë asokohe as që i kuptoja këto. Tashti që kanë kaluar kaq vjet e di fare mirë se kankua i rrinte së bijës mbi kokë.

Nuk e di si erdhi njëherë fjala rreth një fqinje që kish turpëruar shtëpinë. Kankua fliste me zjarr e skulte faqet, duke derdhur njëmijë fjalë menjëherë...se një vajzë na paskish marrë mendjen atyreleshprerave. Përleshprerat, nga gra si hankua, asokohe flitej sikur ato të kishin bërë turpet e botës. Gjithë jetën e saj hankua e kish kaluar prapa atyre mureve. Kur dilte, dhe kjo ndodhte shumë rrallë, vishte një çarçaf të zi e hidhte perçe në fytyrë. Si mund të dilte gruaja kokëzbuluar e të nxirrte në shesh pulpa e llërë? Pupupu! Ishin punëra që s'bëheshin. Dhe ja, vajza e filanit, që hankua ja njihte me rrënjë e degë prindërit, të cilët ishin njerëz namuzli e s'u kish dalë kurrë fjalë e keqe, kish ikur nga shtëpia e kishte shkuar në hekurudhë.

-Pupu, si u bënë vajzat sot, moj xhiko, të keqen! Ec e mos i ruaj po deshe. Unë njëzë kam, po më ka hipur frika e mezi pres që ta martoj. Fundi në shtëpi të botës ka për të shkuar, pra hë, një sahat e përpara.

-E keni zënë gjëkund, moj hanko?



-E vluam, e vluam me një njeri të perëndisë. Është i urtë, ia di hallin shtëpisë. Ç'duam më tepër ne?

-U, u, po ti pse s'thuhet, moj hanko? Epo mirë de, t'ju trashëgohet.

Nëna e la fjalën në mes se atë kohë hyri vajza me ca gota në dorë dhe i vuri në raft. Ishte bërë flakë e kuqe e dukej mjaft e mërziur. Ajo i hodhi vjedhurazi një vështrim të egër së ëmës e mua sepse më shtrëngoi aq fort një gjyç i pashpjeguar në grykë.

Fjalët s'kishin fund, më bëhej sikur po më zihej fryma e doja aq shumë të dilja përjashta e të merrja ajër të pastër.

Vajza doli prapë e hankua i shkeli syrinë nënës e qeshi, duke zbuluar dhembët e florinjtit:

-Epo doemos. Shkollën e mbaroi?

-Uu, shkollën!, Jo, jo, të keqen. Goca në shkollë tërbohët. Sa të na bënte ndonjë proçkë, më mirë e hoqëm fare. Ja, le të rrijë e të bëjë pajën. Vafti po i vjen...

Mbase ajo i dëgjonte të gjitha ato që thueshin, se nisi të vijë më rrallë dhe dukej krejt e dërmuar. Nga fytyra i qe zhdukur gjallëria e parë, faqeve u kish rënë një i zbehtë i lehtë e këmbët i hidhte si me përtim në atë dysheme të vjetër që kërciste.

Të nesërment u ngritëm që në mëngjes dhe ikëm. Unë ndjehesha shumë i gëzuar që po iknim, po megjithatë se ç'kishin diçka thellë në zemër që më mërziuste e më brengoste. Zbritëm në oborr e vajza m'u duk shumë më e zbehtë; në sytë e saj kish diçka si lodhje, diçka të errët e të dëshpëruar. Ajo buzëqeshi një grimë, duke na dhënë dorën e sepse të trishtonte aq shumë buzëqeshja e saj! Po të më kish ndodhur shumë më vonë kjo ngjarje, unë atë vajzë do ta kisha krahasuar me një lule të bukur, që kish mbirë në mesë të atyre gurëve bojëhiri, e cila zbehej nga dita në ditë nën peshën e tmerrshme të një paragjykimi të mykur. Ajo s'ishite aq e fortë sa ajo vajza e fqinjit që kish vajtur në hekurudhë, prandaj qe tulatur e priste me drithërima zemre të ardhmen e saj të panjohur. Oh, sa dëshira mund të kish ajo vajzë në zemër, sa e sa ëndrra si atu ujërat e thella jetëdhënëse që rrjedhin në damarët e tokës! Po për të gjitha këto asnjëri nuk dinte, as njërit ajo s'mund t'i thoshte për këto vegime të vagëlluara, që ndizeshin në shpirtin e saj. Ajo kishte ulur kokën e priste ta merrte rrota e fatit. Unë atëhere vetëm e vështrova e më erdhi keq që e lashë prapa asaj porte të vjetër me hark të gurtë.

Dhe ja, tashti mbas 17-18 vjetëve, në këtë mbasditë të nxehtë korriku, rri i ulur në një gur përpara Kombinatit "Mao Ce Dun" e pres të vijë ndonjë maqinë për në Berat. Përpara meje hapet një pamje plot ndërtesa që s't'i kap syri dot menjëherë. Dikur këtu ishte një fushë e shkretë; më tej dukeshin kodrat e zhveshura argjilore, pastaj u hapën themele, u ngjitën qindra shtylla e kapriata betoni si një pyll i dendur dhe i fortë e ja tashti kjo vepër e madhe është në të mbaruar.

Diku bie çanga. Ora mund të jetë dy, e nga dera dalin një grumbull vajzash të reja. Në fillim duken katër-pesë. Njëra, një flokëverdhe me një bluzë të hollë e me fund me pala, tregon një anekdotë gazmore e të tjerat qeshnin me të madhe.

-Tjetër, Lika, tjetër!

-O, mjaft unë. Hajt, radhën e ka Hajrija.

Dhe Hajrija tregon.

Mbas tyre dalin dhjetë të tjera, pastaj grumbuj të tjerë e mbas pak rruga mbushet plot me zërat e ture gazmore. Janë kursante që mësojnë në Kombinatit e Tekstileve "Stalin" në Tiranë, po tashti kanë ardhur të bëjnë punë vullnetare në kombinatin e tyre të ri. Do të kalojnë pak kohë e mëngjeseve në këtë rrugë do të duken disa mijëra vajza e gra që do të punojnë në repartet e këtij kombinati. "Sa nga ato do të jenë nga ajo lagja ku isha dikur?" - mendoj unë. "Dhjetë, pesëdhjetë, njëqindë... Kushedi. Veç me siguri që nga ajo lagje do të jenë shumë".

Duke parë atë grumbull ngjyra-ngjyra, m'u kujtua gjithë ajo histori e trishtuar.

Eh, dil, moj hanko, e shih dhe mos i shkul faqet.

AGIM, ÇAST DELIRI...

Poezi nga
Shazim Mehmeti

SHOHIN SYTË E ZEMRËS PËRTEJ XHAMIT PANDEMIK T'SPORTELIT...

Shohin sytë e zemrës
përtej xhamit pandemik t'sportelit:
një maskë e zezë
mbi një fytyrë mister;
dy shndritje,
a dy xixa syshë ndezur;
duar mahnitëse;
thonj bilur;
gishta të hollë, të gjatë,
që cicërrojnë si zogj mbi tastierë;
qafë a gushë e paharueshme
që pulson
sikur flet,
sikur këndon;
flokë të zëna n'faj;
lëvizje e zbuluar gjoksi
që trand, trand, trand;
mish i bardhë krahësh,
joshës, joshës, joshës;
dhe ky epsh, o Zot, o Zot,
ky epsh,
ky epsh,
ky epsh...

Epo,
kjo vërtet është gjendje:
e martë e dytë e gushtit,
pandemi - erë vdekjeje,
bankë, sportel dhe qelq,
dhe përtej atij qelqi,
ajo femër, o Zot, o Zot,
ç'dritë,
o ç'lule,
ç'ëndërr!...

GRUA!...

Grua!...
Po pra, grua!...
Mëlmisë e jetës, a limfë rinimi,
që ua bën të mundur ditëve
shumëzimin edhe shkuarjen
tutje në t'ardhme.
Ajo ç'u lë shenja gjaku
shekujve të pambarimtë
t'dhimbjes e t'gjakut.
Pranvera, nga fillimi n'fund,
e të gjitha stinëve.
Pranvera edhe e dimrave
më t'acartë t'mendimit.
E qorrit, drita je, grua -
formë e shpirt, shpirt e formë - dritë e lagur.
Dritë përthithëse
e shdërrimit më ndijor.
Shprehësi e lakuriqar
e bukurisë hyjore.
Acar e zjarr - grua -
zjarr e acar.
Acar i zjarrit të gjithë zjarreve.
Zjarr i acarit të gjithë acareve.
Kripë e plagës, kripë e bukës.
Frymë, frymë e frymës.
Frymë, përherë e munguar,
edhe kur je
me shumë, shumë frymë.
Frymë që t'deh, t'përthith
deri n'harrime,
deri n'përcëllime...
Grua, pra!
Po pra, dritë lakuriqe!
Më e përkryera sajësë
e dëshirimit
të Zotit n'Tokë!...

NUDO...

Baaahh,
ç'ditë, ç'qiell,
ç'muzikë e dritës!



Ç'i kaltër qielli!
Ç'i kaltër qielli
atje lart,
me atë ré vetmake,
shpinas shtrirë,
si një grua e bukur,
flokëlarë,
gjishpluar,
lakuriqe.

Shih e ndij,
ndij e shih, o Zot:
nudo dita,
nudo qielli, réja,
nudo muzika, drita,
nudo kjo dehje,
ky mendim...

AGIM, ÇAST DELIRI...

Përtej dritares,
tutje majëmalit
dita qet krye -
si zog i sapolindur,
sytë i përpëlit agimi.

Derdhur, derdhur
flokënajë e gjumit,
e mbi shtrojnë ngjyrëvjollcë,
shpluar m'shpërfaqet
trupi yt i ëndërrt,
i bardhë, i hollë, i njomë -
lule trazimi.

Dritarja të vëzhgon,
rrezja e parë e dritës
hollë-hollë ta prek barkun,
një flutur zbret, ulet
mbi gjirin tënd.

Ta trazoj
këtë flutur ëndrre?...

Oh, jo, jo!
As pahiri!
Madje,
edhe kjo dorë e ngrohtë
e prekjes
mund ta zhbëjë
këtë çast deliri...

GRUA ENGJËLLORE

Ajo është e fjetura
e mëngjeseve të mia.
Ajo është molla ime,
luleja ime që fle gjatë -
molla ime shijemjaltë.
Ajo erëmon e fle
sa nata n'ditë,
sa dita n'natë.

Ditë më ditë
u bëj lak mëngjeseve,
dritës i bëj lak:
i ulem asaj gruaje mbi krye,
dhe tekta e shikoj
ashtu të qetë e t'fjetur,
më vjen t'ia ha fytyrën,
gojën më vjen t'ia ha,
t'ia ha hundën, sytë...

Çudi gruaje ajo gruadritë:
sa më gjatë fle,
e sa më shumë mplaket,
aq më engjëllorë m'bëhet!
Erëmuose, e pjekur, e ëmbël,
tamam për ta ngrënë!

(Por, por, por...
si mund, vallë, ta ha,
kur mbetur jam, mbetur,
si një ujë i mplakur
pa fije dhëmbi n'gojë?..)

FTOHTË PËR ËNDRRA MITURAKE

Poezi nga Vjollcë Berisha

Jemi dy gazeta
Mbledhur shuk
Në plagën e mbrëmjes

Zilkat kanë rënë.
T'i biem në fund kësaj rruge
Sa kemi frymë

Qershi të ëmbla të varim në veshë,
Sy e flokë,
Perëndime të arta të këpusim e në shportë t'i vëmë,
Gjysmëzgjuar të flemë sa për të thënë që fjetëm
Për inat të mullarëve të vetmisë

Gjysmëzgjuar, pa e humbur plotësisht këtë ditë
Ti fishkëlle atë këngë me selvi e myreqep,
Unë do mbaj ritmin kallur ninëzave të tua

Lotët s'kanë si vijnë e shuajnë
Zjarrin që ua vëmë mullarëve të vetmisë.

DRIZË

Nuk thoshte asnjë fjalë
se gjuha kishte mëkatet e veta të shumëfishta.
Netëve dëgjoja fëshfërimën që lëshonin lëkurat e ngjitura
dhe lutjet e tij për mua.

Edhe sot, tek shkruaj
e vetmuar në kthinën time,
ndjej si rrëshqas në po atë borë
që e shkelëm të dy asaj stine,
si vrapoj prapë në flladin e lagjes së evgjitëve
ku më shpinte mbrëmjeve e ne merrnim thua
në mbetjet e haresë që patën ata,
në mbetjen e endacakërisë që vinte nga
të vdekurit e tyre të largët...

Edhe sot e mërmëris të njëjtën vjershë,
e ritregoj të njëjtin rrëfim të Bulgakovit,
u vë po ata emra frutash kafeneve,
po ato karikatura vajzave që i xhelozoj për vdekje...
(Dëgjoj tek lutet ai heshtazi për mua...)
Prapë më bien ndërmend ëndrrat që i kisha lidhur tok
si letra të vjetra
dhe s'më tremb asnjë ferr.

Kur ti kërkove t'i zbrisja shkallët e dashurisë,
unë u lëshova një nga një në to
me kyçin e këmbës që më dhimbte,
kapur në parmakët e drurit
që ëndëroja të ishin prej Gështenje.

E mira që të dija të rrokullisesha
apo të ma kishe dhënë një të shtyrë...
Do zhurmoja pak si enë boshe prej bakri,
pastaj do ripërtirja ashtin për ca muaj
e s'do zvarritesha kështu keq:
me kyçin e këmbës së përdredhur,
me dritat harruar ndezur atje lart,
drejt në terrin e rrugës
pa një yll.

LERMË TË TË DASHUROJ SI DUA

Lermë të të dashuroj si dua
si mundem
me të tëra çezmat e ndjenjës shpërthyer

Rubinetat më micërojnë
Lumenjtë e rrëmbyeshëm janë arti im
Ndjenja ime e pafre

Lermë të të dashuroj si dua
me të tëra këngët e dhimbjes që di.
filozofët më grijnë me briskun e tyre
unë rapsodin vetmitar ëndërojo.

Të shoh si rri kruspull në një bucë dheu
ke frikë të përfshihesh nga flakët që lëshoj
ke fshehur sytë, duart, zemrën...
dhe beson se je avulluar
si ai fëmija që është i sigurt se po zhduket
tek i mbyll sytë.

Mua më gëlltit zjarri
më bien trarët një nganjë
më shkumbohen dëshirat mu në hundë
nga brinjët si bori zije buçet ulërima:
"Lermë të të dua"

Lermë të të dua si mundem
si di
me dashuritë e të gjitha grave bashkë
që s'guxuan të të dashurojnë
me ëndrrën fluturake të vogëlushes
që u drodh nga frika mos po ia zbulon praninë.

Lermë të të dua me rrëmbimin e lumit
që ngutet ta prekë vdekjen
me honin e atij që sapo ka lënë një qytet
me preken e butë siç prekim një kone
me çmendurinë e atij që hidhet nga kati i shtatë
me mallëngjimin e atij që kthehet.



Lermë të të dua e të besoj se ishe këtu rrotull
teksa po flija gjumë.
Lermë të të marr e të të shpie në vise ku s'ke qenë,
ku këmbë e burrit s'ka shkelur ende
jo se duhej flatra për të vajtur
po pse s'patën fuqi të dashurojnë tepër
e s'na lanë t'i duam as ne.

Lermë të të dashuroj si dua

Rrugët janë ngushtuar ndër vite
Re të tjera hedhin shi me gjym
Emri i shkrimtarit kroat në tabelë
Vjetëron qetaz pa kundërshti.
Një tavolinë i bie ndërmend
Një mur lokali që mban erë myk
Një shitës esmer gazetash
Dhe një burrë
Një burrë i zakonshëm shpatullgjërë
Një burrë i kushedi cilës grua.

PËR DIMRIN QË SHKOI

E fundit ka për të qenë ndoshta
Kjo borë që ra e s'e shkelëm dot
Një ditë midis luksit e ditëve të ngrohta
Do vuajmë si s'u deshëm kot më kot.

Si nuk u shtruam në një bisedë azgane
Diku në një tavernë, me mbulesa kuti-kuti
Me zërin mëndafsh të ndonjë cigane
Me plot andrralla e me pak raki.

Si nuk e pamë tek binte ajo borë,
Si nuk u ulëm pranë e pranë një herë
Si e vumë përposhtë dimrin e gjorë
Me dëshirat tona që i lamë nderë.

Askush s'na pa buzë më buzë puthitur
As me çap të lehtë duke shkarë mbi re
Sa mall do të endnim po ta kishim ditur
Se gëzimi i fundit dimri i vjetshëm që.

FTOHTË PËR ËNDRRA MITURAKE

Në majë të gishtave
shkelëm shkretëtirën që kemi brenda,
mbyllë gojën për të mos thirrë nga gëzimi

Këtu më parë s'ka çapitur kurrkush
as thembrat s'i shtrijmë rërës së vjetër

Bën vonë për gëzime të mëdha,
bën ftohtë për ëndrra miturake

Me hukamë, midis pëllëmbëve,
i ngroh do ditë
t'i mbaj edhe pak.

Nesër kur shpirti ynë t'i tërheqë drejt fundit lopatat në
varkën vetmitare,
mbi atë lumë tërë rrëmbim që solli kaq gurë me vete
e që dikush u kujtua ta quante Jetë,
do të kuptojmë ç'deshëm në të vërtetë
kur thamë "jo" para një djali fisnik a para një cuce besnike,
kur u ulëm në gjuhë para një poshtërimi teksa pendimi
përgjonte në dhomën ngjitur,
kur fjetëm nën qiellin e hapur
a kur i dhamë xurxull makinës në funde betejash me një
gotë,
kur bëmë krenarin për ta heshtur tutcin
kur i vumë emra gurëve që solli lumi
(i quajtmë: lumturi, vetmi, pikëllim, mall, afsh,
çmenduri...),
pa e ditur se trazoheshin aq letë dhe se ishin copa të po të
njëjtit shkëmb.

Do ta kuptojmë ç'patëm dashur në të vërtetë
kur varka të ketë bërë një copë rrugë.

GISHTAT E NANËS

Tregim nga Shpresa Qeriqi

Vorbulla e një përjetimi të tytmë turbullon sot mendimet e mia, dhe si illum i errët më thahet në shpirt; dhembja e re më kthen të vjetrën në ofshamë. Njëmend, që nuk kam menduar ndonjëherë se kam patur të bëj në ndonjëfarë mënyre me këtë ngjarje, ani që e gjithë çfarë ndodhi që një fatkeqësi, as sot përpara juve zotërinj, nuk e heq dot ndjenjën e shkoqur që unë mora pjesë në të.

E para e punës, si nis një luftë? Mua më është dhënë të mendoj, fjala vjen, e zëmë sikur livadhet me bar e lule janë përgjegjës për hijeshinë e tokës, nëmos përgjegjës duhet të jenë edhe për dëshirën që ndjellin tek kosarët, sepse edhe këta të fundit, jo më pak përgjegjës duket se ndihen për hijeshinë e saj. Të them të drejtën, mua për vete një tjetër e vërtetë e vrazhdë ma mbush zemrën me frikë, një tjetër ma mbush zemrën me brengë.

Quhem Vuk J. jam lindur në tetëdhjetë e shtatën. Siç më kishte thënë nana, ishte hanë e plotë. Babi kishte vdekur një javë pasi mbusha tre vjeç. Ne, domethënë nana dhe unë jetonim filikat. Nana vdiq pardje! Ishte e gjymtë dhe tullace. Flokët i shkuli ajo vetë, por gishtat i ranë (i pashë unë si i ranë).

Oh, ju lutem shumë, ju e dini mirë çdo të thotë shtëpi. Kujtoni shtëpinë e fëmijërisë suaj, a nuk është aromë e saj prej trëndafil? (A nuk është?) A nuk e bënë prania nanës atë kaq të ndritshme, a nuk e bënë ajo kaq të ngrohtë? Kujtojeni zërin e saj si këndon kur gatuan, ose...kur ju zgjon nga gju-

mi. Kujtojeni si ju puthën buzët e saj çdo mëngjes. Imagjinojeni se ju përfaqon, pastaj se ju puth kur ju vë në gjumë. Kujtoni krahët që ju mbanë, dhe sytë që pasqyruan mrekullinë. A nuk janë duart dhe zëri i saj butësi e Zotit? (A nuk janë?) Edhe një gjë të fundit, oh, ju lutem shumë! Imagjinojeni sikur zgjoheni një mëngjes, uleni për të ngrënë si gjithmonë përballë, por ajo nuk buzëqeshë më. Përpara syve tuaj shfaqet pandal, mëngjesi i mjegullt i tre gishtave të saj që ranë, pastaj më tregoni ju lutem, me ç'shije do t'ju vinte supa?

Ne kishim edhe një shtëpi tjetër, por të vjetër, jo shumë larg shtëpisë sonë. Në pjesën e përparme të shtëpisë, të dyja dhomat kishin nga një dritare, por të dyja të mbrojtura me shufra metalike. Nana u kishte dhënë leje të rrinin tek shtëpia, derisa të mbaronte lufta. U kishte dhënë bukë, ujë dhe mbulesa. Për tre ditë me radhë u ndezi zjarrin. Në kujtesën time nuk ishin më shumë se pesë a gjashtë veta, burra, gra dhe një fëmijë.

Një mëngjes të lagësht mjegullngjeshur, shtëpia e vjetër mori flakë. Përveç fëmijës që i binte xhamit, të gjithë të tjerët dukej se ishin në gjumë (ndoshta edhe vetë Zoti). Nana, pothuaj nuk e ndjeu fare, që gishtat i preu me sëpatë kur përpiquej të thyente derën, por kur e shastisur me shuplaka shtrëngoi faqet, njëmend unë pashë veç si i ranë. Për pak sekonda, ajo mbeti e ngrirë, pastaj lëshoi një britmë të mprehtë thujse të pafundme, si ato britmat që lëshojnë gratë. Ajo pa me kukamë. Unë pashë

Studim duarsh, nga Leonardo Da Vinci



si syve të saj refleктоhej ferri. Më duket se u tremba nga vështrimi i saj dhe qava. Dhe më kujtohen tymçe piskama dhimbjesh të gjata therëse, të cilat u ngritën mbi majat e pemëve, dhe minuta më pas gjithçka ra në heshtje, trarët ranë, flokët dhe gishtat e nanës gjithashtu. Asnjë forcë njerëzore nuk mund të bënte gjë.

Sot përpara juve zotërinj, gjithë ç'mund të lidh me fjali, nuk e thotë askurrë gjendjen e fajshme shpirtërore, në të cilën kam rënë. Nanës i kujtohej një emër, një fytyrë, asgjë tjetër. Një fytyrë e ngrysur, flokët kaçurrela, hundë e mprehtë dhe sy të hirtë. Mua për vete, nuk më kujtohet më fytyra e fëmijës që i binte xhamit, por mbaj mend që kishte veshur një xhup të kuq. Nuk ia ndaja sytë dhjetëra fotografive të varura në rrethoja, sa herë më qëlloi puna në kryeqytet. Të them të vërtetën seç kisha frikë nga gjithë ato fytyra, të padepërtueshëm i kanë sytë. Sa herë matesha të kërkoja falje, po aq herë zbrapsesha me frikë. Frika e nanës, që askush nuk do të na besonte, edhe mua më lidhej në grykë.

Sot përpara juve zotërinj, unë nuk kam as edhe një dokument, apo as edhe vetëm një argument, pos kërcitjeve të dërrasave, vajeve të mekura, dhe zërave të largët, që nana i shihte zgjuar. Çdo mëngjes nana ngrihej dhe shihte në dritare, me kryet që i shkundej nga njëra anë tek tjetra. Dhe ajo e bënte sërish pas një ore, pas dy ore, pastaj ulej, pastaj shtrihej, dhe me vrull ngrihej prapë. Kur e kur shante dredhën e zërave në kokë, herëherë i binte me grushte dhe qante. Dhe ajo e bënte sërish pas një ore, pas dy ore, dhe ajo ashtu bënte përditë. Ç'është e vërteta, përgjatë gjithë këtyre viteve kam mbajtur veshët ngrehur për zërat që kumbonin, për kërcitjet që lëshonin dërrasat, për ata që vinin natën dhe ecnin somnambul nëpër shtëpi. Përgjatë gjithë këtyre viteve kam mbajtur veshët ngrehur, por unë as nuk i pashë, dhe as nuk i dëgjova deri një javë përpara se të vdiste nana.

Nuk desha ta kuptoja, nuk desha ta dija të vërtetën atëherë, por tash që nana vdiq, i vetëm jam mes zërave, dhe kollitjeve të thata e t'pafrymë. Ja tek janë, ata vijnë përnatë me piskama, përvidhen bashkë me fëmijën që qan e lutet, pastaj me grushte i bien xhamit.

Çfarë duhej të thosha? Tash, çfarë presin ata nga unë, kur unë nuk e di as cilët janë?



Milorad Pavić

LUNDRIMI I ZGJATUR INATËS

(Historia e trupit dhe e shpirtit)

E përktheu Nikolla Sudar

„Asnjëherë mos qëllo, nëse krisma e armës tënde nuk dëgjohet, të paktën, në tre shtete.”

Me këto fjalë Pavle Shjollkovollosi, i bukur si një ikonë, por i tëri i pagdhundur dhe i egër, doli në rrugë të madhe. Në Primorje, ku dielli nuk çmohet më shumë se kashta e lopës, duke grabitur bagëti dhe karvanë me erëza, ai shkelte ligjet e tri shteteve, të Venedikut, të Turqisë dhe Austrisë. Rastësisht një të shtunë, një tregtar ia futi tytën e pushkës në gojë dhe e shkrehu, mirëpo arma iu bllokua dhe Shjollkovollosi ia përcëllloi gjuhën baruti. Që nga ajo kohë ai humbi aftësinë për të shijuar dhe për të ishte njëlljosi si të mbante në gojë thithën e gjirit të një gruajë, apo të shijonte fasulet me kastravecë. Qysh atëherë peshqit i pastronte dhe i piqte pa i mbytur më parë, kështu që i ngulur në shpatë, peshku akoma i gjallë dridhej mbi zjarr. Pavle gjithmonë ecte rrugës me majën e shpatës që i dukej nga jashtë, sepse ishte betuar se do ta mbante ngjitur me pantallonat, vetëm atëherë kur ta fuste në këllëf.

Ditën e Shën Jurit ai u ngop me bukë e djathë dhe priti për të parë se në çfarë mendimesh do të shndërrohej ajo që kishte ngrënë, sepse burrit mund t'i lindin mendime, vetëm kur ha bukë me djathë. Atë ditë në mal ai ndeshi Velluçen, bareshën që jetonte pa të atin, me nënën e motrat. Vajza asnjëherë nuk i kishte parë allatet e një mashkulli, por vetëm te dashi, madje edhe ato të pjekura, kurse mashkullin e kishte parë vetëm të gdhendur në dukat (monedhë). Kur nga pylli iu shfaq Pavle Shjollkovollosi, me atë gërshet të thurur bashkë me mustaqet, vajzës iu duk se po i buzëqeshte dielli.

Një shpirt i madh e i panjohur qëndronte para saj, si i kryqëzuar në drejtim të dritës, si një lëkurë e tendosur dhe e zbrazët si nata. Por në të vërtetë në të, ashtu si në errësirë zinin vend qytete dhe pyje, lumenj dhe gjiret e detit, gra dhe fëmijë, ura dhe anije, kurse në fund, plotësisht në fund, ndodhej trupi i brishtë dhe i mrekullueshëm i këtij shpirti, i cili, si një shkëmb i madh, e shtynte furishëm lart. Vetëm buzëqeshja, e cila i shfaqej tamam si vezullim, për një çast i zbulonte pakëz se pas kësaj nate nuk do të kishte zbrazëti dhe se përmes trupit mund të futej edhe në shpirt. Kurse këtë buzëqeshje, burri sikur e kishte ndeshur diku, në një botë tjetër, ku vetëm me buzëqeshje mund të jetohej dhe ia kishte sjellë asaj, këtu, në Zagorjen dalmate, ia kishte sjellë asaj, Velluçes, si një frutë shumë të çmuar, i cila duhej provuar, ose duhej të vdiste...

Velluçë vështronte buzëqeshjen në fytyrën e Pavle Shjollkovollosit dhe kjo ishte e fundit gjë që pa në jetën e saj. Ajo e pyeti si e quanin dhe këto ishin fjalët e fundit që dëgjoi në jetën e vet. Ai e goditi me kondakun e pushkës dhe po aty, po në atë vend, gjysmë të vdekur e përdhunoi, tamam sikur po hante peshkun gjysmë të gjallë. Pastaj mëngjesin e asaj dite e shiti vajzën në njërin nga anijet, në të cilën u lejohej të gjitha grave të udhëtonin nga njëri port në tjetrin dhe u largua nga ajo buzëqeshje, që shndriste në errësirë, kurse Velluçen nuk e pa më. Vajza mbeti si e lajthitur nga tmerri, nga zgjimi i ndjesive, nga frika, kurse nga goditja u verbua dhe u shurdhua për gjithë jetën.

Kështu filloi lundrimi në errësirë i Velluçes së verbër.

Çdo vizitor, duke u ngjitur në bordin e anijes, blinte një unazë prej bakri dhe një libër të vogël me kapak ngjyrë ari, të botuar në Venedik, me përshkrime të hollësishme të vajzave që jetonin në anije dhe me të gjitha mënyrat që ato kënaqnin mikun, i cili frekuentonte kabinën. Norma ishte dhjetë meshkuj në ditë për një vajzë dhe kështu ato lundronin nga pranvera në pranverë, nga porti në port, të habitura nga fakti se si e gjithë bota ua dinte emrat dhe hiret. Vizitorët e mbrëmjes i linin unazat në anije, pasi ua vinin në gisht të zgjedhurave të tyre, kurse ato duhej t'ia kthenin kapitenit, nga një unazë për çdo gisht, një për çdo nga dhjetë vizitorët e rinj të së nesërme. Kurse librat vizitorët i merrnin me vete dhe ua dhuronin më pas miqve. Kështu mbyllej rrethi, por jo me ndihmën e unazave, të cilat gjithmonë mbeteshin në anije, por me ndihmën e këtyre librave të vegjël.

Meshkujt dashurojnë me shikim, kurse femrat me dëgjim, megjithatë Velluçë dashuronte më mirë se të tjerat. Të ardhurit në anije gjithnjë e më tepër kërkonin me ngulm pikërisht atë; fshehurazi i prisnin ndonjë cullufë nga flokët dhe ua dërgonin në letër kushërinjve, në mënyrë që ta njihnin, kur edhe vetë të ndodheshin në anije.

- Gruaja nuk është sapun dhe nuk shkrihet, - thoshin për të, duke qeshur dhe fama për Velluçen përhapej më vullshëm sesa shpejtësia e anijes, përveç kësaj, askush nuk ishte në gjendje të përshkruante mbresat nga takimi me të, por gjithçka shprehej me lëvizjet e duarve dhe fishkëllimat. Unazat prej bakri nganjëherë ia vinin edhe te gishtërinjtë e këmbëve, sepse ndodhte që në duar nuk

kishte më vend. Por ajo nuk shihte dhe nuk dëgjonte asgjë nga ato që ndodhnin me të e rreth saj dhe vazhdonte të ishte më e preferuara nga të gjitha.

- Ditën mendja i punon më shpejt sesa zemra, ndërsa natën ndodh e kundërta, - pëshpëritnin vajzat e tjera. Duke vënë e duke hequr unaza, Velluçë e verbër përshkoi me anijen e grave gjithë detet, Adriatik dhe Jon, nga Ankona në Venedik, nga Bari deri në Durrës, nga Dubrovniku deri në Korfuz dhe vetëm pas një kohe të gjatë rastësisht kishte thënë:

- Sa i çuditshëm më duket ky fshati, në të cilin jetojmë; të gjithë bodrumet janë nën tokë, kurse rrugë me diell pothuajse nuk ka, ndoshta për këtë arsye gjithë kohën lëkundet...

Vetëm atëherë u bë e qartë se ajo nuk e dinte se ku ndodhej. Pasi ia lëshuan dorën në ujën e detit, ia shpjeguan se jetonte në një anije. Si edhe më parë, Velluçë nuk shfaqti shqetësim, vetëm nganjëherë shihte në ëndërr sikur veshët, pasi i shkëputeshin nga koka, tamam si dy bathë, fluturonin drejt tokës që t'i sillnin asaj zërin apo emrin e dikujt. Por kur zgjohej, veshët plotësisht të zbrazët ishin në vendin e vet. Nganjëherë, ashtu e shurdhër, i binte fyellit të vet të bareshës; mirëpo fyelli tashmë prej shumë kohësh nuk nxirrte më asnjë melodi, madje as edhe një piskamë. Ç'është e vërteta, Velluçë këtë gjë nuk mund ta dinte. Për të folur, ajo pothuajse nuk fliste fare, tamam sikur druhej se, bashkë me fjalët, prej saj do të rridhte gjak.

Në të vërtetë, ekzistonte një përjashtim i vetëm. Ajo pohonte se erërat, të cilat lëkundnin anijen e tyre, mund ta bënin me fëmijë. Vajzat e tjera e dinin se të tillave si Velluçë, me të vërtetë ndryshimi i erës u sillte një dashnor të ri dhe se ajo me gjithë mend nga kjo gjë mund të mbeste shtatzënë. Ndërkohë ato dëgjonin me tmerr se si ajo lutej për diçka të tillë, së cilës i trembeshin kaq shumë. Ajo qëndronte mbi kuvertë dhe u lutej erërave. Ato ishin si një kishëz për të. Vajza i thërriste ato me emër, duke iu përgjiguar që t'i dhuronin frutin.

Velluçë u lutej erës së perëndimit, apo asaj të malit, me të cilat shkruhen ato që dëshirojmë të harrohen, apo furtunës, në prani të së cilës shitet nderi nga njëri krah, për ta ruajtur në krahun tjetër; i lutej erës së lindjes, gjatë së cilës mëkati i madh të njollos, apo thëllimit, i cili të premtëve nuk lejon rrotullimin e krahëve të mullirit me erë, ngatërron rrugët, mbyll shtigjet dhe gjithçka i kthen në fillimet e veta; i lutej erës së jugut, erës së martuar, e cila si nyjë e mbërthen kullën, tufanit, që të ndihmon të shpëtosh, duke u arratisur, për të cilin i luten Zotit dhe po Ai ua dërgon atë; i lutej erës së mesnatës, prej së cilës



kafshohet gjuha dhe qumështi shndërrohet në gjizë, flladit, që kërkon ndezjen e qiririt ditën e Shën Pavlit dhe prej të cilit mund të prishësh agjërimin, duke ngrënë gjellë me yndyrë. Velluça u lutej erës rrotulluese, që shkëput dorën nga luga, që numëron qimet e pushit të qenit dhe yjet në qiell, erës bastarde, e cila vrapon më shpejt se kali e që mund të të vrasë, duke flakur gurë e që të mpin bërrylat; erës së veriut, për shkak të së cilës karrocat bashkë me pajimet i hedhin në zjarr, erës së verdhë, e cila ndjell keq, prandaj përdoret pasqyra për të zhdukur magjinë; i lutej erës fishkëlyese, fëmijë i erërave, që në gjumë e sipër e çliron kurrizon nga gunga, e që e var në degën e panjës.

U lutej ajo erës Modrik, e cila fryn gjatë ditës, sa që mund të të marrë frymën, duke pirë gotën me verë, erës së nxehtë, e cila u prin ushtrisë dhe kavalerisë, që çan tokën si të ishte spirancë dhe e korr me shpatë, sikur të ishte drapër; po kështu edhe erërave: "Anxhelisë së verbër", e cila është e akullt dhe ta sjellë dëborën në kupë; tufanit me dëborë, prej së cilit flaken edhe kapelat në zjarr; erës Ustok, që shpërndan gjithandej pjesë të turpshme të trupit, nga duhma e së cilave mund të përcaktosh ditët e javës.

Kështu, duke iu lutur erërave që t'i jepnin një fëmijë, Velluça përjetoi rreshe edhe më të këqija sesa ato që kishin provuar ndonjëherë ato vajza. Duke përdorur gjashtë gjuhë, tre dialekte dhe nën rrebeshin e përplasjeve të gramatikave, që i kundërviheshin njëra-tjetrës, ushtarët përpiqeshin ta shfrytëzonin të parët vajzën e, ndërsa anija e grave lundronte përmes vatrës së luftimeve midis Venedikut dhe Austrisë, nga fundi e përfshinë rebelimet në perandorinë turke, që e rrethuan nga Kostandinopoja, në Tripoli, Tunizi dhe Algjeri. Atë e përdoqën po ato pasoja, të cilat përshinin anijet që morën pjesë në luftën e Kandisë. Ajo kaloi përmes flotës venedikase, kur kjo e fundit mori pjesë në rrethimin e krahinave Klis dhe Makarska dhe e vetme nuk e uli asnjë herë poshtë flamurin. Në Herceg-Novi, Velluça mori të parën sëmundje, atë që ia shkatërroi dëgjimin, i cili i kishte pas munguar; në Sicili mori sëmundjen e dytë, atë të syve, vdekjeprurëse për ata që shohin. Përveç asaj, shurdhes Velluçe, të gjithë e kishin marrë vesh lajmin në Zadar se Pavle Shjollkovollosi ishte vlarë nga një turk, i cili udhëtonte me kalë dhe yzengjitë i kishte zburuar me flokët e tij si mëndafsh. Në Shibenik njëri nga vizitorët kërkoi që Velluça të vallëzonte dhe ajo, pasi e pushtoi nga qafa, vallëzoi më bukur nga të gjitha, ndonëse nuk dëgjonte asnjë tingull. Si pasojë e zanatit të vet të vjetër, të gjithë prej kohësh e dinin se kishte lajthitur; meshkujt thoshin se për cilindo prej tyre ajo ruante nga një pikë të ëmbël djerse vajzërore, kurse vajzat e dinin se asnjëherë dhe asnjë grosh nuk i kishte kërkuar pronarit të anijes për zanatin që ushtronte me meshkujt...

Por gjithçka shkoi kot, ajo nuk pati dot fëmijë, kurse më vonë, rastësisht në Korinth, vajzat vunë re atë që e verbra Velluçe nuk mund ta shihte: ajo ishte thinjur.

- Së shpejti edhe gjoksi do t'i vyshket, - flisnin ato me keqdashje. Midis tyre kishte shumë të reja, të freskëta, prandaj edhe nami i Velluçes kishte perënduar. Gjithnjë e më tepër po rralloheshin meshkujt që vizitonin kabinën e saj në anije. Gjithnjë e më rrallë po dukeshin unazat prej bakri në duart e vajzës. Një herë shtrati i mbeti i zbrazët gjithë natën dhe vajzat e gjetën me lot në sy. Ato i përkëdhelnin kokën me degëza ulliri, pa e kuptuar përse po qante dhe shtangën kur dëgjuan fjalët, të cilat edhe sot i rrëfejnë njerëzit:

- Pavli Shjollkovollosi im gjatë gjithë kësaj kohe të gjatë, asnjëherë nuk më ka mashtruar, dhjetë herë vinte çdo natë për të më përkëdhelur dhe për të qëndruar pranë meje. Tashmë ai nuk po vjen më. Burri më i bukur dhe i vetmi në botë, nuk më do më. Pavel Shjollkovollosi ka gjetur një tjetër.

Pasi i tha këto fjalë, u hodh në det...

Ai vend edhe sot ashtu quhet, me emrin e famës së saj, e cila nuk përshkruhet dot. Cilido që lundron këtu, lëshon lopatat, tund dorën dhe fishkëllen. E meqë veprohet kështu, edhe unë, ja, në këtë vend po lëshoj lopatat, po tund dorën dhe po përpiqem të kujtoj atë fishkëllimë të shekullit XVII.

PËRSE LEXOJ ANGLISHT

Nga Eni Myrtollari



Në ADRION, në librarinë më të madhe në kryeqytet, gjenden më shumë se 9 mijë tituj në gjuhë të huaj, kryesisht në anglisht, rreth 1500 aksesore të lidhur ngushtësisht me librin, afërsisht 50 agjenda të frymëzuara nga mendjet gjeniale të letërsisë, mbi 200 katalogë arti, mode dhe estetike, rreth 70 botime luksoze e të ilustruara të klasikëve modernë dhe veprash që tanimë cilësohen etalon në fushë (mjafton të kujtojmë veshjen speciale që mbart *The Great Gatsby*, variantin me skica marramendëse të të fortdashurit 1984 nga George Orwell dhe botimin në nder të 20-vjetorit të mjeshtrit të fantazisë, *A Game of Thrones* të George R. R. Martin) - si dhe mijëra tituj për të vegjlit, të ndarë në grupmosha specifike.

Megjithëkëtë, nëse shpeshherë për një lexues shifrat janë bezdisëse, titujt, autorët dhe prurjet e reja me siguri që jo, andaj le të flasim kësaj.

Lexues besnikë dhe të rinj e kujtojnë më së miri se libraria ADRION ka pasur, që prej krijimit të saj, një sektor të veçantë kushtuar librit në gjuhë të huaj, i pasuruar, shtuar dhe përmirësuar me kohën për të ndjekur hapin e titujve më të fundit të hedhur në treg nga gjigantët e botimeve në Britaninë e Madhe, Amerikë dhe Kanada. Teksa prurjet e reja nuk mungojnë në letërsinë artistike (*fiction*), numri i veprave joletërsi (*non-fiction*) ka ardhur në rritje në lloje e nënloje, ku vërehen botime gjithnjë e më të hollësishme dhe të orientuara për stilin e jetesës, mirëqenien, zhvillimin personal, kujdesin ndaj vetes dhe banesave, financave, përmirësimin e aftësive komunikuese dhe rritjen e rendimentit në punë, me qëllim parësor uljen e ngarkesës dhe të stresit. Ritmi i vullshëm që i kemi diktuar vetes sidomos në dekadën e fundit ka sjellë si nevojë zbulimin e antidotit qetësues, që një prej intelektualëve më të rëndësishëm të kohës sonë e ka përmbledhur deri më sot në dy tituj: *12 Rules For Life* dhe *Beyond Order*. Nga ana tjetër, britaniku Simon Sinek na orienton fare mirë në fushë të lidhshme dhe të sipërmarrjes me pothuajse një duzinë titujsh, kësaj parapëlqej që mendimin e tij ta lexoj në origjinalin anglisht tek *Infinite Game*, *Start With Why*, *Leaders Eat Least* etj.

Unë lexoj anglisht, sepse vetëm kështu mund të kem në duar romanin më të fundit të nobelistit Ishiguro, *Klara and the Sun*, dhe përmbledhjen e shkëlqyer me tetë tregime të Haruki Murakamit, *First Person Singular*. Përkthimi i butë nga Ann Goldstein i *The Lying Life of Adults*, vepër e një prej autoreve më të mira bashkëkohore italiane (Elena Ferrante), rrëfimi prekës i Hanya Yanagiharas tek *A Little Life* dhe mbi pesëmbëdhjetë romanet e çekut Milan Kundera, Salman Rushdies dhe filozofit dhe estetit e kritikut të madh Michel Foucault, që marrin hapësirën e merituar në librari, vetëm sa forcojnë tezën e të lexuarit në gjuhë të huaj. Pavarësisht nga botimet dhe titujt debutues, në librarinë kult të Tiranës një stendë e tërë i është dhënë bujarisht, me të drejtë, thuajse 20 titujve të shkrimtarit më të madh postmodern Murakami. Ka lexues që me Haruki Murakamin janë takuar fillimisht me *Norwegian Wood*, gjithsesi maratonën e leximit e vijnë me kolanën e pa-fundme të romancierit japonez. (Maratona këtu nuk është aspak metaforë, por pasion i madh i tij, prandaj është e udhës të rekomandohet që *What I Talk About When I Talk About Running* të lexohet doemos!)

Gjithnjë e më tepër të rinj, falë mjeteve të komunikimit masiv, përditësohen me botimet e reja në kategorinë *young adult*. Me sa duket, zhanret fantashkencë dhe fantazi "e pastër" tingëllojnë më mirë origjinal dhe, sikurse ndodh në librat e kërkuar nga ata vetë, botimi i shpejtë në harkun e më pak se një viti e zhbën përmasën e kohës dhe ua zvogëlon pritjen.

Unë lexoj anglisht për të pasur mundësinë e komunikimit sa më pranë me mendësi vetjake; këtu u referohemi letërkëmbimeve, rrethit aspak të vogël të biografive, autobiografive dhe të memuarëve (kuptohet se mes tri të fundit ka dallime në nuanca sa i takon këndshkrimin dhe reflektimit mbi ngjarje e njerëz).

Vëllimi i parë i kujtimeve me titull *A Promised Land*, i ish-presidentit amerikan Barack Obama, është shembulli më i shkëlqyer i rrëfimit të ngjarjeve personale, ditëve dhe momenteve që shënuan fatin e një kombi dhe krejt politikën ndërkombëtare.

Lexoj anglisht, sepse kënaqësia estetike për të përzgjedhur mes vëllimit me kopertinë të butë dhe atij me kopertinë të fortë, si alternativë ngazëllyese që vetëm një libërdashës i thekur e kupton, duket haptas. Nëse funksioni parak i letërsisë është kënaqësia gjatë leximit - a së paku dëshira më e thellë e çdo shkrimtari, që dërgon në shtyp një pjesë nga vetja në formën e romanit, poezisë dhe kushedi se ç'trajte të ndërmjetme - aspekti pamor, pra shijimi i një kopertine delikate, që mirëqëndron në raft, s'ka si të anashkalohet.

Duket qartë se për të rriturit si mundësitë, ashtu edhe arsytet për të lexuar në *lingua franca* janë të mjafta, por pyetja shtrohet: përse lexojnë anglisht edhe të vegjlit? Pashmangshmërisht, përgjigjja lidhet me të dhënat shifrore përmenduar në krye të shkrimin: botime të bukura, të llojllojshme dhe leximi në një gjuhë që u mundëson të bëhen lexues model.

Po ti, përse lexon anglisht?

GÜNTER GRASS

BOSH DHE VETËM

Përktheu Fatmir Alimani

CREDO

Dhoma ime është erëqetë,
e përshpirtshme, një cigare,
kaq mistike, saqë askush s'guxon
të ngrejë qeranë
ose të pyes për gruan time.
Dje kur miza vdiq,
unë kuptova pa kalendar,
tetorin, një mësues vallëzimi që përkulet,
ai don të më shesë mua tablo të vogla, të ndaluara.
Për vizitë unë pres para derës.
Posta ngjitet te xhami,
jashtë, shiu lexon bashkë me mua.
Brenda, dhoma ime është erëqetë,
asnjë grindje mbi tapet,
puthje të përpura nga orët,
kurrë s'pengohemi, që të godasim gjurin,
sepse gjithçka jepet,
e përshpirtshme, një cigare,
vertikalisht beson ajo,
vertikalisht merimanga, një balancë,
e ndjek pas çdo thellësi të madhe.
Ne nuk do të dështojmë kurrë.

USHQIMI I PROFETËVE

Kur karkalecat e pushtuan qytetin tonë,
s'erdhi më qumësht në shtëpi, gazeta u asfiksua,
madje u hap burgu, profetët i lanë të lirë.
Kështu përshkuan rrugët 3800 profetë.
Të padënuar, duhej të flisnin, të ushqeheshin bollshëm,
me çdo shtresë kërcyese bojë hiri, që ne torturë e
q u a n i m.

Kush kishte pritur diçka tjetër. –

Shpejt erdhi përsëri qumështi tek ne, gazeta mori frymë
thellë,
profetët mbushën burgun.

PAGJUMËSI

Unë numëroja armiqtë e mi
dhe fjeta mbi numrat.
Kur u zgjova,
unë numërova miqtë e mi,
ndërmjet tyre të vdekurit,
që numëroheshin dopio.



DASHURI NË GUSHT

Nëse ne në bashkveprim
ndërmjet dhe nën merimangat
shumëgjymtyrëshe, shkojmë në rretën
e bërë në shtëpi,
për të na kapur ty dhe mua,
sepse ne jemi
njëri
për tjetrin
pre

NORMANDI

Bunkerët në bregdet
s'mund ta heqin dot betonin e tyre.
Nganjëherë vjen një gjeneral gjysmë i vdekur,
dhe përkëdhel frëngjitë.
Ose në to banojnë turistët
për pesë minuta torturuese. –
Erë. Rërë. Letër dhe urinë:
Gjithmonë është invazion.

QARK I SHKURTËR

Në çdo dhomë, edhe në kuzhinë, unë ndizja dritat.
Fqinjët thoshin: Një shtëpi festive.
Por unë isha krejtësisht vetëm me ndriçimin tim,
gjersa ra era e siguresave të djegura.

NARZISS

Për ku do ta prini qenushin,
për ta shëtitur
edhe pa rrip?

Ai gërvisht te porta,
urinon mbi parket,
gjersa e shoh ç'po bën.

Unë jam i bukur.
Kështu thotë qeni im, që është gjithnjë besnik.
Budallenj jemi ne të dy – por të pavdekshëm.

DUEL ME HUTËN

Jo, hutë, jo.
Mishi im është i pastër.
Më beso, unë s'bie erë.

Jo, hutë, jo.
Si mund të jem unë i ushqyeshëm për ty,
mua më ka lindur një engjëll.


Jo, hutë, jo.
Lëre zorrën time dhe gurin në veshka,
përndryshe unë duhet të këndoj për ty.

Dhe unë këndova për një hutë,
gjersa ajo duhej të më pështynte mua.
Jo, hutë, jo.

Dhe, kush don të më shfaros mua tani?

BOSH DHE VETËM

Pantallonat poshtë, duart si për lutje,
shikimi im është fokusuar në një drejtim:
pllaka e tretë nga sipër, e gjashta djathtas.
Diarre.



Unë dëgjoj.
Dymijëepesëqind vjet histori,
dije të hershme dhe mendimet e fundit
lëpjinë njëri-tjetrit, ngrihen lart.

Është infektimi i zakonshëm.
Vera e kuqe e nxit këtë gjë
ose grindja te shkallët me Ilsebill.
Ankth, sepse koha-ora mendoj unë-
ka një bark kronik.

Çfarë përlyejnë: problemet e mëngjesit.
Asnjëri s'dëshiron që jashtëqitja të bëhet kompakte,
dhe gjithashtu dashuria bie në pafundësi.

Kaq shumë boshnajë
është tashmë një kënaqësi: vetëm në WC
me prapicën time
Zoti Shteti Shoqëria Familja Partia...
Jashtë. Gjithçka jashtë.
Era që bie jam unë.
Tani mund të qajmë.

O NJERI!

Edhe vetë muti yt
bie kryeneç,
bie erë egocentrik
dhe s'ka asnjë krahasim.

PËR TY

Këpucët e mia të zbrazëta
janë plot me plane udhëtimi,
dhe dinë rrugë të tërthorta,
që të gjitha të çojnë tek ti.

NË VEZË

Ne jetojmë në vezë.
Në anën e brendshme të lëvozhgës,
ne kemi gërvishtur vizatime të pacipa
dhe emrat e armiqve tanë.
Ne do të kllaçitemi.

Kush do të na kllaçitë ne,
do të kllaçitë edhe lapsin tonë.
Një ditë do të dalim nga veza.
dhe ne do të bëjmë menjëherë
një portret të kllaçitjes.

Ne pranojmë, që të kllaçitemi.
Ne përfytyrojmë një shpeshë shpirtmirë
dhe shkruajmë hartime
mbi ngjyrën dhe racën
e pulës, që na kllaçit ne.

Kur do të dalim ne nga veza?
Profetët tanë në vezë
grinden për pagesën mesatare
mbi kohën e kllaçitjes.
Ata pranojnë një ditë X.
Nga mërzia dhe nevoja e vërtetë
ne kemi shpikur inkubatorin.
Ne kujdesemi shumë për brezin tonë të ri në vezë.
Me kënaqësi secilit që vigjëlon mbi ne,
i rekomandojmë patentën tonë.

Por ne kemi një çati mbi kokë.
Zogj pule matufë,
embrione me njohuri për gjuhën
flasin gjithë ditën
dhe diskutojnë akoma për ëndrrat e tyre.

Dhe nëse ne nuk do të kllaçitemi?
Dhe nëse kjo lëvozhgë s'do të ketë një vrimë?
Nëse horizonti ynë është vetëm horizonti
i shkarravitjeve tona, dhe kështu do të mbetet?
Ne shpresojmë, që ne do të kllaçitemi.

Nëse ne do të flasim vetëm për kllaçitjen,
mbetet të frikësohemi, që dikushi,
jashtë lëvozhgës sonë, ndien uri,
dhe na hedh ne në tigan, dhe na krip. -
Çfarë të bëjmë ne pastaj, o ju, vëllezër në vezë?

INKURAJIM PËR ANËN

Mos ki frikë
për sa kohë do të bjerë shi,
askush nuk do të vër re,
që kukullat e tua qajnë.

Mos u frikëso ti.
Unë e kam vënë revolverin nën tutelë.
Të gjithë plumbat na përkasin ne,
ne mundemi ta mbushim orën me to.

Mos ki ankth.
Unë do t'i kap zhurmat,
do t'i mbyll në kuti të vogla,
dhe do t'i çoj te posta.

Mos ki frikë.
Emrat tanë unë i kam maskuar.
Askush nuk duhet të dijë si quhemi,
nëse ne na thërrasin.

GOETHE

Ose një paralajmërim për Teatrin Kombëtar
në Mannheim.

Unë u frikësohem njerëzve,
që bien erë duhani anglez me llullë
Fjalët e tyre sinjalizuese nuk kafshojnë,
por do të transmetohen
nëse unë tashmë fle.

Sa frkësohem unë,
nëse ata vijnë nga Frankfurti,
sjellin duhanin e tyre,
kundrojnë gruan time,
dhe flasin ëmbël për librat.

Frikë kam, ata që e pinë duhanin me llullë,
do të më pyesin mua,
çfarë tha Goethe dhe ku,
si kështu, çfarë mendonte ai,
kur thoshte që donte të kuptohej sot dhe në të ardhmen.

Por unë, nëse humbas frikën time,
nëse unë librin tim të madh,
që numëron nëntëqind faqe,
dhe përshkruan zjarrin më të madh,
para llullave të tyre, do ta hap me furi?

Frikë, fillon libri im,
kur njëfarë zotëri Goethe,
me qëllim dhe fitil,
Teatrin e Weimar-it,
e la në flakë. -

tashmë si Neroni, edhe Shekspiri,
zjarrvënës ishin dhe poetë.

RRUAZA GJAKU

Por lakuriq
dhe e pranishme, vetëm në proporcione,
ti më bën të vuaj akoma.
Dhe unë përpiqem të zhvendos gjurin tënd.
Kryqi yt i zbrazët më lë mua të mendueshëm.
Unë nuk e di përse ti je kaq e shëmtuar,
përse syri im nuk mund të rrëshqasë nga ti,
në gjelbërim ose përgjatë lumit,
që është i tëri prej natyre
dhe nuk ka asnjë klavikul.

Unë të dua,
për sa është e mundur.
Unë dua të mendoj një balet
për rruazat e tua të gjakut,
të bardha dhe të kuqe.
Dhe nëse pastaj bie perdja,
unë do të kërkoj pulsën tënd
dhe do të verifikoj,
nëse ia vleu vërtet shpenzimi i bërë.



Dante Alighieri (1265-1321)

AQ HIRPLOTE

Aq hirplote dhe e dliirë ngjan
Kur njerëzit përshëndet kjo vasha ime
Sa fjala n'buzë i ngrin gjindjes anembanë
Dhe sytë s'guxojnë të hedhin vështrime.

Ajo po shkon me lavdërim rrethuar
Dhe thjeshtësia e vesh me tis të ndritur
Dhe të ngjan se nga qielli ajo ka zbritur
Ashtu porsi një qenie e mrekulluar.

Është aq e këndshme kur nis e sodit
Sa zemra të gufon nga një ëmbëlsi
Që kurrë s'e kupton kush s'e ndjen vetë.

Dhe duket se nga buza e saj po zbrat
Një frymë e ëmbël plot dashuri e dritë
Që seç i thotë zemrës: "Psherëti".

Përktheu: Klara Kodra



DJALI I PRAPË

Ivan Ivaniç Llapkini, një djalosh me pamje të lezetshme, dhe Ana Semionova Zamblickaja, një vajzë e re hundëcipe, zbritën tatëpjetë një bregu të pjerrët dhe u ulën në një stol. Stoli ishte mu buzë lumit, mes degësh të dendura shelgjesh të reja. Çfarë vendi i mrekullueshëm! Ulesh aty dhe bota nuk të sheh - vetëm peshqit dhe merimangat që kalojnë vringthi mbi ujë. Të rinjtë kishin me vete kallama, rrjeta, kuti me krimba e gjithfarë takëmsh peshkimi. Sapo u ulën nisën të peshkojnë.

— Gëzohem që më së fundi jemi vetëm, — filloi të flasë Llapkini duke vështruar rreth e rrotull. — Unë duhet tu them shumë gjëra Ana Semionova.... Aq shumë.... Kur ju pashë për herë të parë... Ah, peshku po kafshon grepin tuaj.... Atëherë e kuptova përse jetoj në këtë botë, kuptova ku është idhulli im të cilit duhet t'i kushtoja jetë time të ndershme e punëtore.... O, ky që po kafshon duhet të jetë i madh... Kur ju pashë ndjeva dashurinë e parë, ju dashurova tërë pasion! Prisni mos e tërhiqni... le ta kafshojë më mirë... Më thoni, e dashura ime, ju përbetohem, a mund të shpresoj — jo që edhe ju, jo! — këtë nuk e meritoj, as që mund ta mendoj këtë, — a mund të shpresoj që.... Tërhiqeni!

Ana Semionova ngriti lart dorën me kallamin, e tërhoqi dhe klithi. Në ajër shkëlqente një peshk ngjyrë argjendi në të gjelbër.

— O zot, sharmak! Obobo, Shpejt! Iku!

Sharmaku e vulli grepin, kërcëu nëpër bar drejt mjedisit të vet natyror dhe pëlltuq në ujë.

Duke ndjekur peshkun, Llapkini në vend të tij, disi padashur kapi dorën e Ana Semionovës dhe po padashur e ngjeshi te buzët e tij.... Ajo u zbraps, por tashmë ishte vonë: buzët padashur u bashkuan në puthje. Kjo doli si papritur. Pas puthjes së parë vijoi një tjetër, pastaj përbetime, zotime... Minuta të lumtura! Mirëpo, në jetën e kësaj bote nuk ka asgjë absolutisht të lumtur. Lumturia zakonisht bart helmin brenda vetes, ose helmohet nga diçka së jashtmi. Kështu ndodhi edhe këtë herë. Kur dy të rinjtë po putheshin, papritmas u dëgjua një e qeshur. Ata panë nga lumi dhe shtangën: në ujë deri në brez qëndronte një djalë i zhveshur. Ky qe Kolja, një gjimnazist, vëllai i Ana Semionovës. Po rrinte në ujë duke vështruar dy të rinjtë dhe qeshte tinëzisht.

— Aha-ha.... po putheni - ë? —tha. — Epo fare mirë! Unë do t'i them mamasë.

— Shpresoj se ju si njeri i ndershëm.... — mermëriti Llapkini, duke u skuqur. —Të përgjosh është poshtërsi, kurse të kallëzosh është e ulët, maskarallëk..... Ma ha mendja, se ju si njeri i ndershëm dhe fisnik.....

— Më jepni një rubël dhe nuk do tregoj! — tha njeriu fisnik. — Përndryshe do tregoj.

Llapkini nxori nga xhepi një rubël dhe ia dha Koljas. Ky e shtrëngoi rublën në grushtin e qullur, fërshël-leu dhe iku me not. Ndërsa dy të rinjtë nuk u puthën më.

Ditën tjetër Llapkini i solli Koljas nga qyteti bojëra dhe një top, kurse motra i dhuroi atij gjithë kutitë e saj të hapjeve. Më pas, u desh t'i dhuronin edhe kopsa mëngësh këmishësh me turicë qenushësh. Sigurisht që djalit të prapë të gjitha këto i pëlqenin shumë, dhe që të përfitonte edhe më shumë filloi t'i ndiqte nga pas. Ku shkonte Llapkini me Ana Semionovën, aty edhe ai. Nuk i linte asnjë minutë vetëm.

— I poshtri! — shqiptonte mes dhëmbësh Llapkini. — Kaq i vogël, po sa maskara i madh! Kushedi çdo të bëhet kur të rritet.

Tërë qershorin Kolja s'i la të jetonin qetësisht të dashuruarit e gjorë. I kërcënonte se do t'i kallëzonte,

i përgjonte dhe kërkonte dhurata; dhe s'ngopej asnjëherë, sa që më në fund filloi të kërkonte orë xhepi. Ç'ti bënin? U detyruan t'i premtinin edhe orën.

— Një herë për drekë kur po shërbenin vafël, Kolja papritmas u shkreh së qeshuri, shkeli njërin sy dhe e pyeti Llapkinin:

— A ta them? Hë?

Llapkini u skuq nga frika dhe në vend të vafllit kafshoi pecetën. Ana Semionova kërcëu përpjetë nga tryeza dhe ia dha vrapit për në dhomën tjetër.

Dhe ja në çfarë gjendjeje ishin dy të rinjtë deri në fund të gushtit, pikërisht deri atë ditë kur më së fundmi Llapkini i bëri propozimin Ana Semionovës. Oh ç'ditë e lumtur që ishte! Pasi foli me prindërit e nuses dhe mori pëlqimin e tyre, Llapkini pikë së pari doli me vrap në oborr dhe nisi të kërktojë Koljan. Kur e gjeti, sa nuk u ngashërye nga kënaqësia dhe e zuri djalin e prapë për veshi. Erdhi me vrap Ana Semionova, që po ashtu kërkonte Koljan, dhe e zuri nga veshi tjetër. Veç t'i shihje se çfarë ngazëllimi shprehej në fytyrat e të dashuruarve kur Kolja qante dhe u lutej:

— Të dashur, të shtrenjtët e mi, pëllumbtha, nuk bëj më! Oh, oh, më falni!

Dhe më pas, që të dy ishin të ndërgjegjshëm se gjatë gjithë kohës që qenë të dashuruar, kurrë nuk kishin provuar të atillë lumturi, të atillë ngazëllim mallëngjyes, si në ato minuta kur shkulnin nga veshi djalin e prapë.

1883

*I përktheu nga origjinali
Dhimitër Haxhimihali*

A.P. ÇEHOV DY TËRËGIME



LIBRI I ANKESAVE SAVE

Ky libër gjendet në një zyrë të vogël të bërë posaçërisht për të në stacionin hekurudhor. Çelësi i zyrës "ruhet te xhandari i stacionit", po në të vërtetë nuk nevojitet kurrfarë çelësi se zyra është gjithnjë e hapur. Shfletoni librin dhe lexoni:

"Zotëri i hirësishëm! Prova e penës!?"

Nën të është vizatuar një surrat hundëgjatë me brirë. Poshtë surratit është shkruar:

"Unë portret e ti tabló, ti hajvan, por unë jó. Unë - jam turiri yt".

"Kur po udhëtoja për te ky stacion dhe po vështroja natyrën nga dritarja, era më mori kapelën. I. Jar-morkin".

"Kush e ka shkruar s'e dí, unë budallai duke lexuar rri".

"La kujtimin e tij kryetari i byrosë së ankesave Koll-ovrojevi".

"I paraqes kryesisë ankesën time ndaj Konduktorit Kuçkin, për vrazhdësinë e tij kundrejt gruas sime. Ime shoqe nuk po bënte aspak zhurmë, përkundrazi po përpiquej që gjithçka të ishte e qetë. Po ashtu edhe për xhandarin Kljatvin i cili më zuri ligisht nga supi. Banimin e kam në pronën e Andrej Ivanoviç Ishçevit i cili e nje shjelljen time. Nëpunësi Samolluçshev".²

"Nikandrovi është socialist!".

"Kur ende ndodhesha nën përshtypjen e freskët të veprimt tronditës..... (shkarravitur). Kur po udhëtoja nëpër këtë stacioni, unë u trondita gjer në thellësi të shpirtit nga kjo... (shkarravitur). Para syve të mi ndodhi kjo ngjarje revoltuese që vizaton me ngjyra të gjalla rregullat tona hekurudhore.... (në vijim është shkarravitur gjithçka, përveç nënshkrimit). Nxënësi i klasës së 7-të të Gjimnazit të Kurskut Aleksej Zudjev".

"Duke pritur që të nisej treni, unë po vëzhgoja fizionominë e përgjegjësit të stacionit dhe mbeta krejtësisht i pakënaqur prej saj. Për këtë po njoftoj sipas linjës. Një pushues i gëzuar daçe."

"Unë e di kush e ka shkruar këtë. Këtë e ka shkruar M. D."

"Zotërinj! Telcovski është hileqar!"

"Xhandaresha dhe bufetieri Kostia mbrëmë udhëtuan matanë lumit. I urojmë gjithë të mirat. Mos u dëshpëro xhandar!"

"Duke udhëtuar nëpër këtë stacion dhe pasi kisha uri, në arsyetimin se ç'të ha, unë nuk munda të gjej ushqim kreshmor. Dhjaku Duhov".³

"Llup ç'të japin"....

"Kush gjen një mbajtëse lëkure për cigare le t'ia dorëzojë në kasë Andrej Jegoriç-it".

"Meqenëse mua po më heqin nga puna gjoja si pijanec, atëherë unë deklaroj se ju që të gjithë jeni batakçinj dhe hajdutë. Telegrafisti Kozmodemjanskij".

"Hijeshoni veten me virtut".

"Katinka, ju dashuroj si i marrë!"

"Lutem mos shkruani në librin e ankesave gjëra pa lidhje. Për shefin e stacionit Ivanovi i 7-të".

"Edhe pse i 7-ti, gjéne budallá".

1884

² Lojë fjalësh: i vetëshpallur më i miri.

³ Lojë fjalësh: shpirtëror.

Botim i ri nga Shtëpia Botuese Dituria

"ANKTHI I PORTIERIT PËRA PENALLTISË", PETER HANDKE

Nga Petrit Ymeri

"Papritur gjithçka përreth tij ishte e padurueshme. Pyeti veten nëse qe zgjuar pikërisht ngaqë në një moment të caktuar, pak para agimit, gjithçka bëhej papritur e padurueshme. Dysheku, mbi të cilin qe shtrirë, ishte fundosur, dollapët dhe komodinat qëndronin në distancë të madhe ndaj mureve, tavani sipër tij qe padurueshmërisht i lartë. Ishte aq qetësi në dhomën e zhytur në gjysmëterr, jashtë në korridor, dhe sidomos jashtë, në rrugë, sa që Blohu nuk duroi dot më. Një ndjenjë e fortë neverie e pushtoi".

Ankthi i portierit, frika e tij para goditjes së penalltisë, për atë aludohet në titullin e romanit, me të cilin Handke interpreton, sipas mënyrës së vet krejtësisht origjinale, një histori që në vështrim të parë mund të ngjajë edhe si letërsi policeske, madje, më saktë një thriller. Është çështje këndvështrimi, dhe këndvështrimi i shkrimtarit austriak është gjithmonë tejet i hapur ndaj realitetit, me një vizion aq të qartë sa e bën atë të largët, por edhe tejet të vëmendshëm për të kapur gjurmët e atij terri të brendshëm, që e bën të jetuarit enigmatik dhe të trazuar. "Ata sy prej poeti, prej mistiku, prej fantazme, prej engjëlli mbi spektaklin kalimtar dhe të përjetshëm të botës", për të përdorur disa nga fjalët që Chiusano i kushton Handkes në "Literatur".

Një histori thriller, sepse romani zë fill nga një krim i urryer, por që autori e nxjerr nga skemat tradicionale të zhanrit, sepse krimi këtu shfaqet krejtësisht pa motiv, aq i beftë dhe i paparashikueshëm sa e habit lexuesin - "Papritmas, ai i vuri thonjtë në fyt...", siç nuk ka asnjë gjurmë hetimi, kërkimi të dhënash, provash dhe madje as të zgjidhjes së çështjes dhe arrestimit të fajtorit. Handke ka në duar një enë bosh, krejtësisht të hapur, për ta mbushur me çdo mundësi të mëtejshme zhvillimi. Dhe ai zgjedh mundësinë më tërheqëse, por në të njëjtën kohë më tjetërsuese, ashtu si çdo metaforë: duke e vënë protagonistin e tij vrasës, montatorin Jozef Bloh, dikur "portier futbollit me emër" në pozicionin e portierit që pret goditjen, pa mundur të gjejë dot se nga cila anë do të vijë, ndërsa sytë e të gjithëve janë drejtuar tek topi, kurse ai është vetëm në pritje të penalltisë.

Vetmia, pasiguria, izolimi, ngrirja e kohës, ndjesia e të qenit jashtë jetës së përbashkët, duke jetuar një kohë të deformuar, në një hapësirë papritmas plot aludime dhe deja vu, në pritjen e pasigurt të një zgjidhjeje të vështirë, si në një univers paralel, i zhytur ndërkaq në jetën më normale të përditshme: pra, në këtë dimension të tjetërsuar zhvillohen ngjarjet, ku Jozef Blohu është protagonist i zymtë, i paqëndrueshëm dhe i trazuar. Pikërisht në këtë dimension të tjetërsuar e fut Handke që në faqet e para të romanit lexuesin e vet. Sepse sytë e vrasësit të tij janë si një aparat fotografik i pajisur me një lente shtrembëruese dhe përmes saj lexuesit-spektatorë e shohin teatrin e kësaj ngjarjeje dhe "aktorët", aktorë që hyjnë e dalin pa formë dhe që marrin peshë krejt tjetër në momentin kur inkuadrohen nga shumë afër, çka u jep thellësi dhe sidomos një lloj force magjike në dinamikën e tregimit, sepse mishërojnë acarimin, neverinë, përzierjen e gjithçkaje që përshkon mendjet e atyre që i vëzhgojnë dhe kanë të bëjnë me ta.

Së njëjtës procedurë i nënshtrohen edhe objektet, çdo detaj, sado i vogël, gjithçka që sytë e Blohut hasin, gjithçka është e nevojshme për të sendërtuar atë që shërben për të përkthyer në imazhe të pangatërrueshme bezdinë ekzistenciale, viktimë e të cilës është vrasësi, ose më saktë ajo që e mbush përbrenda dhe madje duket se i jep atij qëndrueshmëri: "Gjithçka që shihet, e bezdiste; u përpoq të përkapte sa më pak të ishte e mundur." Nuk ka më gjurmë të natyrshmërisë në veprime, madje edhe ato më të zakonshmet mund të çojnë në një acarim që stili i Handkes i përkthen përmes sekuencave të përsëritura qëllimisht. Në shpalljen e tyre disi hipnotike, në vetë formën e tyre, në transkriptimin e irrituar të të dhënave thjesht të ndjeshme, qëndron dhe duhet kërkuar ajo që autori nënkupton, që fsheh, duke ia lënë lexuesit detyrën e interpretimit, ose thjesht dëgjimit, siç do të bënte përpara një sekuence kinematografike: "Kamerierja shkoi pas banakut. Blohu vuri duart mbi tryezë. Kamerierja u përkul dhe hapi shishen e birrës. Blohu shtyu tutje tavllën. Kamerierja, në ecje e sipër, mori një nëngotëse nga një tavolinë tjetër. Blohu zhvendosi karrigen prapa. Kamerierja mori gotën që e kishte vendosur përmbys mbi qafën e shishes, vuri nëngotësen mbi tryezë, sipër saj gotën, derdhi birrën në gotë, la shishen mbi tryezë dhe u largua prej aty. Po fillonte prapë nga e para! Blohu nuk dinte më çfarë të bënte."

Po ta shohësh mirë, ka diçka në këtë roman që e fut atë te thrilleri: një lloj tensioni i përhershëm që rreh aty, i prekshëm dhe aludues, një pritje drithëruese që megjithatë nuk duket të jetë e lidhur me zhvillimin e ngjarjeve edhe aq më pak me përfundimin e hetimit policor, për të cilin praktikisht nuk thuhet gjë, sesa me rënien dhe zhvillimin progresiv, që është një degradim

i ngadaltë, i perceptimeve gjithnjë e më të marra dhe të tjetërsuara të protagonistit, i fiksuar po, por sigurisht jo nga ndjenja e fajit për vrasjen që kreu, por përkundrazi nga interpretimi i tij i realitetit, gjithmonë dhe në çdo rast në dëm të vetes: "Me plot kuptimin e fjalës, gjithçka që shikonte ishte e dyshimtë. Imazhet nuk ngjanin natyrale, por si të qenë përgatitur për një rast të posaçëm. I shërbenin një qëllimi. Kur i shikoje, të hidheshin me plot kuptimin e fjalës, në sy". Siklet, hutim, befasi, tërbim, paaftësi për të duruar sulmin e fjalëve dhe gjërave, nervozizëm, neveri, ndjenjë e të qenit viktimë e keqkuptimeve, shqetësim, iluzione të çuditshme, panatyrshmëri në gjeeste dhe në të folur, neveri ndaj vetes "Nga mënyra si rrinte shtrirë aty, ai ishte diçka eksituese, vulgare, e papërshtatme, diçka krejtësisht skandaloze; "Varrose!" mendoi Blohu, "ndaloje, hiqe prej aty!" Është zhvillimi me ritme të shpejta i perceptimeve të tilla, të konkretizuara në imazhe që në të vërtetë janë zbulime, që krijon dramën agresive të një romani i cili në thelbin dhe në mënyrën e tij, imponuese dhe me pasoja, zbulon përkatësinë në zhanrin e letërsisë policore.

Një vlerë e ngjashme, që ndikon në atmosferën e rëndë të romanit, qëndron në marginalitetin që ndihet nga fillimi në fund, në çdo kthesë sado të vogël të ngjarjeve ose në çdo ndryshim të padukshëm të perceptimit të trazuar të protagonistit. Margjinalitet, i cili u rezervohet para së gjithash vendeve. Vjena, për krimin që ndodh, por një Vjenë periferike dhe disi e shurdhër, e përvijuar nëpër vende anonime, të banuara nga aventurierë, mes të cilëve protagonistin endet duke e prekur, duke e vëzhguar por duke mbetur prapëseprapë në periferi: vende të grumbullimit të rastësishëm: bar, stadium, treg, stacion, kinema, kafene, një dhomë hoteli - dhe vende jugore kufitare, destinacion i udhëtimit, arratisjes ose maskimit, jo fort të përcaktuara, por me gjasë në Kärnten, në vendet e origjinës së autorit. Në skaj, në kufi, në provincën më të largët dhe të errët, Blohu endet mes fshatrave dhe bujtinave të vendit, në një mjedis rural që mund të dukej i parrezikshëm, madje edhe bukolik, nëse nuk do të deformohej nga vështrimi i turbullt i Blohut, që lexon dhe interpreton gjithçka duke u nisur nga deliri i tij.

Dhe kështu rrëfimi mbushet me histori të zymta, personazhe shqetësuese, fakte të trishta, legjenda të dëshpëruara dhe atmosfera bëhet groteske dhe e padurueshme dhe madje, herë-herë, duket sikur zëra pothuajse nga nëntoka katapultohen në qendër të një rrëfimi bernardian: "Errësira nëpër bredhishta", citoi portieri përmendësh, "e kishte bërë të luante mendsh".



Robert Pinski

MITET E STUDIOS

Përktheu nga anglishtja Flurans Ilia

Ebrendashkruara qetësi e ndërprerë nga thirrjet e zogjve, ose zhurma e qenit që hidhet nga qilimi në qilim, kryq e tërthor dyshemesë së drunjtë ngjyrë të pjekur. Kabinë malore apo barakë kodrinore, ndoshta edhe lëçitje e thellë në librari, frëngji qele për soditjen e turmës së njerëzve të bërë mullar. Privatësi, qetësi, e lartësuar meshë e zgjatuar e mëngjesit të hapur tej e tej për punë, pa telefon, radio apo televizor. Imagjinata e çlirët nga devijimi: Çerdhja e Shkrimtarëve.

Për mua, një Ferr i mprehtë. Në këtë podium pritjeje, mundet të çmendem nga përgjërimi i ziles telefonike, nga kërkesat e fëmijëve, nga çdo qoshk shmangie i ardhur të më çlirojë nga vuajtjet paditëse të kohës së lirë.

- Kur shkruani?

- Kurdoherë që është e papërshtatshme.

Vetmia më e mirë realizohet: nuk pajiset nga mitet e ngucura të barakës në pyll, por kapet me forcë vetë-dëshironjëse në fushën e nderit, në aeroport në sallën e hallavitjes, ose në të qenin vetëm për vetëm në makinë, në vetminë e ngrirë të një klase të mërzitshme, apo në arratinë e leximit me zhdërvjelltësi, përmes provokimit të brendshëm të ëndërrimit.

Më mirë përmes pemëve (ose në rrugë) se sa në kabinë, sepse e ecura mund të gjallërojë trupin dhe arsyet, në një rrugë që të drejton drejt endjeve alarmuese të poezisë, duke lëvizur drejt gjërave, duke parë për rreth – sistemin pa qëllim.

Wallace Stevens dhe William Wordsworth kanë kompozuar ndërsa ecnin. Kam dëgjuar se rrugica e Parkut Hartford ku Stivensi kalonte për të shkuar në kompaninë e tij të sigurimeve, përmban pjesën më natyrale të imazheve të punës së tij, përfshi guguftutë dhe pallonjtë. Emily Dickinson qëndronte në shtëpi, por Elizabeth Bishop e ndërtonte “*Drerin brilopatë*” në një autobus urban, edhe poemat e William Carlos Williams si për shembull “*Në rrugën për tek spitali infektues*” zbulon nëpërmjet poezisë kopshtin e soditur nga një automobil në lëvizje.

Ndoshta një makinë apo një aeroport, një rrugë ose një vagon, mund të sjellë fotografinë e vërtetë të vendit tim të punës në raport me aktualitetin tim të tanishëm, të kësaj dhome në një shtëpi të stilit të vjetër: kthina që dashuroj, e veshur me fotografitë e mia dhe objektet tabu, dhuratat. Dhe këto qindra libra, një minoritet të vogël prej të cilave e dua me të vërtetë. Veçanërisht nuk jam i rregullt; mesatarisht, çrregullime zhuli të pashquar mbulojnë sipërfaqen e këtij vendi që përngjan me dhomat që kam parë në dhjetëra shtëpi të tjera shkrimtarësh.

Rrëmuja ndihmon për ta mbajtur vendin nga degjenerimi i pastërtisë së bardhë, formë kjo nga e cila do të ndihesha komplet jashtë, një nënshkrim i nënkuptuar nga e urryera Ministri e Krijimit, nga Departamenti i Poezisë Lirike – një agjensi që kam nevojë ta imagjinoj për ta kundërshtuar. Poezia, të gjitha veprat serioze, vringëlljnë për mua në kohën e vjedhur, iluzioni i “të luajturit hookey mbi akull”: një arsye për shkeljen e detyrës që ishte pak e vjetruar edhe përgjatë djalërisë time. Frazat e vjetra kanë disa gojëzime magjike: lehtësia e “të luajturit” ndjek dhëmbëzën e përkuljes nën “gr-

remç”, pseudonimi i “hokejit” ndoshta me një pasqyrim të njeriut-bishtnues krenar në lojën mbi akull.

Këtu në dhomën time të lezetshme, kam krijuar rezervat e pjesës më kryesore të shkrimeve, kam trashëguar nga rinia e hershme, të keqen e paaftësisë studentore për të kryer çfarë është supozuar për t’u bërë. Në thellësinë e pas radhës, kodi ynë na dëfton: lëri të tjerët të mbartin çmimin e tyre skllavërues të vijës së drejtë, kurse braktisja e shkollimit tonë zinte vend ndër-sa kënaqeshim pa masë. Jo me të vërtetë ngaqë vërtet kënaqeshim, por ngaqë ishim të kënaqur që njihnim për fakt faktin që ndërmjet bashkëbisedimeve tona – kur ndodheshim mbi terrenin tonë, tjetërkund – ka qenë shumë më jetësore dhe krijuese se sa gjithçka tjetër që duhej dëgjuar në klasën e dhomëzave shkollore.

Begenisja e shtirur e Asistentit Kryesor: A keni një vend të qetë për të punuar? A keni një skrivani dhe llambë të mirë ndriçimi?


- Për drejt jo, jetojmë në frigorifer dhe lexojmë nën një llambë me vajguri.

Në fakt, miku i vjetër, shërbëtori im ndez zjarrin në dhomën e librave dhe i gatit llambat për lëçitje, çdo mbrëmje. Mjafton kjo që të ndihem si i palluar nga pas, e shihni edhe vetë.

Mundësia e ftesës të shkruaj për dhomën time, duke më kujtuar ato ditë të mërzitshme të shkollës së mesme, më ka lejuar singërisht të shqetësohem nëse poezia vjen së paku nga ndjenjat në harmoni me natyrën, Zotin, arkitekturën e hapësirës, apo me çdo ndjeshmëri të mbarëfatëzuar.

Poemat e mëdha i japin atmosferë festive shtëpive, “*Te Penshurst*”-at nga Ben Jonson dhe “*Mbi shtëpinë e Apleton*”-it nga Andrew Marvell, gjejmë në shtëpitë e të tjerëve, forca mikpritëse që janë bujare ndaj poetëve në shekullin e hierarkive. Huazimi, pajisja me rehati, në poezitë e Mervilit mbulohet me dhunë. Alexander Pope, që është quajtur si poeti i parë profesionist i gjuhës angleze, ndërmori disa mitizime prej Shpellës së Shkrimtarëve ku e shumë dashuruara “strofull e katakombeve”, e shtruar nga dyshemeja në tavan me copa pasqyrash, xhama me ngjyra, guacka, gjarpërinjuri, “kokrriza diamantesh”. Imazh që gjithashtu propozon sfidë: shformuesi i vogël poet mbrojtës fshikullon rrugën tonë të njerëzve të thjeshtë; Popi i fjetur në xixëllimin e vocërr të gjithësisë.

Këto cifla qelqi dhe guacka nën flakërimin e ndriçimit mund të shpërthejnë me emocione të vrullshme. Jo të baraspeshuara por energjikisht lëvizëse,



jo harmonishëm por kërcëllueshëm mashtruese. Duke shkruar këto fjalë ndërsa trupat amerikane janë ende në Irak, përshkoj dhomën time të punës të vëzhgoj për fjalën “luftë” në thesarin tim të Oxford English Dictionary, që më habit gjithmonë e më tepër me botimet e veta:

Format: uerre, werre, wyrre, weorre, worre, werre (werren), werr, guerre, gwerre, wer, were, vere, weer, veyr, veir, weire, weyr(e), weir, wair, wiar, weare, veare, ware, wear, waar, warr(e), war, wyrre, werre, guerre, guerra, gerra, werra, - çrregullim, mosmarrëveshje, grindje, shpënie në ngatërrim, ngasje në mospërputhje mendimesh, turbullim, shastisje, (të gjitha verbalisht të mbijetuara nga verworren).

Është kurioz fakti që asnjë komb gjermanik në kohën e historisë së hershme përgjatë përdorimit të përditshëm gjuhësor nuk e ka përdorur saktësisht në kuptimin më të drejt për drejtë fjalën “luftë”, qëllim i disa fjalëve që nënkuptojnë mbijetesën poetike, në fraza proverbiale, edhe në fjalë përbërjen e emrave të përvetshëm. Popujt e të folmes romanike, që ishin të detyruar të shmangnin nga latinishtja fjalën *bellum* në llogari të rastësisë formale me *bello* – i bukur, themeluan jo ekuivalent të përafërt në Teutonikisht nga *werra*. Në gjuhën Oekumenikale përkthimi i zakonshëm i *bellum* ishte *gëwin*, që do të thotë luftë, grindje. Gjuha Teutonike kontinentale më vonë zbuloi fjalë të veçanta për domethënien e fjalës “luftë”: gjermanikët *krig*, ndërsa suedezët dhe danezët thjesht *krig*, islandikët *ófriðr*, që do të thotë “pa-paqe”.

“Guerre” dhe “la guerra” tashmë janë të prejdardhura në mendjen time nga “awry” (“shtrembërim”): lopët e trembura të Françesko Gojas, pluskojnë me të vërtetë në një rënie të lirë, portretizime të shpërthimeve që shkaktojnë mosmarrëveshje, orendi dhe trupa njerëzore që fluturojnë të copëtuar veç e veç, gravitet që ngatërrohet në vetvete nëpër hapësirën e bërë *weird*, *worrying*, *wary*, *wrecked*, (çuditshëm, shqetësueshëm, syçelët, të mbytur). Dëshmia e Gojas është e para gjetie kaq e mprehtë e prodhimit shkatërrimtar të Evropës, dhe ka funksionuar si i pari përshkrim në fushën e artit përpara Luftërave Botërore. Gjëja më e keqe që mund të vijë në mendje.

Këto imazhe dhe ky përfundim më paralajmëron drejtimin që të paragjykoj dhe të ndruhem përpara se të guxoj njëfarësoj lehtësisht të shkruaj, gjë që më bën dyshues nëse shkrimi im vjen më pak ose më shumë prej paqes apo konfliktit. Në këtë mënyrë e shkëlqyera dhe e pabesa Botë fillon të hyjë në shpellën time: jo vetëm nëpërmjet gazetave e faqeve të internetit apo telefonit, por nëpërmjet gjuhës time dhe konspektit (përmbledhjes). Familja ime, qyteti im, vendi im, gjuha ime: këto ndijohen si forma të lëvizjes për mua, forma po aq të dhunshme. I dua njësoj sa edhe ua kam frikën: për lëvizjet që kryejnë, për nxënësinë që të jenë të ndryshme për së mbari po aq sa të njëlljoja sa herë që i shoh.

A nuk është hero i Artit kujdestari, aspak aristokracia i zymtë Akil, aq më pak i luajalisti i qëndrueshëm Beowulf, por Odiseja “i pambërrishmi aventurier” i Ualas Stivensit “i cili vjen gjithmonë kaq afër”: i etur dhe i shqetësuar aq sa tregtar? (Ose grabitës.) Oportunist i kopshtit të shtëpisë, përjetësisht emigrant ose imigrues. Dhe kur Odiseja mbërrin në shtëpi, konflikti është madhështor, fillon e bëhet i tmerrshëm. Udhërrëfyesja e tij Athinaja është luftëtare e mençur, e armatosur dhe e mbrojtur. Kundërshtari i tij Posedoni krijon furtuna dhe tërmete për të. Këtu në raftet e mia me libra ngjitur me versione përkthimesh të vargjeve të ndryshme, ndodhet proza ngashënjyese “*Odiseja*” e E.V. Rieu, fajtori i kthimit të poemës në një novelë, por fshehtësisht një krijim i dashur për mua pikërisht për vrullin e lëvizjeve të tij.

Në drejtim të kundërt, ja se si e mohoj thirrjen e të dy kllisheve opozitare: dhoma e punës së shkrimtarit e papërlyer, si rregullsi e dliërë Japoneze; dhoma e punës së shkrimtarit të pasur, rehati e çrregullsisë shkatërraqe anglofile. “Ja dhe planimetria: këmbalecë drukedri qëndëruar përpara drejtkëndëshit të ekranit


prej letre,” do të desha të them. “Këtu puna ime kërkon ekonominë e Kabuki-t.” Një kallamar me bojë shkrimi, një prefese lapsash, një penë. “Atje ndodhen marifetet artizanale që im gjysh ka sjellë nga Kreta, këtu është një hartë e skicuar me dorë që tutori im ma ka sjellë nga vendi i majave të skifterëve Skocia, aty ndodhen variantet e vëllimeve të “*Komedisë Hyjnore*” dhe “*Eneida*”-s të xhaxhait tim, shumica e të cilave të ngjeshura me nënvizime, këndeje keni disa akuarele që gjyshja ka sjellë nga Venecia, ja edhe lëmshi i kujtimeve të ditëve të mia në kolegjin Etoni ...”

Kur shikoj rreth e qark dhomës time, vështroj gjurmët e atyre duajve me drithëra ideale, të rrethuara me revizionimin antik të mishmashit amerikan në një hapësirë Amerikane. Version i mobilimit të brendshëm të “bubërrimit të dy brigjeve dhe mashtrimin të përkryer.” Këtu në një hapësirë që orvatet të gjejë kompromis midis këtyre dy faltoreve të njohura polare, ftoj hyjnitë nevrrike të Ndërprerjes Shushatjes dhe Improvizimit.

Ndoshta Muza nuk është vetëm një trillim seksual, por mishërim mitik i atyre principeve të tjera kaq shumë në opozitë me zellin e krijimtarisë shtëpiake. Një eksitim i detyruar. Muza vjen rrotull kryeneçe, pikërisht kur supozohet të studiosh për një provim, apo kur përgatitesh për ndonjë takim të planifikuar. Në çastin e pa përshtatshëm, një trokitje në derë, një fëshfërimë dhe: “Po qe se me të vërtetë më dashuron, provoje dhe merrmë tashti ndër krahë.”

Në rrugë e sipër, kureshtar Asistenti Kryesor nuhat drojën time: nazeli, një vegël e kulturës kjo ndjenjë, parafytyroj hapësirën e shtëpive të lagjeve të varfra periferike. I bindur me idenë kulturore e të fort dëshiruarit të një dhome të ndarë më vete nga fëmijët e tjerë, u rrita duke ndarë të njëjtën dhomë me motrën time si fillim, më tej me vëllanë tim, në apartamentin tonë dy e një kuzhinë, në katin e parë të një karakatinë dykatëshe. Ndoshta e vetmja gjë që më përfron me jetën e Virginia Woolf është fakti se nuk kam pasur asnjëherë Dhomën Time gjersa u bëra një djalë i rritur. E tillë është mëdyshja ime, ndjenjë e kompromentuar për të gjithë këtë gjatësi – dhomë të mbushur me dritare – “libër i nënvizuar” – në një shtëpi të stilit Viktorian. Pianoja dhe saksofoni janë rrugë gjigante që shtrihen jashtë ndërsa aty ndodhem i mbyllur. Gjithashtu, faksi, CD-ja, telefoni, linja e internetit, të tilla janë. Por më afër dëshirave të mia se të gjitha këto së bashku, është ai: Odiseja. Ky vend është dhe nuk është i imi. Jam dhe s’jam në të. Është i ngopshëm dhe i pamjaftueshëm për mua; i bërë kapicë me sendet e mia, që më zbardhëllon nga të gjitha orenditë, vend që bëhet një gjetje teatrale ndërkohë që luhetat midis qelës meditonjëse të një murgu Zen Budist e dhomës hetimore të inspektorit të njohur Sherlock Holmes.

Madje edhe nga trofetë e mia ndihet paksa mbështetje. “Ja ku është kutia e shahut që e latoj mbi kapak, këtu babi im me ekipin e tij të basketbollit: “The Jewish Aces, City Champs, 1938”. Aty një kartolinë nga koha e vjeljes së rrushit në Long Branche, New Jersey, tregon barin e gjyshit tim, Broadway Tavern. Një top bejsbolli të nënshkruar: karemi-kafshues, që një sportist i njohur ma dhuroi si rezultat i përmendjes së emrit të tij në një nga poezitë e mia. Një medalje e Dantes e blerë në një dyqan vjetërsirash antike dhuratë nga një poet irlandez. Ora ime me figurinën e personazhit të filmave vizatimorë Bart Simpson. Fotografitë. Tastiera ime. Por këto gërmadha jete dhe objekte adhurimi dhe pothuajse drogëra shëruese lundrimi përbëjnë një model jo të rregullt, jo një kostelacion të akorduar nga shekujt. Familjariteti i kaosit të tyre bie erë Posedon, kundërshtari i vjetër dhe frymëzuesi, Perëndia Oqean që bllokoi rrugën për në shtëpi dhe shkund mbarë botën. Ai tundet, dhe jam i frikësuar, dhe kacafytem me diçka pa formë, pa lidhje, të shkriëruar, dhe po qe se jam me fat, mëdyshja mund të më lerë të tundem e shkundem, i pafrymë, kureshtar i ndezur tek disa brigje që asnjëherë nuk kam mundur t’i shoh më parë.



ROBERT PINSKY (1940 -) poet, eseist, kritik letrar, libretist, profesor universiteti dhe përkthyes, ka lindur në Long Branch New Jersey. Pas shkollës së mesme, diplomohet në Artet e Bukura pranë Universitetin Rutgers në vitin 1962. Vazhdon studimet e larta në Universitetin Stranford ku diplomohet si Mjeshtër i Arteve në vitin 1965 prej ku edhe kurorëzon doktoraturën në vitin 1967. Në vitin 2004 zgjidhet Kancelar i Akademisë së Poetëve Amerikanë, pozicion të cilin e mbajti gjer në vitin 2010. Për tre vite rresht ka qenë Poet Laureat i Shteteve të Bashkuara (1997-2000) i pari rast ky në botën letrare amerikane. Përgjatë gjithë karrierës së tij Pinsky dallohet si poet që e ka angazhuar poezinë dhe rolin e saj në kultura dhe horizontet e ndryshme të pejsazhit amerikan. Përkthyes i Ferrit të Dantes, Bllok shënimesh të ndara të Česlav Milosh, etj. Drejtor dhe koordinator i publikimit të *Më të mirat e Poezisë* më të mirë Amerikane. Fitues i disa çmimeve, opusi i tij përmbledh dhjetë libra me poezi, botuar në vitet 1975-2016. Gjashtë botime me ese dhe prozë, publikuar përgjatë viteve 1975-2009. Si edhe një sërë antologji, librete, përkthime, shkrime kritike, konferenca dhe leksione ndër vite në bashkëpunim me Njy Jorker, E Përmaajshmja e Atlantikut, *Më të mirat Poezi Amerikane*, etj. Qysh nga viti 2015 Universiteti i Bostonit e emëron Robert Pinsky Profesor i Merituar në Fronin e William Fairfield Warren që është funksioni më i lartë që i jepet antarëve profesional dhe bashkëpunëtorëve aktivë në kërkimet e jetës universitare. Jeton në Newton Corner Massachusetts.



Tua Forsström
kur gjithë uji i botës
shndërrohet në lot

Poezi

Onufri